



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

RAPORT
I PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT
PËR VITIN 2021

Mars 2022

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,**Të nderuar zonja e zotërinj Deputetë,**

Në përmbushje të detyrimit të parashikuar në nenin 148/b shkronja “d” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 104 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr.1, datë 11.01.2022 “Për miratimin..., kalendarit vjetor të Kuvendit për raportimin e institucioneve të pavarura për veprimtarinë e vitit 2021...”, dërguar me shkresën tuaj nr.216, datë 18.01.2022, ju parashtroj Raportin Vjetor të Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2021.

Në këtë raport jepen të dhëna të detajuara, për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në vend, për efikasitetin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm dhe efektivitetin e hetimeve, ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq, ekzekutimin e vendimeve penale dhe veprimtari të tjera thelbësore përgjatë vitit 2021, si dhe objektivat prioritare për vitin 2022.

Viti që kaluam ishte mjaft i vështirë për shkak të kohëzgjatjes së pandemisë, e cila ndikoi dhe krijoi problemeve edhe në funksionimin e sistemit të prokurorisë, por prokurorët dhe strukturat administrative e mbështetëse të prokurorisë e përballuan më së miri këtë situatë.

Prokuroria ka ushtruar kompetencat e saj bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe ligje të tjera në fuqi, si dhe Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave, rekomandimet e Bashkimit Evropian dhe Planit të Veprimit të Grupit të Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (në vijim: ICRG/FATF) për vitin 2021, si dhe në prioritetet kyçe të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Për të garantuar, si rritjen e mëtejshme të efektivitetit në luftën e përbashkët kundër krimit, forcimin e rendit juridik dhe shtetin e së drejtës, ashtu dhe mbrojtjen e lirive personale dhe të drejtave e interesave të ligjshme të shtetit, ka ende shumë për të bërë, dhe për këtë nevojitet vijimi i masave për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale në sistemin e prokurorisë, rritja e efikasitetit të bashkëpunimit ndërinstitucional me të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë penale dhe i strukturave shtetërore, vijimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe rritja më tej e përgjegjshmërisë dhe integritetit në çdo hallkë të sistemit të drejtësisë penale.

Duke ju siguruar se organi i prokurorisë do të intensifikojë më tej masat dhe luftën efektive kundër kriminalitetit, ju paraqesim raportin për gjendjen e kriminalitetit për vitin 2021.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

I. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit	5
Drejtimit prioritarë, rekomandimet, aktivitetet dhe treguesit.....	5
Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve të Bashkimit Evropian.....	5
Zbatimi i Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”.....	30
Aktet normative të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre	58
Përmbledhje e tendencave të kriminalitetit sipas grupveprave.....	63
Efektiviteti i ndjekjes penale, cilësia e përfaqësimit të akuzës në gjyq.....	65
II. Analiza e treguesve të kriminalitetit.....	68
2.1 Volumi i punës në hetim	68
2.2 Çështje të përfaqësuara në gjykatë.....	68
2.3 Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë në pesë vitet e fundit	69
2.4 Procedime penale të regjistruara sipas prokurorive.....	74
2.5 Koeficientët e kriminalitetit për 100,000 banorë.....	76
2.6 Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale.....	77
2.7 Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.....	78
2.8 Kriminaliteti sipas strukturës së kodit penal.....	79
2.9 Analiza e veprave penale sipas strukturës së kodit penal.....	82
Krime kundër njerëzimit.....	82
Krime kundër jetës të kryera me dashje.....	82
Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi.....	87
Vepra penale kundër shëndetit të kryera me dashje.....	87
Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia.....	91
Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënësisë ose mosdhënia e ndihmës.....	91
Krime seksuale.....	94
Vepra penale kundër lirisë së personit.....	97
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit.....	101
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes.....	104
Vepra penale kundër lirisë së besimit.....	108
Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.....	108
Mashtrimet.....	113
Shkatërrimi i pronës.....	117
Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare.....	120
Vepra penale në veprimtaritë bankare dhe financiare.....	122
Krime në fushën e doganave.....	123
Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet.....	127
Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë.....	130
Falsifikimi i dokumenteve.....	133
Vepra penale në fushën e falimentimit.....	136
Zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit.....	136
Vepra penale që çenojnë rregjimin juridik të tokës.....	139

Vepra penale kundër mjedisit.....	141
Krime kundër pavarësisë e rendit kushtetues dhe krime që çënojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera.....	144
Vepra me qëllime terroriste.....	145
Krime kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit.....	145
Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik.....	149
Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike.....	152
Vepra penale që lidhen me pastrimin e parave.....	157
Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë.....	159
Vepra penale kundër drejtësisë.....	162
Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.....	166
Veprat penale të korrupsionit.....	167
Krimi kibernetik.....	168
Trafiqet e paligjshme.....	171
Veprat penale që lidhen me prodhimin dhe kultivimin e narkotikëve.....	174
2.10 Treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në vite.....	178
2.11 Të dhëna për të pandehurit	182
III. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.....	187
Ekstradimet.....	188
Letërporositë.....	192
Njohjet e vendimeve penale.....	199
Transferimet e procedimeve penale.....	200
Transferimet e personave të dënuar.....	201
Urdhrat e arrestit ndërkombëtar	203
IV Garantimi i integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike	205
V. Ngarkesa e punës së prokurorive për vitin 2020.....	209
VI. Përmbledhje e analizës financiare.....	226
VII. Objektiva prioritarë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021.....	230
Aneksi 1 Tabelat me të dhëna e tregues statistikorë të veprave penale.....	234
Aneksi 2 Të dhëna pasuritë e sekuestruara dhe kërkesat për konfiskim.....	268

I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2021

Prokuroria është organ i pavarur kushtetues, që ushtron ndjekjen penale, përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj.

Prokuroria për vitin 2021, përbëhet nga¹:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) Prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
- c) Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Në prokuroritë sipas niveleve më sipër funksionet ushtrohen nga prokurorët pranë tyre.

Zhvillimet kryesore, përgjatë vitit 2021 në luftën kundër kriminalitetit dhe në veprimtarinë e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, në mënyrë sintetike, kanë qenë²:

I. Drejtimit prioritarë, rekomandimet, aktivitetet dhe treguesit

Drejtimit kryesore të luftës kundër kriminalitetit për vitin 2021, të formalizuara, si në politikat dhe objektivat prioritarë institucionale të parashtruara në Raportin e Prokurorit të Përgjithshëm dërguar Kuvendit të Shqipërisë “Për gjendjen e kriminalitetit për vitin 2020” në prill 2020, ashtu dhe në kërkesat e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimet prioritarë të Këshillit të Ministrave, rekomandimet e Komitetit të Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri dhe në planin e veprimit të ICRG/FATF për Shqipërinë, kanë qenë në fokusin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2022. Këto drejtime janë ndjekur me përparësi, si nëpërmjet masave administrative dhe procedurale institucionale siç janë miratimi i udhëzimeve të përgjithshme dhe planeve të veprimit për të unifikuar veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe mbikëqyrjes së zbatimit tyre me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit bazuar në një kuadër normativ të unifikuar, konsoliduar dhe sa më eficient në veprimtarinë institucionale, ashtu dhe nëpërmjet vijimit të zbatimit të akteve të përbashkëta me disa institucione dhe agjenci ligjzbatuese ndërvepruese që kanë ndikuar në rritjen e kapaciteteve ndërinstitucionale e profesionale dhe efikasitetin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

1. Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit dhe i rekomandimeve të Bashkimit Evropian (BE-së).

¹ Bashkëlidhur struktura dhe organika e prokurorisë, miratuar me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.49, datë 07.5.2021 “Për strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme” dhe nr. 29, datë 3.02.2020 “Për strukturën organike të Prokurorisë së Shkallës së Parë dhe Prokurorisë të Apeleve”.

² Renditur sipas kërkesave të Rezolutës së Kuvendit datë 14.06.2021

Prokuroria e Përgjithshme në mbështetje të nenit 148/b shkronja “dh” të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 104 pika 4 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe në përmbushje të vendimit të Kuvendit nr.49/2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj” dhe vendimit të Kuvendit nr.134/2018 “Për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik”, ndërmori masat e nevojshme për zbatimin e kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 14.06.2021 dhe mbikëqyrjen e zbatimit të saj, si vijon:

Prokurori i Përgjithshëm me urdhrin nr.78 datë 09.07.2021 miratoi Planin e Veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 14.06.2021 dhe ka caktuar strukturat sipas niveleve të prokurorive për monitorimin e zbatimit të masave të planit të veprimit, në të cilin janë përcaktuar masat/aktivitetet, strukturat përgjegjëse, fondi i nevojshëm, afatet kohore dhe treguesit/indiktorët matës të zbatimit për secilën kërkesë të Rezolutës. Ky akt normativ me shkresën nr.977/3, datë 19.07.2021 i është dërguar për njoftim Kuvendit të Shqipërisë, dhe ndërkohë i është dërguar për njohje dhe zbatim prokurorive të të gjithë niveleve të juridiksionit të përgjithshëm.

Në kuadrin e mbikëqyrjes së zbatimit të kërkesave të Rezolutës dhe të objektivave të synuara në Planin e Veprimit, jemi të ndërgjegjshëm se realizimi i tyre është vështirësuar, si për shkak se në të gjithë nivelet e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm ka vijuar krijimi i vakancave të përkohshme dhe të përhershme, si për shkak të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve, ashtu dhe për shkak të vijimit të gjendjes së pandemisë Covid 19 përgjatë vitit 2021.

Në mbikëqyrjen e zbatimit të kërkesave të rezolutës, evidentohen zhvillimet më të rëndësishme të përditësuara mbi ecurinë e përmbushjes së kërkesave të rezolutës, angazhimet dhe progresi lidhur me masat, aktivitetet, rezultatet e arritura bazuar në treguesit e vitit 2021 dhe problematikat në zbatimin e tyre në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, të përmbledhura në vijim për secilën kërkesë:

1.1 Në zbatim të kërkesës së Rezolutës të Kuvendit “*Të merren masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë*”, kërkesë e cila përkon me, - rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave për vitin 2021, “*Marrja e masave për forcimin e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve, të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë*”, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.1.1 Në përmbushje të kësaj kërkesë të rezolutës dhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave (në vijim: KM) për vitin 2021, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar Udhëzimin e Përgjithshëm nr.4, datë 09.07.2021 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, në të cilin janë normuar masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimet paraprake, dhe kryerjen e hetimeve proaktive efektive me përdorim të mjeteve të posaçme/speciale të hetimit në funksion të shtimit të

hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë për rritjen e mëtejshme të efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit në vitin 2021.

1.1.2 Në zbatim të këtij udhëzimi të përgjithshëm dhe në përmbushje të kësaj kërkesë të rezolutës, prokurorët kanë rritur rolin aktiv në hetimet paraprake, si nëpërmjet shtimit të hetimeve të filluara kryesisht, ashtu dhe në kryerjen e hetimeve proaktive efektive me përdorim të mjeteve të posaçme/speciale të hetimit në funksion të rritjes së hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë.

i) Referuar të dhënave statistikore dhe informacioneve të drejtuesve të prokurorive në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, evidentohet se në vitin 2021 janë filluar kryesisht 125 procedimeve penale ose me rritje 104,91 % të numrit të procedimeve të filluara kryesisht krahasuar me vitin 2020 që ishte 61 procedime.

ii) Prokurorët sipas kërkesave dhe procedurave ligjore, në vitin 2021 kanë rritur rolin aktiv në kryerjen e hetime proaktive me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në 655 procedime penale ose me rritje 3.9 % të numrit të procedimeve proaktive krahasuar me vitin 2020. Ky proces i ka shërbyer, si parandalimit dhe/ose ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu dhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 640 personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

iii) Në hetimet për vepra penale në kompetencë lëndore të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, prokurorët me rol aktiv kanë vlerësuar drejt të dhënat/indiciet e përfituara nga përdorimi i mjeteve të posaçme të hetimit edhe për kryerjen e veprave penale në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme. Në këtë vështrim, në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.04/2021 dhe dhe në vijim të mbikëqyrjes së zbatimit të Aktit Koordinimit Ndërinstitucional datë 15.12.2020 “Për rritjen e efikasitetit nëpërmjet, bashkërendimit të Prokurorisë së Përgjithshme, me Prokurorinë e Posaçme dhe unifikimin e disa veprimtarive administrative dhe procedurale ndërinstitucionale,...”, sipas të dhënave statistikore dhe informacionit nga Prokuroria e Posaçme, nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm janë transferuar 93³ procedime/referime penale në Prokurorinë e Posaçme ose me rritje 45.3% të procedimeve të transferuara krahasuar me vitin 2020, prej të cilave 69 procedime janë pranuar e regjistruar për vepra penale me qëllime terroriste, trafikime të paligjshme dhe vepra penale në fushën e korrupsionit, etj, në kompetencë lëndore të asaj Prokurorie, disa raste nga të cilët, kryerja e hetimeve proaktive ka çuar në zbulimin e ekzistencës së elementëve të formave të veçanta të bashkëpunimit, për kryerjen e hetimeve të mëtejshme nga ajo prokurori në kuadrin e veprimtarisë kriminale të organizuar.

 Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, kërkesën e rezolutës dhe rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave, për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht, e konsiderojmë të realizuar, si për faktin se me Udhëzimin e Përgjithshëm nr.4, datë 09.07.2021 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të

³ Sipas të dhënave statistikore, përgjatë vitit 2021 janë transferuar për kompetencë lëndore 93 procedime penale nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në Prokurorinë e Posaçme.

Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, janë normuar masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimet paraprake, ashtu dhe është rritur numri i procedimeve të filluara kryesisht, është rritur numri i hetimeve proaktive dhe rezultatet e përfutuara dhe është rritur numri i referimeve bazuar në hetimet proaktive të iniciuara/dërguara Prokurorisë së Posaçme, si dhe përgjithësisht është rritur efektshmëria në zbulimin, goditjen dhe parandalimin e veprimtarisë kriminale në fushat përkatëse të veprimtarive institucionale dhe ndërinstitutionale.

1.2 Në zbatim të kërkesës së Rezolutës të Kuvendit “Të forcohet koordinimi dhe monitorimi i ecursisë së zbatimit të memorandumit të bashkëpunimit dhe udhëzimit të përgjithshëm nr.10/2020, për rritjen më tej të efikasitetit të veprimtarisë ndërinstitutionale dhe të efektivitetit në hetimet dhe ndjekjen penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, në vijim të zbatimit të planit të veprimit të Grupit të Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar/Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (ICRG/FATF)”, kërkesë e cila përkon me, -rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave, drejtimet: “Lufta kundër krimit të organizuar” e “Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional”, ashtu dhe me, -rekomandimet e KSA-së dhe Planit Veprimit të ICRG/FATF “Për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave...” për Shqipërinë, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.2.1 Prokuroria e Përgjithshme në përmbushje të, kësaj kërkesë të Rezolutës, rekomandimeve prioritare të KM, rekomandimeve të KSA-së dhe Planit të Veprimit të ICRG/FATF, ka vijuar zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit datë 15 korrik 2020 dhe Udhëzimit të Përgjithshëm nr.10/2020, si dhe ka iniciuar Urdhrin e Përbashkët “Për ngritjen e Sekretariatit Teknik në Prokurorinë e Përgjithshme për zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit” i miratuar në Korrik 2021 nga përfaqësuesit e PP, DPPSH, DPPPP, DPT, DPD, AAPSK-së, me synim rritjen e efikasitetit të koordinimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të memorandumit të bashkëpunimit dhe Udhëzimit të Përgjithshëm nr.10/2020 në nivel qendror dhe në nivel vendor, si dhe përcaktimin e rregullave të funksionimit të këtij Sekretariati Teknik Ndërinstitutional.

1.2.2 Prokuroria e Përgjithshme me mbështetjen e Projektit EURALIUS V, në përmbushje të rezultatit imediat (IO.7.1) të planit të veprimit të ICRG/FATF, përgatiti sistemin elektronik e-tracking PRESTO, me synim për të përfutur të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse, të hollësishme dhe të besueshme, si dhe për të evidentuar arritjet dhe problematikat për efikasitetin në ndjekjen penale të këtyre grupveprave penale. Për implementimin e këtij sistemi elektronik, Prokurori i Përgjithshëm nxori Urdhrin nr.92 datë 30.07.2021 “Për përdorimin e regjistrit elektronik dhe përfutimin e statistikave për çështje të pastrimit të parave në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”, i cili ju dërgua për zbatim strukturave të posaçme dhe prokurorëve të dedikuar për hetimin e ndjekjen penale të pastrimit të parave, së bashku me manualin e përdorimit të tij. Ky urdhër për efekte të masave organizative/administrative përgatitore ka hyrë në fuqi menjëherë (30.07.2021), ndërsa veprimtaria për përdorimin e regjistrit elektronik e-tracking PRESTO ka filluar me 1 shtator 2021, me efekte zbatimi me datë 1 janar 2021. Ky rezultat i arritur është vlerësuar paraprakisht dhe në vijimësi nga ekspertët e ICRG/FATF në raport progresin për

zbatimin e këtij plani veprimi. Ndërkohë seksionet e posaçme dhe prokurorët e dedituar në prokuroritë përkatëse po vijojnë hedhjen e të dhënave sa më të plota në këtë sistem elektronik për të përfutur të dhëna statistikore të besueshme, gjithpërfshirëse dhe në kohë reale për këtë grup veprash penale brenda afateve të këtij plani veprimi.

1.2.3 Në përmbushjen e rezultatit imediat (IO.2) të planit të veprimit FATF/ICRG lidhur me prioritizimin e kërkesave të autoriteteve gjyqësore të huaja nëpërmjet sistemeve elektronike, në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional me Ministrinë e Drejtësisë është mundësuar dhënia e të drejtës së përdorimit të drejtpërdrejtë në sistemin elektronik “M-File” të Ministrisë së Drejtësisë për dy përdorues të Prokurorisë së Përgjithshme, si zgjidhje e përkohshme deri në përmirësimin e sistemit elektronik “IMPRO” të Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, që do të mundësojë ndërlidhjen e dy sistemeve IMPRO dhe M-File.

1.2.4 Në kuadrin e forcimit të kapaciteteve profesionale të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore, dhe strukturave hetimore në agjencitë ligjzbatuese të tjera, Prokuroria e Përgjithshme ka bashkëpunuar me projektet ndërkombëtare që asistojnë sistemin e drejtësisë penale, të cilët kanë mbështetur dhe kontribuar në aktivitetet, siç janë:

i) Projekti FIAPP (Spanjoll), i cili ka filluar aktivitetin në Mars 2021, për asistencë në fushën e pastrimit të parave, lidhur me: -aktivitetin “Për përgatitjen e manualit për pastrimin e parave” ka filluar puna në nëntor 2021 me ngritjen e grupit të punës me ekspertë ndërkombëtarë të përfshirë dhe është përgatitur indeksi i manualit për pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve kriminale, si dhe -ka planifikuar për vitin 2022 aktivitete për trajnime të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore, dhe strukturave hetimore të agjencive ligjzbatuese të tjera në këtë fushë;

ii) Projekti PAMECA V ka bashkëpunuar dhe mbështetur Prokurorinë e Përgjithshme në zhvillimin e dy moduleve trajnimi online me tema: “Mbi pastrimin e parave dhe hetimi pasuror dhe financiar” dhe “Mbi veprat penale që lidhen me detyrën” të zhvilluara në janar 2021 ku morën pjesë prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve të posaçme, prokurorë të Prokurorisë së Posaçme, oficerë të policisë gjyqësore të shërbimeve në Policinë e Shtetit dhe përfaqësues të DPT, DPD, DPPPP, KLSH, ILDKPKI (gjithsej 148 pjesëmarrës).

1.2.5 Rezulti i këtyre masave, që përkon me përmbushjen e rezultatit imediat (IO.7.1) të planit të veprimit të ICRG/FATF, është progresi i evidentuar me rritjen e efektivitetit në hetimet për veprat penale të pastrimit të parave të parashikuara nga nenet 287 e 287/b të Kodit Penal, pasi sipas të dhënave statistikore në vitin 2021 evidentohet:

i) Për veprat penale të parashikuara nga nenet 287 dhe 287/b të Kodit Penal, janë regjistruar 301 procedime penale të reja me 56 të pandehur, dhe 18 procedime me 33 të pandehur u dërguan për gjykim, si dhe 21 persona janë dënuar. Këto tregues evidentojnë një rritje prej 7.01 % të procedimeve të regjistruara dhe një rritje prej 31.25 % të personave të dënuar për këto dy vepra të pastrimit të parave.

ii) Në vitin 2021 vetëm për veprën penale të PP sipas nenin 287, janë regjistruar 288 procedime të reja me 42 të pandehur, dhe 10 procedime me 10 të pandehur janë dërguar për gjykim, si dhe 10

persona janë dënuar. Këta tregues, krahasuar me periudhën e vitit 2020 kanë një rritje prej 3.22% të procedimeve të regjistruara për këtë vepër.

1.2.6 Hetime financiare e pasurore për sekuestrimin/konfiskimin e pasurisë për vitin 2021 janë:

Në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, në kuadrin e hetimit dhe ushtrimit të ndjekjes penale për veprën penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*” sipas nenit 287 të K.Penal dhe për vepra të tjera penale të lidhura me to, në zbatim të nenit 36 të Kodit Penal dhe neneve 274 dhe/ose 210, 190 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, mbi kërkesat e prokurorëve gjykatat kanë vendosur konfiskime pasurie/aseteve kriminale në kuadrin e dy çështjeve, dhe sekuestime pasurie në kuadrin e 6 procedimeve penale, të përshkruara në Aneksi 2 bashkëlidhur. Këto tregues evidentojnë një rritje në shifra si të numrit të konfiskimeve të pasurisë nga 0 në 2 (dy) vendime konfiskimi pasurie, ashtu dhe një rritje të numrit sekuestimeve të pasurisë nga 5 në 6 vendimi sekuestrimi pasurie, krahasuar me vitin 2020.

ii) Në këtë periudhë, në zbatim të nenit 3/1 e vijues të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, i ndryshuar, në kuadrin e hetimeve pasurore, mbi kërkesat e prokurorëve të pranuar nga gjykata kanë vendosur: për 1 (një) procedim konfiskim pasurie për një procedim dhe për 3 (tre) procedime është vendosur sekuestrimi i pasurive, të cilët janë në Aneksi 2 bashkëlidhur. Këto tregues evidentojnë një rritje në shifra të numrit të konfiskimeve nga 0 në 1 (një) vendim konfiskimi pasurie në zbatim të ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar.

1.2.7 Ndërkohë, në vitin 2021 Prokuroria e Përgjithshme në kuadrin e zbatimit të masave të planit të veprimit të ICRG/FATF - Shqipëri, ka përgatitur kontributin institucional të progresit dhe është përfaqësuar në takimet/mbledhjet e Grupit Ndërinstitucional të Punës për zbatimin e Planit të Veprimit dhe në mbledhjen e Komitetit të Bashkëpunimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave në datë 28 qershor 2021.

i) Prokuroria e Përgjithshme ka përgatitur në bashkërendim me Prokurorinë e Posaçme materialet e progresit për raportin në kuadër të raportimit periodik, ku janë administruar dhe analizuar përpjekjet e bëra për rritjen e efektivitetit në luftën ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për vitin 2021. Gjithashtu, përfaqësuar Prokuroria e Përgjithshme në takimet online në 8 janar 2021, korrik 2021 dhe 8 shtator 2021 me ekspertët e ICRG/FATF-së në kuadrin e zbatimit të Planit të Veprimit të FATF/ICRG-Shqipëri.

 Në përmbushje të funksioneve Kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar këtë objektiv prioritar, kërkesë të rezolutës së Kuvendit, rekomandim prioritar të KM dhe aktivitete të planit të veprimit të FATF/ICRG, për faktin se evidentohen arritje, si në vijimin e zbatimit të politikave dhe masat administrative e procedurale institucionale dhe ndërinstitucionale, ashtu dhe përmirësimi i strukturës koordinuese e monitoruese për rritjen më tej të efikasitetit në bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet dhe agjencitë e përfshira në këtë fushë (MB, MFE, DPPSH, AAPSK, DPPPP, DPD, DPT), forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale, dhe rritjen e numrit të procedimeve të regjistruara dhe e personave të dënuar si dhe rritjen e numrit të pasurive

produkte të veprimtarisë kriminale të konfiskuara dhe sekuestruara për veprën penale të pastrimit të parave dhe vepra penale të tjera të lidhura me të.

🚩 Në vijim të zbatimit të objektivave prioritare dhe Planit të Veprimit ICRG/FATF, po punohet me synimin për rritjen më tej të efikasitetit në bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet dhe agjencitë e përfshira në këtë fushë për vijimin e punës së nisur për forcimin e kapaciteteve profesionale, si dhe për të rritur më tej numrin e të procedimeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim, dhe të dënuarve për veprat penale të pastrimit të parave, veçanërisht persona të tretë profesionist dhe/ose subjekte raportuese (gatekeeper), rritjen më tej të hetimeve financiare e pasurore për identifikimin, sekuestrimin dhe/ose konfiskimin e pasurive prodhuese të veprimtarisë kriminale, ose vlerën ekuivalente të tyre, përmes bashkëpunimit të cilave mundëson heqjen e Shqipërisë nga grupi i vendeve në monitorim të shtuar ose “lista Gri”⁴ në qershor 2022.

1.3 Në zbatim të kërkesës së Rezolutës “Të forcohen kapacitetet institucionale për rritjen e efikasitetit në veprimtarinë administrative të prokurorisë dhe të veprimtarisë së prokurorëve dhe Policisë Gjyqësore në ushtrimin e funksioneve të tyre nëpërmjet vijimit të punës së nisur për shmangien e efekteve të krijuara nga ulja e numrit të prokurorëve për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, bashkërendimit dhe koordinimit me Këshillim e Lartë të Prokurorisë (KLP) dhe Shkollën e Magjistraturës, për të planifikuar në kohë zëvendësimin e prokurorëve të shkarkuar nga detyra me magjistrat/prokuror sipas rregullave të përcaktuara në ligj” kërkesë e cila përkon me rekomandimin e KM për “Zhvillimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve në këtë fushë, duke përfshirë edhe trajnime të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore”, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.3.1 Në kuadrin e unifikimit të veprimtarisë administrative të prokurorisë dhe forcimit të kapaciteteve institucionale për rritjen e efikasitetit në veprimtarinë administrative, në zbatim të Urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.164 datë 18.12.2020 “Për miratimin e rregullores standard të organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe Prokurorisë pranë Gjykatave të Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm”, i hyrë në fuqi me 1 janar 2021, drejtuesit e prokurorisë kanë miratuar rregulloret standard për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë që drejtojnë me synim për të siguruar efikasitetin dhe efikasitetin në veprimtarinë administrative që kryen secila strukturë në prokurori nëpërmjet zbatimit të rregullave standard⁵.

1.3.2 Në kushtet e një situatë kritike vazhduese të mungesës së kapaciteteve funksionale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm të krijuar nga vakancat e prokurorëve në procesin e vetingut, Prokurori i Përgjithshëm në vijim të punës së nisur për shmangien e efekteve të krijuara nga ulja e numrit të prokurorëve për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, për të lehtësuar rritjen e ngarkesës dhe mbështetur veprimtarinë e prokurorëve me numër të reduktuar në sistemin e prokurorisë, me shkresën nr.1434, datë 24.09.2021 i ka kërkuar Komisionit të Policisë Gjyqësore rritjen në 250 të numrit organik të oficerëve të policisë gjyqësore në seksionet pranë prokurorisë të

⁴<http://www.fatf-gafi.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/documents/increased-monitoring-february-2020.html#albania>

⁵ Neni 20 në lidhje me nenin 38 pika 2 shkronja “e” e ligjit nr.97/2016;

juridiksionit të përgjithshëm dhe kryerjen e procedurave për emërimin e tyre sipas nevojave në disa prokurori, me synim për të lehtësuar dhe mbështetur veprimtarinë e prokurorëve në përballimin e volumit të punës në rritje, të cilët aktualisht janë të mbingarkuar me kryerjen e hetimeve, ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e çështjeve në gjykim.

i) Kjo kërkesë është bazuar në një studim të kryer referuar numrit ekzistues të oficerëve të Policisë Gjyqësore që ushtrojnë funksionet në seksionet e policisë gjyqësore pranë prokurorive të shkallës së parë, numrit të lartë të çështjeve penale që prokuroritë kanë hetuar vitet e fundit, ngarkesës të madhe në punë të oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe raportit jo të drejtë prokuror - oficer i policisë gjyqësore, që ekziston aktualisht në të gjitha prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

1.3.3 Komisioni i Policisë Gjyqësore, mbi propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, në mbledhjen e datës 29.09.2021, në mbështetje të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, dhe bazuar në studimin e Prokurorisë së Përgjithshme, caktoi numrin e përgjithshëm prej 250 oficerë të Policisë Gjyqësore të Seksioneve të Policisë Gjyqësore në prokuroritë e të gjitha niveleve të juridiksionit të përgjithshëm.

i) Gjithashtu, mbi kërkesat e Prokurorit të Përgjithshëm nr.1506/2021 dhe nr.1284/159-2021, Komisioni në zbatim të ligjit 25/2019 ka shqyrtuar kërkesat dhe ka emëruar në seksionet pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm 13 oficerë të policisë gjyqësore në muajin maj 2021 dhe 12 oficerë të policisë gjyqësore në muajt nëntor-dhjetor 2021.

ii) Rekrutimi i oficerëve të policisë gjyqësore është kryer mbi bazën e konkurimit dhe pasi kandidatët kanë kaluar të gjitha fazat e konkurimit, të përcaktuara në Rregulloren e Komisionit të Policisë Gjyqësore “Për caktimin e rregullave për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore të Seksioneve të Prokurorisë”.

1.3.4 Prokuroria e Përgjithshme në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, ka bashkëpunuar me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe me Shkollën e Magjistraturës, për të siguruar mbarëvajtjen e punës administrative në prokurori, rritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe lehtësimin drejt shmangies së problematikave që janë e po krijohen me vakancat e prokurorëve në sistemin e prokurorisë në këtë periudhë të procesit të rivlerësimit kalimtar. Në kuadrin e zbatimit të ligjit dhe bashkërendimit të punës me këto institucione janë kryer disa aktivitete, si më poshtë:

i) Prokurori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 105 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë...” me datë 27 maj 2021 raportoi në KLP “Për ecurinë e veprimtarisë së prokurorive me juridiksion të përgjithshëm”, ku janë trajtuar masat e mara, administrative dhe procedurale, për forcimin dhe garantimin e pavarësisë së prokurorëve, për rritjen e performancës së prokurorive nëpërmjet rritjes së rolit të drejtuesve të prokurorive sipas ligjit, përmirësimin e funksionimit të prokurorive, rritjen e efikasitetit të punës në veprimtarinë e çdo prokurorie, monitorimin e treguesve të veprimtarisë administrative dhe procedurale të prokurorive, objektivat prioritare për vitin 2021, si dhe problematikën, nevojat dhe mjetet ligjore për zgjidhjen e tyre.

ii) Prokurori i Përgjithshëm në kuadrin e bashkëpunimit me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Ministrin e Drejtësisë dhe në raportimin periodik në Kuvendin e Shqipërisë, veç të tjerash, është angazhuar në diskutime dhe kërkesa si nevoja emergjente, si për

miratimin e hartës së re gjyqësore, ashtu dhe për përmirësime në infrastrukturë në sistemin e prokurorisë për rritje të kapaciteteve akomoduese me ambiente pune për prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve, administratën dhe shërbimet mbështetëse në prokurori, me synim për të lehtësuar rritjen e ngarkesës dhe mbështetur veprimtarinë e prokurorëve me numër të reduktuar dhe përmirësuar kushtet e punës, në gjithë sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm.

iii) Këto masa dhe kërkesa për forcimin e kapaciteteve institucionale në sistemin e prokurorisë janë shoqëruar dhe me kërkesën për projektbuxhetin e Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2022, i cila është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin e ri për buxhetin 2022, dhe në këtë vështtrim përfitoj nga rasti t'ju falënderoj për mbështetjen institucionale të prokurorisë.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, si kërkesën e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, ashtu dhe rekomandimin e KM, i konsiderojmë të zbatuar për vitin 2021 dhe po vijon puna për vitin 2022 për marrjen e masave të nevojshme në vazhdimësi të vakancave të përkohshme e të përhershme, kryesisht për shkak të rivlerësimit kalimtar, si dhe për rritjen e numrit të oficerëve të policisë gjyqësore dhe të numrit në administratën ndihmëse/mbështetëse të prokurorëve në prokuroritë e të gjithë niveleve, për të lehtësuar rritjen e ngarkesës dhe mbështetur veprimtarinë e prokurorëve me numër të reduktuar në gjithë sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm.

1.4 Në zbatim të kërkesës së Rezolutës “Të standardizohen procedurat e funksionimit nga pikëpamja administrative për unifikimin e volumit të punës dhe normalizimin e veprimtarisë në prokurori nëpërmjet përgatitjes së një udhëzimi të përgjithshëm “Për përcaktimin e normës/volumit orientues të punës në prokurori”, me synim përcaktimin e normës e volumit të punës orientuese për prokurorët në sistemin e juridiksionit të përgjithshëm sipas standardeve evropiane të punës në të gjitha prokuroritë e rretheve gjyqësore”, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.4.1 Prokuroria e Përgjithshme, në kuadrin e zbatimit të kësaj kërkesë në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, i kërkoi Projektit EURALIUS V të mundësojë sigurimin e informacionit mbi standardet dhe/ose praktikatat e mira Evropiane, për sa i përket kriterëve që aplikohen për normimin e volumit të punës orientuese për prokurorët sipas niveleve të prokurorëve në vendet e BE-së.

1.4.2 Në këtë vështtrim, Prokuroria e Përgjithshme ka marrë masa dhe ka analizuar/studiuar, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, gjendjen, shtrirjen dhe tendencat në rritje ose në ulje të numrit të procedimeve penale të regjistruara, sipas niveleve të prokurorëve dhe rretheve gjyqësore, si dhe sipas gjendjes organike dhe faktike të prokurorëve në secilën prokurori, me synim për të vlerësuar performancën e secilës prokurori dhe për të orientuar punën paraprake që mund të nevojitet për përcaktimin e normës/volumit orientues të punës në sistemin e prokurorisë.

i) Por ndërkohë, së afërmi pritet të miratohet dhe hyjë në fuqi harta e re e sistemit gjyqësor, ku përfshihet dhe sistemi i prokurorisë, me ndikim në riorganizimin e prokurorëve pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm në një numër më të vogël rrethesh gjyqësore dhe me kompetenca territoriale në njësi administrative më të mëdha se aktualisht. Për këto arsye objektive kemi vlerësuar se iniciimi i përgatitjes së këtij projektudhëzimi

të përgjithshëm duhet të pezullohet, për të mundësuar përshtatjen e projektudhëzimit me riorganizimin e ri të sistemit të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm sipas hartës së re gjyqësore që pritet të miratohet së afërmi.

1.4.3 Gjithashtu, nga ekspertë të projekteve që asistojnë sistemin e prokurorisë mbetemi në pritje të informacionit të nevojshëm për standartet evropiane mbi bazën e të cilit dhe hartës së re gjyqësore do të vijojë bashkëpunimi në vitin në vijim për përgatitjen e këtij projektudhëzimi të përgjithshëm *“Për përcaktimin e normës/volumit orientues të punës në prokurori”* në standartet evropiane.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të realizuar pjesërisht këtë kërkesë të rezolutës për arsye objektive, për faktin se së afërmi pritet të miratohet dhe të hyjë në fuqi harta e re e sistemit gjyqësore, ku përfshihet dhe sistemi i prokurorisë, me ndikim në riorganizimin e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm. Për këtë arsye objektive është vlerësuar pezullimi i përgatitjes së këtij projektudhëzimi të përgjithshëm për të mundësuar përshtatjen e tij me riorganizimin e ri të sistemit të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm sipas hartës së re gjyqësore të miratuar.

1.5 Në zbatim të kërkesës së Rezolutës ***“Të evidentohen shqetësimet dhe vështirësitë që hasin prokurorët dhe/ose oficerët e Policisë Gjyqësore në prokuroritë e të gjitha niveleve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e dispozitave të reja të ligjit penal e procedural penal, metodikat/protokollet e hetimit për vepra ose grupvepra penale dhe të organizojë trajnime të oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe prokurorëve, krahas trajnimeve vazhduese të prokurorëve bazuar në programin e Shkollës së Magjistraturës. Bashkëpunimi dhe mbështetja e misioneve dhe projekteve ndërkombëtare që asistojnë prokurorinë është e mirëpritur”***, kërkesë që përkon pjesërisht dhe me rekomandimin e KM ***“Marrjen e masave për rritjen profesionale dhe organizimin e trajnimeve për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, në fusha specifike, sipas ndarjes së tyre në seksione brenda prokurorisë”***, përgjatë vitit 2021 janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.5.1 Prokuroria e Përgjithshme rritjen profesionale të prokurorëve e ka vlerësuar si domosdoshmëri për forcimin e kapaciteteve profesionale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm. Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme ka bashkërenduar me Komisionin e Policisë Gjyqësore për forcimin e kapaciteteve profesionale të policisë gjyqësore të seksioneve, dhe jo vetëm, nëpërmjet realizimit dhe trajnimeve të përbashkëta me prokurorët dhe agjencitë ligjzbatuese të përfshira.

i) Në këtë vështrim, referuar Udhëzimit të Përgjithshëm nr.4/2021 *“Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”*, drejtuesit e prokurorive janë udhëzuar të koordinojnë dhe organizojnë trajnime të përbashkëta, si dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në trajnime në bashkëpunim edhe me agjencitë e tjera ligjzbatuese. Gjithashtu, në këtë udhëzim prokurorëve u kërkohet të synojnë rritjen e zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive profesionale të tyre, nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime apo në tryeza diskutimesh, veçanërisht për zbatimin e

dispozitave të reja të Kodit Penal, si dhe trajnime të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të strukturave hetimore në shërbimet policore, me fokus në fushat dhe drejtimet prioritare të rekomanduara.

1.5.2 Në zbatim të kësaj kërkesë të Rezolutës dhe rekomandimit prioritar të KM, Prokuroria e Përgjithshme, në kuadrin e bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës, nisur nga objektivat dhe nevojat prioritare të prokurorisë, ka identifikuar temat ku vlerësohet se ka nevojë të thellohen njohuritë e prokurorëve⁶. Me shkresën nr.945 datë 09.06.2021 Prokuroria e Përgjithshme i ka kërkuar prokurorëve në prokuroritë e shkallës së parë dhe prokurorëve të apeleve, bazuar mbi problematikat dhe mangësitë e evidentuara në praktikën e veprimtarisë së tyre, për të vlerësuar temat e sugjeruara dhe tema të tjera që secili prokuror vlerëson të nevojshme për përfshirjen në kalendarin e trajnimeve në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik përkatës.

i) Referuar në temat e kërkuara dhe sugjeruara nga prokurorët në përgjigjet e dërguara në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr.945/7, datë 29.06.2021 propozimi për temat që duhen përfshirë i janë dërguar Shkollës së Magjistraturës, te cilat janë përfshirë në kalendarin e trajnimit vazhdues të prokurorëve.

1.5.3 Në kuadrin e këtij bashkëpunimi, Shkolla e Magjistraturës është angazhuar në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me pjesëmarrjen e prokurorëve, dhe jo vetëm, për forcimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve, me synim forcimin e kapaciteteve në luftën kundër kriminalitetit. Në kuadrin e trajnimit vazhdues dhe në zbatim të ligjit, përgjatë vitit 2021 në Shkollën e Magjistraturës janë organizuar dhe zhvilluar 76 tema në fusha të ndryshme të sistemit të drejtësisë penale, tema të përzgjedhura sipas ligjit nga 563 prokurorë pjesëmarrës.

i) Në këto trajnime përfshihen dhe 4 tema, për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe rritjen e performancës në veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, me pjesëmarrjen e kancelarëve dhe drejtuesve të prokurorive, prej të cilave dy tema të organizuara në bashkëpunim dhe mbështetjen e Projektit PAMEKA V dhe Projektit EURALIUS V.

1.5.4 Në kuadrin e Memorandumit të Mirëkuptimit datë 13.04.2021 mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe OSBE “Për bashkëpunimin dhe bashkërendimin në zbatimin e projekteve dhe veprimtarive në mbështetje të efikasitetit të sistemit të prokurorisë shqiptare”, me fokus “Veprimi kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri”, dhe objektivit të projektit, dhënien e kontributit drejt një pakësimi të përgjithshëm të përhapjes së trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri dhe nga Shqipëria, janë zhvilluar aktivitetet e planifikuara dhe të trajtuara në kërkesën e Rezolutës së Kuvendit me “nr.1.6”, më poshtë.

1.5.5 Në kuadrin e disa projekteve evropiane, gjatë vitit 2021, prokurorë të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm janë përfshirë në trajnime, seminare, workshope dhe kurse për rritjen e kapaciteteve profesionale në fusha prioritare, siç janë:

⁶ Koment: Temat ku është vlerësuar se ka nevojë të thellohen njohuritë e prokurorëve janë; -Krimi kibernetik, -veprat penanale në fushën e mjedisit; -trafikimi i qenieve njerëzore; -dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore; -skuadrat e përbashkëta hetimore; - krijimi grupeve hetimore; -hetimet proaktive dhe -ndryshimet e kodit penal në vitet 2020-2021;

i) Projektit i-PROCEEDS-2⁷ organizoi kursin online “Hyrje në Rrjetet Kompjuterike”, ku kanë marrë pjesë një prokuror dhe një përfaqësues i Policisë së Shtetit.

ii) Projekti i-PROCEEDS-2⁸ organizoi seminarin online me objektiv rritjen e aftësive në “Bashkëpunimin ndërkombëtar dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet njësive të krimit kibernetik, njësive të hetimit financiar dhe njësive të inteligjencës financiare (FIU), si dhe ndërmjet autoriteteve kompetente për bashkëpunim gjyqësor”, ku kanë marrë pjesë katër prokurorë.

iii) Trajnim online, nga Këshilli i Evropës⁹, mbi hetimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave, ku kanë marrë pjesë 35 prokurorë.

iv) Në kuadër të Projektit i-PROCEEDS-2¹⁰, të Këshillit të Evropës është organizuar “Workshopi Rajonal lidhur me përmirësimin e aftësive dhe zhvillimin hap pas hapi të udhëzimeve/standardeve për hartimin e kërkesave për ndihmë juridike për çështjet penale që kanë të bëjnë me krimet kompjuterike dhe provat elektronike” i zhvilluar online, ku kanë marrë pjesë gjashtë prokurorë.

v) Prezenca e OSBE-së në Shqipëri¹¹, Policia e Shtetit Shqiptar dhe Akademia e Sigurisë, organizuan seminarin “Mbi Parandalimin dhe Hetimin e Krimeve Kibernetike”, ku mori pjesë një prokuror.

vi) Projekti i-PROCEEDS-2¹² i CoE, organizoi trajnimin rajonal në lidhje me njohjen e “Udhëzuesit për sekuestrimin e kriptomonedhave dhe ushtrimin praktik për sekuestrimin e aseteve virtuale”, ku mori pjesë një prokuror.

vii) Projekti i-PROCEEDS-2¹³ i CoE, në bashkëpunim me përfaqësues të Prokurorisë, Policisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe AKCESK organizoi Workshop online mbi tendencat e krimit kibernetik

⁷ Projekt i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për evidentimin e të ardhurave nga krimi në internet dhe sigurimin e provave elektronike në Evropën Juglindore dhe Turqi, në 11 Janar 2021 organizoi kursin online “Hyrje në Rrjetet Kompjuterike” ku janë ofruar njohuri të përgjithshme dhe praktike të rrjeteve, duke përdorur praktikën, teknologjitë dhe teknikat më të fundit dhe më të mira në dispozicion të oficerëve të zbatimit të ligjit dhe u drejtohet kryesisht specialistëve të ekspertizës dixhitale.

⁸ Projekt i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për evidentimin e të ardhurave nga krimi në internet dhe sigurimin e provave elektronike në Evropën Juglindore dhe Turqi, më datë 31 mars 2021 organizoi seminarin online mbi funksionimin dhe rolin e rrjeteve të pikave të kontaktit 24/7 në bashkëpunimin ndërkombëtar për krimin kibernetik dhe provat elektronike, me objektiv rritjen e aftësive në “Bashkëpunimin ndërkombëtar dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet njësive të krimit kibernetik, njësive të hetimit financiar dhe njësive të inteligjencës financiare (FIU), si dhe ndërmjet autoriteteve kompetente për bashkëpunim gjyqësor”.

⁹ Trajnimi online i organizuar me 26 maj 2021 nga Këshilli i Evropës, mbi hetimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave në kuadër të Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, të bashkëfinancuar nga BE dhe Këshilli i Evropës, kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri ka për qëllim mbështetjen e autoriteteve shqiptare në kuadrin e rekomandimeve të Komitetit monitorues të KiE për vlerësimin e masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit MONEYVAL”.

¹⁰ Projekt i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, organizuar më datë 29 qershor 2021

¹¹ Prezenca e OSBE-së më datë 29 qershor 2021 organizuan seminarin “Mbi Parandalimin dhe Hetimin e Krimeve Kibernetike” në format hibrid (prezencë fizike dhe virtuale), duke ofruar mundësinë për shkëmbimin e përvojës dhe bashkëpunimin në nxitjen e parandalimit dhe hetimit të krimeve kibernetike. Seminari mundësoi që ekspertët kombëtarë dhe ndërkombëtarë në këtë fushë të njihen me zhvillimet më të fundit në fushën e parandalimit të krimit kibernetik, ndanë përvojën mbi dokumentet strategjike, të cilat përcaktojnë përparësitë dhe politikat kombëtare në trajtimin e këtij fenomeni, si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në hetimin e rasteve të krimit kibernetik”.

¹² Projekt i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, më datat 16-19 gusht 2021 organizoi trajnimin rajonal në lidhje me njohjen e “Udhëzuesit për sekuestrimin e kriptomonedhave dhe ushtrimin praktik për sekuestrimin e aseteve virtuale”. Ky aktivitet rajonal bashkoi të gjithë profesionistët përkatës nga vendet dhe zonat që në aktivitetet e tyre të përditshme ndeshen dhe janë të përfshirë në gjetjen dhe sekuestrimin e monedhave virtuale.

¹³ Projekt i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, në bashkëpunim me përfaqësues të Prokurorisë, Policisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe AKCESK (Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike) më datë 25 tetor 2021 organizoi Ërkshop online mbi tendencat e krimit kibernetik dhe të sigurisë kibernetike si dhe për statistikën e drejtësisë penale në Shqipëri. Ky aktivitet u zhvillua nga ekspertë ndërkombëtarë me objektiv prezantimin e rolit dhe rëndësisë së një qasjeje strategjike, elementeve të raportit kombëtar për krimin kibernetik dhe të provave elektronike (aktorët, struktura, etj.) dhe përdorimi i statistikave të drejtësisë

dhe të sigurisë kibernetike si dhe për statistikën e drejtësisë penale në Shqipëri, ku morën pjesë katër prokurorë.

viii) Projekti i-PROCEEDS-2¹⁴ ka organizuar një trajnim Rajonal për rritjen e aftësive, zhvillimin e udhëzimeve standarde hap pas hapi për hartimin dhe përpunimin e kërkesave për ndihmë juridike të ndërsjellë (MLA) për çështjet penale që përfshijnë krimin kibernetik dhe provat elektronike, ku morën pjesë dy prokurorë.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, kërkesën e rezolutës dhe rekomandimin prioritar të KM e konsiderojmë të realizuar, për faktin se janë zbatuar masat dhe kryer aktivitetet për organizimin, krahas trajnimeve vazhduese të prokurorëve në Shkollën e Magjistraturës sipas programit të sugjeruar dhe nga vetë prokurorët, ashtu dhe realizimin e trajnimeve të përbashkëta të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve ose agjencive të tjera policore e ligjzbatuese në bashkëpunim dhe me mbështetjen e misionëve dhe projekteve ndërkombëtare që asistojnë sistemin e drejtësisë penale përfshi dhe prokurorinë, me synim forcimin e kapaciteteve profesionale të tyre për rritjen e efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit dhe forcimin e ligjshmerisë në ushtrimin e funksioneve, duke garantuar pavarësinë e prokurorit.

1.6 Në zbatim të kërkesës së Rezolutës “Të përgatitet në një kohë sa më të shpejtë një manual për hetimet dhe ndjekjen penale të grupveprave të trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe të organizohen trajnime në këtë fushë me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të prokurorisë dhe agjencive të zbatimit të ligjit për një përgjigje më të mirë ndaj trafikimit dhe shfrytëzimit të qenieve njerëzore, mbrojtjen më të mirë të viktimave dhe në veçanti grave dhe fëmijëve në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me OSBE-në, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.6.1 Në kuadrin e Memorandumit të Mirëkuptimit miratuar me nr.627, datë 13.04.2021 mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prezencës së OSBE-së “Për bashkëpunimin dhe bashkërendimin në zbatimin e projekteve dhe veprimtarive në mbështetje të efikasitetit të sistemit të prokurorisë shqiptare”, Shtojca II, fokuson “Veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri” dhe ka si objektiv të projektit, dhënien e kontributit drejt një pakësimi të përgjithshëm të përhapjes së trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri dhe nga Shqipëria.

1.6.2 Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në realizimin e këtij projekti kanë zhvilluar aktivitetet e planifikuara, siç janë:

i) Aktiviteti “Tryeza tematike mbi hetimin e veprave penale të trafikimit të personave”, është zhvilluar me datë 29 qershor 2021, me temë “Hetimi i veprave penale të trafikimit, risitë në legjislacionin penal, qasja e bazuar në të drejtat e viktimes së trafikimit”, ku kanë marrë pjesë 10

për krimin kibernetik dhe provat elektronike bazuar në Udhëzuesin përkatës që është zhvilluar në kuadër të Zyrës së Programit të Krimit Kibernetik, në CoE.

¹⁴ Projekt i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, më datat 2-3 dhjetor 2021 ka organizuar një trajnim Rajonal për rritjen e aftësive, zhvillimin e udhëzimeve standarde hap pas hapi për hartimin dhe përpunimin e kërkesave për ndihmë juridike të ndërsjellë (MLA) për çështjet penale që përfshijnë krimin kibernetik dhe provat elektronike. Në këtë trajnim u prezantua edhe draftprotokolli i dytë i Konventës së Budapestit.

prokurorë dhe kordinatorë të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm. Ndërsa, me datë 30 qershor 2021 është zhvilluar tema “Interesi më i lartë i fëmijës viktimë e trafikimit në procesin penal”, ku kanë marrë pjesë 10 prokurorë dhe kordinatorë të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

ii) Aktiviteti “Trajnimi simulues”, është zhvilluar me datat 19-21 tetor 2021, me temë “Trajnimi simulues ndërinstytucional për hetimin e trafikimit të personave dhe identifikimin e viktimave” me synim të përmirësojë hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore si dhe identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave të këtij krimi, ku kanë marrë pjesë 6 prokurorë dhe kordinatorë të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

iii) Aktiviteti “Krimikibernetik dhe trafikimi”, është zhvilluar në nëntor 2021, me temë “Workshop mbi rolin e teknologjisë në veprat penale të trafikimit”, ku kanë marrë pjesë 2 prokurorë.

1.6.3 Në lidhje me kërkesën e Rezolutës “Për përgatitjen në një kohë sa më të shpejtë një manual për hetimet dhe ndjekjen penale të grupveprave të trafikimit të qenieve njerëzore...”, sqarojmë se për vitin 2021 në shtojcën II “Veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri” të këtij projekti nuk është parashikuar përgatitja e manualit për hetimet dhe ndjekjen penale të grupveprave të trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe nisur nga fakti se Memorandumi i Mirëkuptimit mes Prezencës së OSBE-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme nuk është lidhur me kohëzgjatje të përcaktuar, mbetet detyrë dhe angazhim institucional i prokurorisë për të ardhmen që në kuadrin e këtij bashkëpunimi të mundësohet përgatitja e manualit për hetimet dhe ndjekjen penale të grupveprave të trafikimit të qenieve njerëzore në standardet evropiane.

 Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar këtë kërkesë të rezolutës, për faktin se, janë organizuar trajnime për hetimin e trafikimit të personave dhe identifikimin e viktimave me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të prokurorisë dhe agjencive të zbatimit të ligjit për një përgjigje më të mirë ndaj trafikimit dhe shfrytëzimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen më të mirë të viktimave dhe në veçanti grave dhe fëmijëve në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me prezencën e OSBE-së, si dhe janë marrë masa që kanë vënë në lëvizje përgatitjen e manualit për hetimet dhe ndjekjen penale të grupveprave të trafikimit të qenieve njerëzore në standardet evropiane, proces që tejkalon vitin objekt raportimi.

1.7 Në zbatim të kërkesës së Rezolutës të Kuvendit “***Të forcohet bashkërendimi, koordinimi dhe roli monitorues i Prokurorisë së Përgjithshme për të siguruar mirëfunksionimin e sistemit të prokurorisë në përputhje me parashikimet ligjore, duke e vënë theksin tek rritja e bashkëpunimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD) dhe KLP-në në drejtim të koordinimit të aktiviteteve, shkëmbimit të informacionit, identifikimit të shkeljeve disiplinore ose etike dhe adresimit të problemeve që hasen në prokuroritë e të gjithave niveleve***”, kërkesë që përkon dhe me rekomandimin e KM për “***Nxitjen e prokurorëve që të ushtrojnë kontroll efektiv në punën e OPGJ-ve, si dhe evidentimin e rasteve që duhen proceduar në rrugë disiplinore për shkak të zvarritjeve dhe mungesës së dilijencës në përmbushjen e detyrave që u ngarkon ligji***”, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet, si më poshtë:

1.7.1 Në kuadrin e forcimit të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit, të vetëdijshëm për nevojën dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD) në kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike, dhe për shkeljet individuale të magjistratëve/prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, Prokurori i Përgjithshëm dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit, me nr.248, datë 05 shkurt 2021 “Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve/prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.

i) Në kuadrin e zbatimit të kësaj marrëveshje, mbi kërkesën e ILD-së, me shkresën/kërkesën nr.483/1, datë 24 maj 2021, Prokuroria e Përgjithshme në zbatim të kompetencave kushtetuese¹⁵ e ligjore¹⁶, ka informuar se përgjatë vitit 2020 dhe në vijim, ka evidentuar problematika, siç janë shkelja e akteve ligjore dhe nënligjore, si për dërgimin në Prokurorinë e Përgjithshme të raporteve vjetore mbi ecurinë e punës për vitin 2020, ashtu dhe për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të detyrueshme lidhur me veprimtarinë administrative dhe funksionale në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës parë me juridiksion të përgjithshëm. Për këto arsye, në mbështetje të nenit 38 pika 2 shkronja “i” e ligjit nr.97/2016 “Për organizimin e funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Prokurori i Përgjithshëm ka kërkuar kryerjen e inspektimeve tematike në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Shkodër e Vlorë.

ii) Përgjatë vitit 2021 për shkelje individuale të konstatuara në tre raste, siç janë, -një magjistrat/prokuror në një prokurori rrethi gjyqësor; -dy magjistratë/prokurorë dhe drejtuesi i Prokurorisë të një rrethi gjyqësor; dhe -një magjistrat/prokuror në një prokurori rrethi tjetër gjyqësor, është përgatitur materiali dhe i janë dërguar për iniciim të procesit të hetimit/inspektimit Institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

1.7.2 Gjithashtu, në kuadrin e zbatimit të kësaj kërkesë të Rezolutës dhe rekomandimit prioritar të KM, me synim shkëmbimin e informacionit, identifikimit të shkeljeve disiplinore ose etike dhe adresimit të problemeve që hasen në prokuroritë e të gjithave niveleve, u përgatit dhe u miratua Udhëzimi i Përgjithshëm nr.10/2021 “Për funksionimin e strukturës së monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkërendimi me institucionet kushtetuese e ligjore”, me synim dhe për iniciimin e inspektimeve tematike në strukturat përkatëse ose hetimeve për shkelje individuale të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve policore sipas ligjit, në bashkëpunim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Komisionin e Policisë Gjyqësore, për të siguruar ushtrimin e funksioneve dhe mbarëvajtjen, efikasitetin, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e sistemit të prokurorisë, ku përfshihet dhe veprimtaria e policisë gjyqësore.

1.7.3 Në kuadrin e forcimit të kontrollit dhe llogaridhënies së oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve pranë prokurorive, dhe bashkërendimit institucional me Komisionin e Policisë Gjyqësore (në vijim Komisioni), Prokurori i Përgjithshëm i është drejtuar katër herë Komisionit, konkretisht:

¹⁵ Shih nenin 148/b shkronjat “b”, “c” e “dh” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

¹⁶ Shih nenin 38 pika 2 shkronjat “b”, “c” e “f” “I”, “k” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në R.Sh”;

i) Mbi bazën e aktkontrollit të realizuar në seksionin e policisë gjyqësore pranë një prokurorie të rrethit gjyqësor, me shkresë nr. 958 datë 15.06.2021 është propozuar fillimi i hetimeve për shkelje disiplinore për dy oficerë të policisë gjyqësore;

ii) Mbi Rekomandimin e Avokatit të Popullit datë 17.03.2021, dhe mbi bazën e verifikimeve të kryera nga Sektori i Monitorimit, me shkresën nr 190/3 datë 01.07.2021, është propozuar fillimi i hetimeve për shkelje disiplinore për oficerin e policisë gjyqësore të një komisariati policie, për kryerjen e shkeljeve procedurale gjatë kryerjes së veprimtarisë hetimore;

iii) Me shkresën nr.1482 datë 19.10.2021, është propozuar fillimi i hetimeve për shkelje disiplinore për dy oficerë të seksionit të policisë gjyqësore pranë një prokurorie;

iv) Me shkresën nr.985/1 datë 13.07.2021, është kërkuar pezullimi i oficerit të policisë gjyqësore pranë një prokurorie rrethi gjyqësor, me arsyetimin se është nën masën e sigurimit arrest në burg i dyshuar për kryerjen e një vepre penale e cila ka të bëjë me detyrën e tij.

1.7.4 Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional, referuar në informacionin e Komisionit të Policisë Gjyqësore, përgjatë vitit 2021 ky Komision në zbatim të kompetencave sipas ligjit¹⁷ për përgjegjësinë disiplinore të oficerëve të policisë gjyqësore, bazuar në propozimet e dërguara nga prokurorët e çështjeve dhe Prokurori i Përgjithshëm, ka urdhëruar dhe zhvilluar procedimin disiplinor për 10 oficerë të policisë gjyqësore, nga të cilët 7 persona janë oficerë të policisë gjyqësore të shërbimeve në Policinë e Shtetit dhe 3 persona janë oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorive. Ndërkohë, Komisioni për 8 oficerë të policisë gjyqësore ka vendosur, dhënien e disa masave disiplinore në raport me shkeljet e kryera, ndërsa për dy oficerë të policisë gjyqësore ka pushuar procedimin disiplinor.

1.7.5 Prokuroria e Përgjithshme ka konsideruar dhe konsideron thelbësore bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, si organi përgjegjës për karrierën e prokurorëve. Bashkëveprimi i të dy institucioneve është i domosdoshëm për mbarëvajtjen e sistemit të prokurorisë në këto rrethana aspak normale, për të mundësuar koordinimin ndërinstitucional në rastet e emërimeve të magjistratëve të rinj, transferimeve, caktimeve të përkohshme apo komandimeve të magjistratëve/prokurorë, me synim për të shmangur cënimin e parimit të funksionalitetit dhe/ose rëndimin e gjendjes të shkaktuar nga vakancat në prokurori.

🚩 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të realizuar këtë kërkesë të rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimin prioritar të KM, për faktin se Prokurori i Përgjithshëm dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit, me nr.248/2021 “Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve/prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” është hartuar Udhëzimi i Përgjithshëm nr.4/2021 për rekomandimet prioritare të KM në luftën kundër kriminalitetit, si dhe është rritur bashkëpunimi me ILD dhe KLP në drejtim të koordinimit të aktiviteteve, shkëmbimit të

¹⁷ Shih, nenin 10 pika 1, gërma “ç” në lidhje me nenet 32 – 39 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.

informacionit, identifikimit të shkeljeve disiplinore dhe adresimi i tyre për kryerjen e hetimeve disiplinore nga institucionet përkatëse.

1.8 Në zbatim të kërkesës së Rezolutës “Të miratohen projektudhëzimet e përgjithshme “Për funksionimin e strukturës së monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkërendimi me institucionet kushtetuese përkatëse” dhe “Për krijimin dhe funksionimin e grupeve të hetimit për çështje të veçanta në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, punë që po kryhet në bashkëpunim me misionin EURALIUS V”, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.8.1 Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar dhe ka ngritur dy grupe pune, ku janë ftuar dhe kanë marrë pjesë përfaqësues të projektit EURALIUS V, me objekt përgatitjen e projektudhëzimit “Për funksionimin e strukturës së monitorimit në sistemin e prokurorisë” dhe përgatitjen e projektudhëzimit “Për krijimin dhe funksionimin e grupeve të hetimit për çështje të veçanta në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, me synim hartimin dhe miratimin e dy projektudhëzimeve në përfaqje me standardet dhe praktikën e mira evropiane.

1.8.2 Në përmbushje të kësaj kërkesë të rezolutës, grupi i punës i Prokurorisë së Përgjithshme në bashkëpunim me ekspertët e projektit EURALIUS V, ka përgatitur dhe me datë 30.12.2021 është miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm Udhëzimi i Përgjithshëm nr.10 “Për funksionimin e strukturës së monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkërendimi me institucionet kushtetuese e ligjore”. Ky udhësim synon unifikimin e ushtrimit të funksioneve mbikëqyrëse dhe verifikuese nga strukturat përkatëse dhe/ose nga autoriteti i monitorimit në sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, për të garantuar zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme, dhe si kanë ndikuar ato në efikasitetin dhe/ose efektivitetin e ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë në drejtimet e udhëzuara dhe/ose rekomanduara, si dhe për iniciimin e inspektimeve tematike në strukturat përkatëse ose hetimeve disiplinore për shkelje individuale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve sipas ligjit në bashkëpunim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Komisionin e Policisë Gjyqësore, për të siguruar pavarësinë/autonominë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve dhe mbarëvajtjen, efikasitetin, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e sistemit të prokurorisë.

i) Ky udhëzim i përgjithshëm përcakton rregullat për mënyrën e mbikëqyrjes të zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme, veprimtarisë së policisë gjyqësore dhe marrjes së informacionit nga strukturat në Prokurorinë e Përgjithshme në bashkërendim me autoritetin e monitorimit/mbikëqyrjes në prokuroritë përkatëse, si dhe mënyrën e mbikëqyrjes dhe verifikimit të indiceve, informacioneve ose ankesave për problematikat apo shkeljet e konstatuara apo të pretenduara dhe bashkëpunimin me strukturat përkatëse në prokurori dhe me institucionet kushtetuese dhe ligjore.

1.8.3 Ndërkohë, në përmbushje të kësaj kërkesë të rezolutës, Prokuroria e Përgjithshme i kërkoi projektit EURALIUS V të mundësojë sigurimin e informacionit mbi standardet dhe/ose praktikën e mira evropiane, sa i përket krijimit dhe funksionimit të grupeve të hetimit për çështje të veçanta në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, me synim shmangien e problematikave të evidentuara

në veprimtarinë funksionale të grupeve hetimore për çështje të veçanta, si në fazën e hetimeve paraprake, ashtu dhe në përfaqësimin e akuzës në gjykatë.

i) Në dokumentin datë 20.04.2021 të ekspertëve të EURALIUS-it V, i emërtuar “Shënim: Projektudhëzimi për krijimin e grupeve hetimore për çështje të veçanta”, në pjesën hyrëse nënvizohet se: “Grupi i punës ra dakort që ligji parashtron vetëm kompetencën e Drejtuesit të Prokurorisë për të krijuar Grupin Hetimor për çështje të veçanta, por ai nuk përcakton kompetencat e tij dhe nuk rregullon mënyrën e vendimmarrjes për rastet kur lindin mosmarrëveshje dhe mendime të kundërta midis anëtarëve prokurorë të grupit. Një shqetësim tjetër ligjor lidhet gjithashtu me përkufizimin e termave “çështje të veçanta” dhe “Grupe hetimore”, të cilat nuk trajtohen në Ligjin për Prokurorinë dhe as në Kodin e Procedurës Penale”

ii) Mangësitë ligjore të evidentuar dhe nga ekspertët e Projektit EURALIUS V të përfshirë në grupin e punës së përbashkët për hartimin e këtij projektudhëzimi kanë ndikuar në mospërfundimin e këtij projektudhëzimi të përgjithshëm, deri në përmirësimin e pritshëm nëpërmjet ndryshimeve e shtesave të nevojshme në nenin 42 të ligjin nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të realizuar kërkesën e rezolutës, përsa i përket miratimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.10/2021 “Për funksionimin e strukturës së monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkërendimi me institucionet kushtetuese e ligjore”, që ka unifikuar ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse dhe verifikuese nga strukturat përkatëse dhe/ose nga autoriteti i monitorimit në sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, për të garantuar zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme dhe si kanë ndikuar ato në efikasitetin dhe/ose efektivitetin e ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë në drejtimet e udhëzuara dhe/ose rekomanduara.

✚ Ndërkohë, e konsiderojmë pjesërisht të realizuar dhe vijon puna e nisur për projektudhëzimin e përgjithshëm “Për krijimin dhe funksionimin e grupeve të hetimit për çështje të veçanta në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, për faktin se mangësitë ligjore të evidentuara dhe nga ekspertët ndërkombëtarë të përfshirë në grupin e punës së përbashkët për hartimin e këtij projektudhëzimi përbëjnë shkaqe objektive që kanë ndikuar në mospërfundimin e këtij aktiviteti, i cili do të vijojë deri në përmirësimin e pritshëm të ndryshimeve e shtesa të nevojshme në nenin 42 të ligjin nr.97/2016.

1.9 Në zbatim të kërkesës së Rezolutës “Të ndërmerren hapa konkretë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Policinë e Shtetit, gjykatat dhe institucionet e tjera shtetërore për të filluar krijimin e sistemit të unifikuar të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave të kriminalitetit, bazuar në standardet ndërkombëtare”, kërkesë që përkon dhe me një rekomandim prioritarë të KM për “Pasurimin e sistemit statistikor të monitorimit të çështjeve të pastrimit të parave për të siguruar një bazë të besueshme për reforma të mëtejshme për të rritur numrin e procedimeve penale dhe dënimeve për veprat penale të pastrimit të parave” janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.9.1 Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar dhe ka vijuar bashkëpunimin me ekspertët e projektit EURALIUS V, me objekt përmirësimin dhe funksionimin e sistemit statistikor, sistemit të analizës dhe dixhitalizimit të komunikimeve, si dhe në pamundësi të vënies në funksionim të sistemit CAMS ka vijuar puna për hartimin e një programi statistikor PRESTO për sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm. Ky program statistikor PRESTO, me përfundimin e Projektit EURALIUS V, mbetet i pa realizuar. Në këto rrethana nga Prokuroria e Përgjithshme po bëhen përpjekje duke e ndarë procesin në dy faza, -atë të ndërmjetme/emergjente për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të programit PRESTO për përfundimin e një sistemi statistikor fleksibël me potencial përfshirjen edhe të dhënave statistikore të tjera sipas nevojave, dhe faza përfundimtare në kuadër të sistemit të integruar që është objektivi final i Prokurorisë së Përgjithshme në kuadrin e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve.

1.9.2 Në zbatim të kësaj kërkesë të Rezolutës dhe në zbatim të planit të veprimit ICRG/FATF-Shqipëri, me mbështetjen e Projektit EURALIUS V, u përgatit sistemi elektronik e-tracking PRESTO, për implementimin e të cilit Prokurori i Përgjithshëm nxori Urdhrin nr.92 datë 30.07.2021 “Për përdorimin e regjistrit elektronik dhe përfundimin e statistikave për çështje të pastrimit të parave në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”, i cili ju dërgua strukturave të posaçme dhe prokurorëve të dedikuar së bashku me manualin e përdorimit të këtij sistemi elektronik, me synim për të përfunduar të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse, më të hollësishme dhe të besueshme, si dhe për të evidentuar arritjet dhe problematikat për këtë grup veprash penale. Gjithashtu, në këtë sistem pasqyrohet historiku dhe ecuria e veprimeve verifikuese e gjurmuese policore për grupveprat penale të pastrimit të parave, sipas parashikimeve në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.10/2020 dhe sipas treguesve në formatin track rekords të përbashkët (polici-prokurori). Ky urdhrë për efekte të masave organizative/administrative përgatitore ka hyrë në fuqi menjëherë me 30.07.2021, ndërsa veprimtaria për përdorimin e regjistrit elektronik e-tracking PRESTO ka filluar me 1 shtator 2021.

1.9.3 Gjithashtu, në kuadrin e zbatimit të planit të veprimit FATF/ICRG, Ministria e Drejtësisë ka ngritur një sistem të centralizuar të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë dhe vendase, ndërkohë Prokuroria e Përgjithshme po përmirëson sistemin IMPRO për realizimin e ndërlidhjes me Sistemin e Ministrisë së Drejtësisë. Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional, Ministria e Drejtësisë ka mundësuar dhënien e drejtës së përdorimit të sistemit M-File (MD) për dy përdorues të Prokurorisë së Përgjithshme, si zgjidhje e përkohshme deri në përmirësimin e sistemit IMPRO, që do të mundësojë ndërlidhjen e dy sistemeve IMPRO dhe M-File.

1.9.4 Në zbatim të kësaj kërkesë të Rezolutës për të filluar krijimin e sistemit të unifikuar të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave të kriminalitetit, bazuar në standardet ndërkombëtare, Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr.977, datë 27.09.2021 me lëndë “Për zbatimin e kërkesës në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë datë 14.06.2021...” drejtuar Ministrisë së Drejtësisë i ka kërkuar angazhimin institucional dhe nevojën e koordinimit ndërinstitucional si dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve të përfshira sipas ligjit, për të filluar krijimin e sistemit të unifikuar të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave të kriminalitetit dhe

drejtësisë, bazuar në standardet ndërkombëtare sipas kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.

i) Ministria e Drejtësisë me shkresën nr.4761/2 datë 12.11.2021 ka njoftuar emrat e personave me të cilët do të përfaqësohet në këtë proces, duke e lënë pa zgjidhje ecurinë e mëtejshme të organizimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional për zbatimin e kësaj kërkesë të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.

1.9.5. Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Drejtësisë po vijojnë bashkëpunimin me INSTAT në kuadër të implementimit të Nomenklaturës Ndërkombëtare të Krimeve për Qëllime Statistike.

1.9.6 Me Ministrinë e Drejtësisë vijon bashkëpunimi lidhur dhe me procesin e raportimit periodik të të dhënave të harmonizuara për strukturat e Bashkimit Evropian, dhe do të vijojmë të jemi po kështu bashkëpunues në çdo iniciativë për qëllime statistikore, dhe jo vetëm.

 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, kjo kërkesë e rezolutës dhe rekomandim i KM, e konsiderojmë të realizuar pjesërisht lidhur me masat/aktivitetet e realizuara më sipër, për faktin se kemi shprehur gatishmërinë institucionale të prokurorisë për bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera të përfshira dhe përgjegjëse për krijimin e sistemit të unifikuar të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave të kriminalitetit sipas standardeve ndërkombëtare.

1.10 Në zbatim të kërkesës së Rezolutës “Krahas statistikave që publikohen tashmë, të mbledhë, të përpunojë dhe të publikojë të dhëna për viktimat e veprave penale dhe kostot e krimit, për kriminalitetin e kryer nga të miturit, femrat, veprat penale me motive diskriminuese”, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.10.1 Në përmbushje të kësaj kërkesë të Rezolutës, lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave për viktimat e veprave penale, me datë 28. 07.2021 Prokurori i Përgjithshëm miratoi Urdhrin nr.87 “Për miratimin e rregullave për përdorimin e sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur”, në zbatim të të cilit prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm përdorin Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, në përputhje me qëllimin e parashikuar në ligj¹⁸, aktet nënligjore¹⁹ dhe rregullat e përcaktuara në këtë urdher. Ky sistem pasurohet me të dhëna elektronike të përditësuara mbi çështjet penale në të cilat përfshihen të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga veprat penale, si dhe mbi vijueshmërinë e procedimeve penale për këto vepra, deri në fazën e përfundimit të ekzekutimit të vendimeve, me synim mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave edhe për viktimat të mitur dhe femra nga vepra penale.

¹⁸ Shih, nenin 136 të ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur”;

¹⁹ Shih, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.149, datë 20.03.2019 “Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit e aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësën e informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur”;

1.10.2 Në kuadrin e kësaj rezolute, Prokurori i Përgjithshëm miratoi dhe Udhëzimin e Përgjithshëm nr.8, datë 15.11.2021 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitar” me synim rritjen e efikasitetit, efektivitetit dhe reduktimin e afateve, në hetimin dhe ndjekjen penale të çështjeve me/dhe ndaj të miturve, në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitar, të udhëhequr nga parimet e një drejtësie penale sa më miqësore dhe i interesit më të lartë të të miturit si dhe garantimi i të drejtave të tyre, në mënyrë që të kontribuohet në uljen e kriminalitetit të të miturit, në rehabilitimin, riintegrimin dhe eliminimin e dhunës ndaj tyre. Ky udhëzim ka unifikuar dhe disa procedura e akte procedurale penale në çështjet me të mitur, në përputhje me praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare në drejtësinë penale për të mitur.

1.10.3 Në përmbushje të kësaj kërkesë të Rezolutës lidhur me raportimin e kostos së procedimit penal, Prokurori i Përgjithshëm miratoi Udhëzimin e Përgjithshëm nr.6, datë 23.07.2021 “Për disa ndryshime e shtesa në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.08, datë 19.05.2020 “Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, me synim për të qartësuar parashikimin se shpenzimet procedurale të parapaguara nga shteti raportohen periodikisht, për çdo procedim penal, në shumën/vlerën totale në rubrikën përkatëse, si dhe se ngarkohen zyrat e financës në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm të raportojnë periodikisht shpenzimet procedurale të parapaguara nga shteti, sipas veprave penale e zërave përkatëse për çështjet e përfunduara dhe vlera/shuma totale e tyre, për periudhat 3, 6, 9 mujore e vjetore, në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financës në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila përllëgarit kostot e shpenzimeve procedurale penale sipas veprave penale e zërave përkatëse për procedimet penale të përfunduara dhe vlera/shuma totale e tyre sipas prokurorive.

1.10.4 Në këtë vështrim, në përmbushje të kësaj kërkesë të rezolutës, Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2021 në Kuvendin e Shqipërisë, në përmbajtje krahas analizës e vlerësimit të treguesve të tjerë statistikorë, do të trajtojë dhe publikojë dhe të dhëna për viktimat e veprave penale dhe kostot e krimit, për kriminalitetin e kryer nga të miturit dhe femrat në konflikt me ligjin.

🚩 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar kërkesën e rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimin e KM, për faktin se janë miratuar, si Udhëzimi i Përgjithshëm nr.8/2021 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe ose dëshmitar” me synim rritjen e efikasitetit, efektivitetit në hetimin dhe ndjekjen penale të çështjeve me/dhe ndaj të miturve, në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitar, ashtu dhe Urdhri nr.87/2021 “Për miratimin e rregullave për përdorimin e sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur” me synim mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave edhe për viktimat të mitur dhe femra nga vepra penale, si dhe po zbatohen në sistemin e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm. Gjithashtu, është miratuar Udhëzimi i Përgjithshëm nr.6/2021 “Për disa ndryshime e shtesa në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.08/2020 “Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, me synim për të qartësuar dhe publikuar shpenzimet procedurale të parapaguara nga shteti dhe kostot e krimit.

1.11 Në zbatim të kërkesës së Rezolutës “Të përshpejtojë punën e nisur për identifikimin e problemeve në “sistemin e menaxhimit të çështjeve” (CAMS) dhe të marrë masa konkrete të një sistemi funksional sipas nevojave të organit të prokurorisë dhe për të mundësuar dixhitalizimin e informacionit” kërkesë që përkon me rekomandimin e KM “**Marrjen e masave, me qëllim rishikimin dhe mirëfunksionimin e sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve në Prokurori (sistemi CAMS), për sa i përket mënyrës së disponimit për çështje konkrete, gjykimet e posaçme, pasqyrimin e saktë të të dhënave në sistemin CAMS në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe kontrolli i vazhdueshëm mbi hedhjen dhe administrimin e këtyre të dhënave**” është zhvilluar aktiviteti si më poshtë:

1.11.1 Në kuadrin e zbatimit të kësaj kërkesë të Rezolutës, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar punën e nisur në grupin e punës me mbështetjen e Projektit EURALIUS V për identifikimin e problemeve në “sistemin e menaxhimit të çështjeve” (CAMS), i cili nuk është funksional. Ekspertët e EURALIUS V kanë bërë analizën teknike të CAMS dhe në konsultimet e opsioneve të parashtruara dhe diskutuara me ekspertët, grupi i punës ka arritur në përfundimin se opsioni më i mirë mbetet një sistem i ri për menaxhimin e çështjeve. Tashmë janë hedhur hapat e parë për një sistem të integruar të menaxhimit të çështjeve, proces që drejtohet nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor.

1.11.2 Ekspertët e Projektit EURALIUS në bashkëpunim me Drejtorinë e IT-së në Prokurorinë e Përgjithshme kanë vijuar punën për krijimin e sistemit PRESTO. Në këtë kuadër, siç u trajtua në pikën “1.9” më sipër, është bërë e mundur krijimi i sistemit e-tracking PRESTO i cili në zbatim të urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm nr.92 datë 30.07.2021 “Për përdorimin e regjistrin elektronik dhe përfitimin e statistikave ...”, është bërë implementimi i këtij sistemi, janë bërë trajnime të përdoruesve të sistemit në gjithë prokuroritë, si dhe është prodhuar një manual përdorimi praktik për përdoruesit.

1.11.3 Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar dhe ka vijuar bashkëpunimin me ekspertët e projektit EURALIUS V, me objekt përmirësimin dhe funksionimin e sistemit statistikor, sistemit të analizës dhe digjitalizimit të regjistrave në prokurori, si dhe në pamundësi të vënies në funksionim të sistemit CAMS ka vijuar puna për hartimin e një programi statistikor PRESTO për sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, të trajtuar dhe në kërkesën 1.9 të Rezolutës së Kuvendit.

 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, kërkesën e rezolutës dhe rekomandimin e KM, e konsiderojmë të realizuar pjesërisht lidhur me masat/aktivitetet e realizuara më sipër, si dhe është në proces dhe po ndiqet ecuria për sistemin CAMS, për faktin, grupi i punës ka arritur në përfundimin se opsioni më i mirë mbetet një sistem i ri për menaxhimin e çështjeve, masë e përfshirë në Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsëktoriale të Drejtësisë e miratuar në dhjetor 2021, si dhe janë hedhur hapat e parë për një sistem të integruar të menaxhimit të çështjeve, proces që drejtohet nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor.

1.12 Në zbatim të kërkesës së Rezolutës së Kuvendit ***“Të nxitet dhe të bashkëpunohet për ngritjen e strukturave hetimore nga Policia e Shtetit sipas ligjit,*** është zhvilluar aktiviteti si më poshtë:

1.12.1 Në zbatim të kësaj kërkeje të Rezolutës, Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr.977/5, datë 27.09.2021 me lëndë “Për zbatimin e kërkesës në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë datë 14.06.2021...” drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe për dijeni Ministrisë së Brendshme, në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional, në mbështetje të kuadrit ligjor dhe në zbatim të kërkesës në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, ka kërkuar dhe nxitur ngritjen sipas ligjit të strukturave hetimore në shërbimet e policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit, duke ju shprehur gatishmërinë për kontributin institucional të prokurorisë në zbatimin e ligjit dhe kësaj kërkeje të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë. Veç të tjerave, në kërkeje i është sjellë në vëmendje se në këtë vështrim dhe në kuptim e interpretim të këtij kuadri ligjor të posaçëm, për të ushtruar funksionet e oficerit të policisë gjyqësore në zbatim të nenit 31 e vijues të K.Pr.Penale, oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve në policinë e shtetit duhet të jenë të organizuar në strukturë hetimore përkatëse sipas parashikimeve në nenin 2 pika 6 dhe nenin 12 pika 2 e vijues të ligjit nr.25/2019.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, kërkesën e rezolutës e konsiderojmë të realizuar pjesërisht lidhur me aktivitetin e realizuar më sipër, për faktin se kemi nxitur ngritjen sipas ligjit të strukturave hetimore në shërbimet e policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit, duke ju shprehur dhe gatishmërinë për kontributin institucional të prokurorisë në zbatimin e ligjit dhe kësaj kërkeje të rezolutës së Kuvendit.

1.13 Në zbatim të kërkesës së Rezolutës ***“Të angazhohet për forcimin e kapaciteteve të analizës dhe studimeve për kriminalitetin, format e shfaqes së tij, viktimat dhe kostot e kriminalitetit në vend dhe një analizë e tillë të bëhet pjesë e raportit vjetor të Prokurorit të Përgjithshëm,*** janë arritur rezultatet si më poshtë:

1.13.1 Në zbatimin e kësaj kërkeje të Rezolutës, Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar për forcimin e kapaciteteve në Sektorin e Koordinimit dhe Studimeve nëpërmjet përzgjedhjes për emërimin e stafit të nevojshëm pranë këtij sektori. Struktura përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme ka kryer procedurën sipas ligjit²⁰ për përzgjedhjen e stafit të këtij sektori bazuar në kriteret specifike për veçoritë e profileve të punës në këtë sektorë, që duhet të përmbushin kandidatët e ofruar. Deri aktualisht kandidatët e ofruar nuk kanë grumbulluar më shumë se gjysmën e pikëve për të përmbushur kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen dhe emërimin në Sektorin e Koordinimit dhe Studimeve të Prokurorisë së Përgjithshme. Për këto arsye, struktura përkatëse do të rishpalli vendin vakant për këtë pozicion me synim plotësimin e organikës dhe forcimin e kapaciteteve profesionale në Sektorin e Koordinimit dhe Studimeve në Prokurorinë e Përgjithshme.

²⁰ Koment: Ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, Kreut IV, “Pranimi në shërbimin civil”, neni 23, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, lidhur me konkurimin e shpallur për nëpunës civil të kategorisë ekzekutive III-b, pika 2, klasa B, për vendin e punës në pozicionin “specialist – juristë ” pranë Sektorit të Koordinimit dhe Studimeve.

1.13.2 Në përmbushje të kësaj kërkesë të Rezolutës, Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm për Kuvendin e Shqipërisë, i hartuar/mbështetur në nenin 148/b të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenin 104 e vijues të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, për vitin 2021 do të vijojë të bazohet në pikën 3 e vijues të Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik, i miratuar me vendimin nr.134/2018 të Kuvendit të Shqipërisë, ku tek analiza e të dhënave sipas grupveprave penale, krahas profilit të pandehurit, gjeografisë sociale, politika penale dhe siguria publike, do të shtohen dhe analiza e profilit të viktimave dhe kostot e shpenzimeve procedurale penale, sipas ligjit.

 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të realizuar këtë kërkesë të rezolutës së Kuvendit, për faktin se në hartimin e Raportit të Prokurorit të Përgjithshëm objekt shqyrtimi, tek analiza e të dhënave sipas grupveprave penale, krahas profilit të pandehurit, gjeografisë sociale, politika penale dhe siguria publike, janë shtuar dhe analiza e profilit të viktimave, si dhe kostoja e hetimit, në mbështetje dhe të manualit të monitorimit të miratuar me vendimin nr.134/2018 të Kuvendit të Shqipërisë.

Angazhime për zbatimin e rekomandimeve të BE-së për Shqipërinë

1.14 Aktivitete në kuadrin e zbatimit të rekomandimeve të BE-së për Shqipërinë ku është përfshirë Prokuroria e Përgjithshme, janë:

1.14.1 Prokuroria, si organ kushtetues dhe subjekt i rëndësishëm i sistemit të drejtësisë penale, është angazhuar në bashkëpunimin, me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, në dhënien e kontributit dhe progresit institucional në përmbushje të rekomandimeve të progres raportit të BE-së për Shqipërinë dhe në progres raportin për zbatimin e planit të veprimit të ICRG/FATF dhe rekomandimet e Moneyval për Shqipërinë.

i) Përgatitur dhe dërguar në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) kontributi/progresi institucional “Mbi zhvillimin e takimit të 13-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri, “Drejtësia, Liria dhe Siguria”, si dhe jemi përfaqësuar në Grupin Ndërinstitucional në takimin online të zhvilluar me delagacionin e BE-së në datat 9-10 dhjetor 2021;

ii) Përgatitur dhe dërguar MEPJ kontributin/progresin institucional “Mbi takimin e 12-të Nënkomitetit Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca, duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit, datë 17 maj 2021”, si dhe jemi përfaqësuar në Grupin Ndërinstitucional në takimin online të zhvilluar me delagacionin e BE-së.

1.14.2 Aktivitetet dhe masat në kuadrin e zbatimit të rekomandimeve Moneyval dhe planit të veprimit FATF/ICRG, ku është përfshirë Prokuroria e Përgjithshme, janë:

i) Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar në zbatimin e rekomandimeve të KSA-së e FATF-së dhe planin e veprimit të ICRG/FATF për Shqipërinë, siç e parashtroam më sipër edhe në zbatimin e kërkesave të rezolutës së Kuvendit. Në bashkërendim dhe koordinim me pikat e kontaktit në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, në dinamik është marrë informacion për ecurinë e rezultateteve të arritura, dhe është informuar/raportuar në

strukturën moneyval pranë KM dhe/ose DPPP në mënyrë periodike përgjatë vitit 2021, për progresin e masave administrative dhe procedurale, dhe ndikimin e tyre në rritjen e numrit të procedimeve apo të pandehurve të regjistruar dhe rritjen e numrit të dënuarve krahasuar me vitin 2020.

ii) Prokuroria e Përgjithshme, në kuadrin e zbatimit të masave të planit të veprimit të ICRG/FATF - Shqipëri, ka përgatitur kontributin institucional të progresit dhe është përfaqësuar në takimet/mbledhjet e Grupit Ndërinstitucional të Punës për zbatimin e Planit të Veprimit dhe në mbledhjen e Komitetit të Bashkëpunimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave në datë 28 qershor 2021.

iii) Gjithashtu, janë përgatitur materialet e progresit për raportin dhe takimet me ekspertët e ICRG/FATF-së në kuadrin e zbatimit të Planit të Veprimit të FATF/ICRG-Shqipëri të dërguara nëpërmjet DPPP dhe përfaqësuar Prokurorinë e Përgjithshme në takimet online në 8 janar 2021, korrik 2021 dhe 8 shtator 2021.

iv) Në kuadrin e rekomandimeve R.38²¹ të Moneyval për Shqipërinë ku përfshihet për dhënie kontributi Prokuroria e Përgjithshme, rekomandime të lidhura dhe me zbatimin e planit të veprimit të ICRG/FATF për Shqipërinë, Prokuroria e Përgjithshme, me 6 tetor 2021, në përmbushje të këtyre rekomandimeve, ka dërguar në Sekretariatit e Moneyval, kontributin institucional të prokurorisë me pergjigjet/komentet për Rekomandimin R.38, konkretisht tek c.38.1, c.38.2, c.38.3 e c.38.4, lidhur me kuadrin ligjor (K.Pr.Penale, K.Penal, ligjin nr.79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, ligjin nr.10193/2009 “Per marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja në fushën penale”) të ndryshuar/plotësuar, të shoqëruar me komente e interpretime, dhe me ekstrakte të dispozitave ligjore përkatëse, që qartësojnë se kuadri ligjor i plotësuar në fuqi është në përfaqje me standardet e kërkuara në rekomandimin R.38 të Moneyval. Referuar vlerësimit paraprak të Moneyval për rekomandimin 38 vlerësimi është shumë i mirë (“C”/complaint).

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, në vështirimin institucional të prokurorisë, i konsiderojmë të zbatuara për vitin 2021 rekomandimet për progres raportin e BE-së për Shqipërinë dhe masat për progres raportin në zbatim të planit të veprimit të ICRG/FATF për Shqipërinë, si dhe vijon angazhimi institucional i Prokurorisë së Përgjithshme për rritjen e progresit të mëtejshëm në zbatimin e rekomandimeve të BE-së dhe kërkesave të ekspertëve, si për rekomandimet R.38 të Komitetit Moneyval, ashtu dhe për masat e planit të veprimit të ICRG/FATF për vitin 2021.

Kontributi për reformimin e kuadrit ligjor në Kuvendin e Shqipërisë

²¹ Rekomandimi 38 i Moneyval, ku përfshihen paragrafët: “c.38.1 “Vendet duhet të kenë autoritetin për ndërmarrjen e veprimeve të shpejta në përgjigje të kërkesave të vendeve të huaja për të identifikuar, ngrirë, sekuestruar ose konfiskuar: (a) pastruar pronën nga, (b) rrjedh nga, (c) instrumentet e përdorura në, ose (d) instrumentet e destinuara për përdorim në, pastrim parash, vepra penale, apo financim i terrorizmit; ose (e) vetinë me vlerën përkatëse”; - c.38.2 “Vendet duhet të kenë autoritetin për të ofruar ndihmë për kërkesat për bashkëpunim të bëra në bazë të procedurave të konfiskimit jo të dënua dhe masave të përkohshme të lidhura, të paktën në rrethanat kur një kryes nuk është i disponueshëm për shkak të vdekjes, ikjes, mungesës ose kryesi është i panjohur, përveç nëse kjo nuk është në përputhje me parimet themelore të së drejtës së brendshme”; c.38.3 “Vendet duhet të kenë: (a) aranzhimet për bashkërendimin e veprimeve të sekuestrimit dhe konfiskimit me vendet e tjera; dhe (b) mekanizmat për menaxhimin dhe kur është e nevojshme për asgjësimin e pronës së ngrirë, sekuestruar ose konfiskuar”; c.38.4 “Vendet duhet të jenë në gjendje të ndajnë pronën e konfiskuar me vendet e tjera, veçanërisht kur konfiskimi është drejtpërdrejt ose indirekt rezultat i veprimeve të koordinuara të zbatimit të ligjit.”

1.15 Marrëdhëniet e Prokurorisë së Përgjithshme me Kuvendin e Shqipërisë janë në raporte bashkëpunimi për përmirësimin e projektligjeve objekt shqyrtimi në komisione.

1.15.1 Përgjatë vitit 2021 në kuadrin e kontributit gjithëpërfshirës për reformën ligjore në sistemin e drejtësisë penale dhe në fushën e zgjedhjeve, përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme kanë dhënë kontribute në vështirimin institucional të prokurorisë, për disa projektligje, me synim përjasjen e tyre me kode e ligje, për përmirësimin e kuadrit ligjor nëpërmjet dhënies së opinioneve institucionale dhe/ose duke u përfshirë në grupe punë në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ndër të cilët mund të veçojmë:

- Projektligje për ndryshime e shtesa në Kodin Penal,
- Projektligje për ndryshime e shtesa në Kodin e Procedurës Penale,
- Projektligji për disa shtesa në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”,
- Projektligji për ndryshime e shtesa në ligjin për Policinë Gjyqësore,
- Projektligji për ndryshime e shtesa në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,
- Projektligji për ndryshime e shtesa në ligjin “Për Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja gjyqësore në fushën penale”,
- “Projektligji për ndryshime e shtesa në ligjin “Për Kodin Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë”;
- Projektligji për ndryshime e shtesa në ligjin nr.8097/1996 “Për pensionet suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësve të shtetit”;
- Projektligji për ndryshime e shtesa në ligjin “Për Policinë Ushtarake;
- Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.110/2018 “Për noterinë;
- Projektligji për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale;
- Projektligji për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore;
- etj.

2. Zbatimi i rekomandimeve të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021”

Në zbatim të nenit 103 pika 3 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Rekomandimet Prioritare “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021” të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.326, datë 02.06.2021²² ju bënë të njohura drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm të gjithë niveleve, në një mbledhje të përbashkët të organizuar në datë 18.06.2021, ku mori pjesë edhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

²² Shih, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.326, datë 02.06.2021 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021” publikuar në Fletoren Zyrtare, Viti: 2021 – Numri: 93, me date 15 qershor 2021.

2.1 Prokurori i Përgjithshëm, në cilësinë e autoritetit që kujdeset për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë²³, në kuadrin e zbatimit si të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 14.06.2021, ashtu dhe zbatimit të rekomandimeve të KM, në datë 24.06.2020, miratoi udhëzimin e përgjithshëm nr.4 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, me synim orientimin e politikave institucionale për ndjekjen e unifikuar të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit nëpërmjet masave administrative dhe procedurale të përcaktuara për drejtuesit dhe prokurorët e juridiksionit të përgjithshëm, pa cënuar pavarësinë e prokurorisë²⁴ si organ që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimtarisë së saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit, ku janë parashikuar:

2.1.1 Masa administrative të marra sipas ligjit për nxjerrjen e udhëzimit të përgjithshëm dhe për hartimin e miratimit të planit të veprimit për të siguruar ndjekjen e rekomandimeve prioritare, në përputhje me specifikat dhe gjendjen e prokurorisë përkatëse që drejtojnë, përfshi nevojat për buxhet (nëse është i nevojshëm), për të siguruar ndjekjen e rekomandimeve prioritare, duke respektuar pavarësinë e institucionit dhe garantuar pavarësinë e prokurorëve.

2.1.2 Masa në drejtim të riorganizimit të brendshëm, koordinimit dhe forcimit të kapaciteteve institucionale dhe profesionale prioritare të rekomanduara dhe mbikëqyrjen në vazhdimësi të ecurisë së tyre, si dhe të informojnë Prokurorinë e Përgjithshme sa herë kërkohet²⁵, për progresin e arritur, dhe si ka ndikuar mbi gjendjen e kriminalitetit në prioritetet e rekomanduara.

2.1.3 Masa procedurale në fazën e hetimeve, ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzave/çështjeve në gjykim, si:

- i) nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete;
- ii) koordinimin e veprimtarisë me prokuroritë e tjera për çështje konkrete që lidhen me fushat/drejtimet prioritare të rekomanduara;
- iii) kërkimi i informacionit, verifikimi i ecurisë dhe përfundimit të procedimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara;
- iv) verifikimi i ecurisë dhe përfundimit të çështjeve për veprat penale prioritare të rekomanduara sipas ligjit dhe në kuadrin e forcimit të mekanizmit të kontrollit e llogaridhënies, duke garantuar paanshmërinë dhe shmangien e çdo lloj influence apo ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimeve në drejtimet prioritare të rekomanduara;
- v) marrja e masave administrative të nevojshme nga prokurorët që në koordinim me zyrën e regjistrimit të pasqyrohen të dhënat e sakta për ecurinë e procedimit/çështjes me synim përmirësimin e

²³ Shih, neni 38 pikën 2 shkronja “f” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në R.Sh” që parashikon: “2. Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca: f) kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore e kushtetuese të prokurorisë.”

²⁴ Neni 148 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili në pikën 2 parashikon: “2.Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimtarive të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit”

²⁵ Shih, nenet 50 pika 1 e 103 pika 5 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në R.Sh”, në lidhje me nenin 6, paragrafi 32 i ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” i ndryshuar, që parashikon: “... Ministri i Drejtësisë ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej Këshillit të Ministrave. Për këtë qëllim, Ministri i Drejtësisë kërkon jo më pak se dy herë në vit pranë Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme informacion mbi zbatimin e tyre...” dhe nenin 50 pika 1 e ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në R.Sh”

koordinimit institucional në raportimin e të dhënave statistikore në drejtimet prioritare të rekomanduara;

vi) zhvillimi i mbledhjeve tematike me prokurorët e seksioneve dhe/ose me prokurorët e caktuar për ndjekjen e çështjeve apo me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve apo të strukturave hetimore në shërbimet e Policisë së Gjyqësore të caktuar për kryerjen e hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara;

vii) nxjerrja e urdhrave për policinë gjyqësore që kanë në juridiksion lidhur me rritjen e cilësisë dhe efektivitetit në ushtrimin e funksioneve në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara;

viii) mbështetje për prokurorët në ushtrimin e funksioneve nëpërmjet menaxhimit të duhur të burimeve njerëzore dhe logjistikës në dispozicion, si dhe për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori në zbatim të Kodit të Drejtësisë për të Mitur për të siguruar aksesin për persona me paaftësi fizike dhe pritjen e publikut, sipas prioriteteve të rekomanduara;

ix) bashkëpunimi në mënyrë efektive me institucionet shtetërore dhe ato ligjzbatuese me rol të posaçëm në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara, si dhe organizimi dhe zhvillimi i analizave të përbashkëta ndërinstitutionale në drejtimet/fushat ose për veprat penale prioritare të rekomanduara;

x) koordinimi dhe organizimi i trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit dhe lehtësimi i pjesëmarrjes së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në trajnime të përbashkëta me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit për forcimin e kapaciteteve profesionale në fushat e rekomanduara.

2.1.4 Masa procedurale që duhen marrë nga prokurorët lidhur me rekomandimet prioritare për luftën ndaj kriminalitetit, për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit sipas prioriteteve të rekomanduara, duke ruajtur pavarësinë nga çdo ndikim të paligjshëm në vendimmarrjen e tyre, si:

i) kryerja e hetimeve të plota e të gjithanshme për veprat penale prioritare të rekomanduara, me anë të hetimeve proaktive efektive, përdorimi i metodave speciale të hetimit dhe hetimeve financiare/pasurore, për sekuestrimin/konfiskimin e pasurive/aseteve produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale prioritare të rekomanduara;

ii) lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit në zbatim të nenit 37/a të Kodit të Procedurës Penale, për vënien përpara përgjegjësisë të çdo bashkëpunëtori në veprimtarinë kriminale, me synim për të parandaluar dhe riparuar dëmet e shkaktuara për veprat penale prioritare të rekomanduara;

iii) përdorimi i bazave të të dhënave të institucioneve ligjzbatuese të tjera ku prokuroria ka akses për rritjen e efikasitetit të hetimit;

iv) kryerja e analizave të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve policore në strukturat hetimore përkatëse dhe/ose të agjencive ligjzbatuese, për rastet e referuara, shkëmbimin dhe kërkimin e ekspertizës në funksion të përmirësimit të shpejtësisë e gjithanshmërisë në ecurinë e hetimeve të specializuara, për veprat penale dhe/ose ndaj subjekteve prioritare të rekomanduara;

v) ruajtja e sekretit të hetimit dhe ndalimi i publikimit të akteve në luftën kundër krimeve të rënda prioritare të rekomanduara;

vi) sigurimi i zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas fushave/drejtimeve prioritare të rekomanduara;

vii) sigurimi i zbatimit efektiv të të drejtave procedurale penale të pandehurve, personave nën hetim apo të dyshuarve, ashtu dhe të viktimave, për veprat penale prioritare të rekomanduara;

viii) ndjekja e një politike penale efektive dhe eficiente, duke analizuar, vlerësuar dhe arsyetuar në aktet/kërkesat/konkluzionet procedurale, edhe kushtet/kriteret ligjore, në ashpërsimin ose zbutjen e politikës penale, si për caktimin e masave të sigurimit personal, ashtu dhe për mënyrën e caktimit të llojit dhe masës së dënimit për veprat penale prioritare të rekomanduara, me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër krimeve prioritare të rekomanduara, ndaj të miturit, dhunës në familje, dhunës gjinore, krimeve seksuale dhe jo vetëm;

ix) rritja e numrit të kërkesave për gjykim të drejtpërdrejtë dhe për zbatimin e instituteve procedurale penale (gjykimi me marrëveshje dhe urdhri penal), duke vlerësuar kushtet dhe kriteret ligjore dhe synimet prioritare të rekomanduara;

x) rritja e aftësive profesionale të tyre nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime dhe në tryeza diskutimesh, veçanërisht për zbatimin e dispozitave të reja të Kodit Penal, si dhe trajnime të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të strukturave hetimore në shërbimet, me fokus në fushat dhe drejtimet prioritare të rekomanduara.

2.1.5 Në datë 09.07.2021, Prokurori i Përgjithshëm miratoi Urdhrin nr.79 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e “Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021”. Këto akte u dërguan për njohje e zbatim në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm me shkresat nr.942/1 datë 21.06.2021 dhe me nr.942/4 e nr.942/5 datë 09.07.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme.

2.2 Prokurori i Përgjithshëm, me shkresën nr. 942/9 prot., datë 16.11.2021 dhe nr. 942/27 prot., datë 02.02.2022 ka kërkuar informacion nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm për ecurinë e këtyre rekomandimeve prioritare, nëpërmjet zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.4/2021 dhe planit të veprimit të miratuar me Urdhrin nr.79/2021, të shoqëruar me disa tregues statistikor për numrin, llojet, intensitetin dhe format e kriminalitetit përgjatë vitit 2021, dhe me shpjegime të qarta mbi angazhimet, rezultatet dhe problematikat në zbatimin e tyre.

2.2.1 Përveç sa u trajtua më sipër lidhur me zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 14.06.2021, ku përfshihet dhe zbatimi i disa rekomandimeve prioritare të KM, gjejmë me vend që t’ju informojmë për masat e tjera të marra dhe progresin në përmbushjen e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit Ministrave përgjatë vitit 2021, sipas drejtimeve ku fokusohen, si më poshtë:

Lidhur me rekomandimet në drejtimin: Garantimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit.

2.3 Lidhur me rekomandimin: “4.Marrjen e masave për garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimeve”, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

2.3.1 Prokurori i Përgjithshëm nëpërmjet miratimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.4/2021, dhe jo vetëm, ka bërë kujdes në përcjelljen e mesazhit për prokurorët dhe drejtuesit e prokurorive, si nëpërmjet normimit të qëllimit të udhëzimit, *... unifikimi i ndjekjes të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit*²⁶ për vitin 2021 në kompetencë lëndore të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, pa cënuar pavarësinë e prokurorisë²⁷ si organ që garanton ... dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit, ashtu dhe në normimin, e veprimtarisë së drejtuesit të prokurorisë -për marrjen e masave procedurale në zbatim të kompetencave të parashikuara në ligj²⁸,... duke respektuar pavarësinë e institucionit dhe garantuar pavarësinë e prokurorëve, si dhe bërjen kujdes të prokurorëve - të vlerësojnë në çdo rast masat në rekomandimet prioritare ... duke ruajtur pavarësinë nga çdo ndikim i paligjshëm në vendimmarrjen e tyre.

2.3.2 Në kuadrin e unifikimit të veprimtarisë administrative të prokurorisë dhe forcimit të kapaciteteve institucionale për rritjen e efikasitetit në veprimtarinë administrative e funksionale, garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit, drejtuesit e prokurorisë, në zbatim të Urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.164 datë 18.12.2020 “Për miratimin e rregullores standard të organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe Prokurorisë pranë Gjykatave të Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm”, i hyrë në fuqi me 1 janar 2021, kanë miratuar rregulloret standard për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë që drejtojnë me synim për të siguruar efikasitetin dhe efikasitetin në veprimtarinë administrative që kryen secila strukturë në prokurori nëpërmjet zbatimit të rregullave standard²⁹, për të siguruar efikasitetin në organizimin, drejtimin, koordinimin, mbikëqyrjen/monitorimin e punës në çdo prokurori, duke garantuar paanshmërinë dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit.

2.3.3 Në kuadrin e zbatimit të kompetencave kushtetuese e ligjore, Prokuroria e Përgjithshme, në 3 muajt e parë 2021 ka mbikëqyrur zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm nr.12/2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar, nëpërmjet kërkesave për informacion për zbatimin e këtij udhëzimi dhe paraqitjes së raporteve vjetore mbi ecurinë e punës në secilën prokurori të juridiksionit të përgjithshëm, ku janë evidentuar disa elemente të moszbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm të detyrueshëm që mund të ndikojnë në cënimin e paanshmërisë së prokurorit në marrëdhënie me drejtuesit e prokurorisë, elemente të cilat janë garantuar me normimet në këtë udhëzim.

²⁶ Shih, neni 103 “Marrëdhëniet me Këshillin e Ministrave” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili në pikën 1 parashikon: “1.Këshilli i Ministrave, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, miraton dhe i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet prioritare që duhen ndjekur për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit”

²⁷ Neni 148 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili në pikën 2 parashikon: “2.Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarevajtjen, kontrollin e veprimtarive të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit”

²⁸ Shih, nenet 42, 43, 46 pikat 1, 3 shkronja “c”, 48, 49, 52 e vijues të ligjit nr.97/2016 .

²⁹ Neni 20 në lidhje me nenin 38 pika 2 shkronja “e” e ligjit nr.97/2016;

i) Për arsyet më sipër, dhe jo vetëm, Prokurori i Përgjithshëm i ka kërkuar ILD kryerjen e inspektimeve tematike në disa Prokurori pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, me sugjerimin për çështje me objekt, ku përfshihet: “2. Masat administrative dhe procedurale të marra për garantimin e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.12 datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar.”

2.3.4 Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me projektin EURALIUS V, nisi përgatitjen e projektudhëzimit të përgjithshëm “Për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit ...” me synim unifikimin e qëndrimeve dhe sjelljeve ligjore të prokurorit për shmangien e çdo paanshmërie, papajtueshmërie ose konflikt interesi në ushtrimin e funksioneve të tyre në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, si dhe garantimin e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor në ushtrimin e funksioneve të prokurorit, projektudhëzim i cili akoma është në fazën përgatitore.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të realizuar këtë rekomandim prioritar të KM, për faktin se janë realizuar masat dhe aktivitetet më sipër në zbatim të këtij rekomandimi, krahas masave dhe aktiviteteve të realizuara në zbatim të Rezolutës së Kuvendit, ku përkohë dhe përfshihen edhe masat/aktivitetet lidhur me zbatimin e rekomandimit për garantimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit.

✚ Lidhur me rekomandet në drejtimin “Garantimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit”, risjellim në vëmendje se, **garantimi i pavarësisë së prokurorëve** është në kompetencën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Kjo, referuar si nenit 149 pika 1³⁰ të Kushtetutës në lidhje me ligjet nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve...” dhe ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ashtu dhe neneve 103, 104 pika 2 e vijues të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë...” dhe pikës 32 të nenit 6 të ligjit nr.8678/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” (i ndryshuar), ku parashikohet se, *në kompetencë të Këshillit të Ministrave nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë është përgatitja dhe përcjellja Prokurorit të Përgjithshëm i rekomandimet prioritare për luftën kundër kriminalitetit që duhen ndjekur për vitin në vazhdim, për zbatimin e të cilëve informohet Kuvendi i Shqipërisë.*

Në këtë vështrim vlerësojmë se, në rekomandimet prioritare të KM për luftën kundër kriminalitetit të rivlerësohet nevoja e përfshirjes në të ardhmen, duke qenë se rekomandimet që garantojnë pavarësinë e prokurorit, dhe jo vetëm, janë në kompetencë vlerësimi dhe monitorimi të KLP-së si organi qeverisës i sistemit të prokurorisë.

Ndërkohë, Prokuroria e Përgjithshme ka dhënë dhe jep kontribut në këtë drejtim, duke marrë masat e duhura administrative dhe procedurale përmes nxjerrjes së udhëzimeve të përgjithshme, me synim garantimin e pavarësisë së prokurorëve dhe mbikëqyrjes në zbatimin e tyre.

Lidhur me rekomandimet në drejtimin: Lufta kundër korrupsionit

³⁰ Kushtetuta në nenin 149 pika 1 parashikon: “1.Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”.

2.4 Lidhur me rekomandimin prioritar: “1.Forcimin e cilësisë së hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit, përfshirë përdorimin me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit për aq sa është e mundur, referuar kompetencës lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme, rritjen e numrit të personave të hetuar dhe të dërguar për gjykim për këto vepra penale, si dhe ndjekjen me vendosmëri të kërtimeve për dënimin e autorëve të këtyre veprave”, që përkon dhe më rekomandimit **“2.Mbështetja e Prokurorisë së Posaçme për sa i përket hetimeve proaktive pasurore dhe financiare, veçanërisht për rastet që lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit në nivele të larta të politikës dhe administratës publike”** janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

2.4.1 Në kuadrin e këtij rekomandimi në lidhje me luftën kundër korrupsionit në përgjithësi dhe korrupsionit në nivelin e lartë në veçanti, referuar kompetencës lëndore që parashikon neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, ky grup veprash, përgjithësisht janë në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme, në bashkëpunim si me institucionet e reja të luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar (SPAK), ashtu dhe me agjencitë e tjera të specializuara ligjzbatuese (BKH, etj). Për këto arsye, Prokuroria e Përgjithshme me marjen e Rekomandimeve Prioritare të miratuara me vendimin e KM nr.326, datë 02.06.2021, të përcjella dhe të prezantuara nga ana Ministri i Drejtësisë në mbledhjen e përbashkët në datë 18.06.2021, me shkresën nr.942/2 datë 21.06.2021 ia ka përcjellë një kopje të Rekomandimeve Prioritare edhe Prokurorisë së Posaçme të Luftës Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit.

i) Në këtë vështrim, lidhur me këtë grup veprash penale, kompetenca lëndore për veprat penale sipas neneve 244, 245/1, 258 e 259 të Kodit Penal deri në qershor 2021 i përkiste në tërësi Prokurorisë së Posaçme. Ndërkohë, me ndryshimet e bëra Kodit Penal me ligjin nr.43/2021, i cili, përkatësisht, me nenet 1, 2, 3 e 4 të tij, ka bërë ndryshime e shtesa në nenet 244, 245/1, 258 e 259 të Kodit Penal. Ndërkohë, me ndryshimet në nenin 39 të ligjit nr.41/2021 që ka ndryshuar nenin 75/a të K.Pr.Penale, hyrë në fuqi me datë 1 qershor 2021, nenet e ndryshuara (244§1, 245§1 e 3, 258§1 dhe 259§1 e 3) të Kodit Penal i kanë kaluar për kompetencë lëndore prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

2.4.2 Në zbatim të objektivave prioritare dhe në kuadrin e këtij rekomandimi, Prokuroria e Përgjithshme për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të suksesshme të kriminalitetit dhe prioritetëve në luftën kundër tij, përfshi veprat penale që lidhen me detyrën dhe ato korruptive, ka vijuar bashkëpunimin ndërinstitucional në nivel vendor nëpërmjet punës së përditshme të drejtuesve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, dhe në nivel qendror në përmirësimin e politikave me akte të përbashkëta, për rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ndjekjes penale, për veprat në detyrë dhe në fushën e korrupsionit, si me Prokurorinë e Posaçme në vijimin e zbatimit të Aktit Koordinimit Ndërinstitucional (nënshkruar datë 15.12.2020), “Për rritjen e efikasitetit nëpërmjet, bashkërendimit të Prokurorisë së Përgjithshme, me Prokurorinë e Posaçme dhe unifikimin e disa veprimtarive administrative dhe procedurale ndërinstitucionale, duke respektuar veçoritë dhe kompetencat institucionale të parashikuara në ligj”, ashtu dhe në vijimin e zbatimit të marrëveshjeve dypalëshe të vitit 2020 ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme me: - Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, -Kontrollin e Lartë të Shtetit, dhe -Inspektoratin e

Lartë të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me synim rritjen e efikasitetit të bashkëpunimit dhe të efektivitetit në hetimet që lidhen dhe me veprat penale të fushës së krimeve financiare, shpërdorimit të fondeve publike, dhe në fushën e veprimtarisë së ILDKPKI-së.

2.4.3 Në kuadrin e rekomandimeve prioritare, Prokuroria e Përgjithshme ka miratuar Udhëzimin e Përgjithshëm nr.4/2021 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, në të cilin janë normuar masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimet paraprake, dhe kryerjen e hetimeve proaktive efektive me përdorim të mjeteve të posaçme/speciale të hetimit në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë për rritjen e mëtejshme të efektivitetit dhe në luftën kundër korrupsionit.

2.4.4 Në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.4/2021 dhe akteve normative të tjera më sipër, prokurorët në luftën kundër korrupsionit dhe veprave që lidhen me detyrën, kanë rritur rolin aktiv në hetimet paraprake, si nëpërmjet shtimit të hetimeve të filluara kryesisht, ashtu dhe në kryerjen e hetimeve proaktive efektive me përdorim të mjeteve të posaçme/speciale të hetimit në funksion të rritjes së hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë.

i) Prokurorët, sipas kërkesave dhe procedurave ligjore, në vitin 2021 kanë rritur rolin aktiv në kryerjen e hetime proaktive me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në 59 procedime penale për veprat penale të korrupsionit dhe që lidhen me detyrën. Ky proces i ka shërbyer, si parandalimit dhe/ose ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu dhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 40 personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

ii) Në kuadrin e zbatimit të Aktit të Koordinimit Ndërinstitucional mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme, nënshkruar me 15 dhjetor 2020, ka vijuar bashkërendimi nëpërmjet komunikimeve të drejtpërdrejta në nivel qendror dhe në nivel rrethi gjyqësor, ndërmjet drejtuesve të prokurorive përkatëse sipas rastit dhe objektit të përcaktuar. Në këtë vështrim, sipas të dhënave statistikore, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë transferuar 11 procedime/referime penale në Prokurorinë e Posaçme vetëm për vepra penale në fushën e korrupsionit në kompetencë lëndore të asaj prokurorie, disa raste nga të cilët, kryerja e hetimeve proaktive ka çuar në zbulimin e ekzistencës së veprimtarisë korruptive, për kryerjen e hetimeve të mëtejshme nga ajo prokurori.

2.4.5 Referuar të dhënave statistikore për vitin 2021, (aneksi 1, tabela 34), për këto grup veprash të korrupsionit në kompetencë të juridiksionit të përgjithshëm, janë regjistruar 100 procedime me 87 të pandehur dhe 54 procedime me 55 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2020 me rritje 3 herë të numrit të procedimeve të regjistruara dhe me rritje të numrit nga 3 në 54 procedime dhe nga 3 në 55 të pandehur të dërguar për gjykim për këto vepra penale.

Tendenca në ulje dhe/ose në rritje sipas secilës vepër penale në këtë fushë për vitin 2021, vërehet e krahasuar me vitin 2020, konkretisht:

i) Për nenin 124/a të Kodit Penal “*Kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit*”, nuk ka procedime penal të regjistruar, ndërsa 1 procedim është regjistruar në vitin 2020;

- ii) Për nenin 164/b të Kodit Penal “*Korrupsioni pasiv në sektorin privat*”, janë regjistruar 2 procedime penale ndaj 1 procedimi në vitin 2020;
- iii) Për nenin 244 të Kodit Penal “*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, janë regjistruar 66 procedime penale ndaj 9 procedimeve në vitin 2020;
- iv) Për nenin 245 të Kodit Penal “*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose të zgjedhurve vendor*”, janë regjistruar 2 procedime penal ndaj 3 procedimeve në vitin 2020;
- v) Për nenin 245/1 të Kodit Penal “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, janë regjistruar 2 procedime penale ndaj 2 procedimeve të regjistruara në vitin 2020;
- vi) Për nenin 259 të Kodit Penal “*Korrupsioni pasiv i personave me funksione publike*”, janë regjistruar 15 procedime penal ndaj 8 procedimeve në vitin 2020;
- vii) Për nenin 328 të Kodit Penal “*Korrupsioni aktiv në zgjedhje*” janë regjistruar 12 procedime penale me 8 të pandehur, ndërsa nuk është regjistruar ndonjë procedim në vitin 2020;
- viii) Për nenin 328/b të Kodit Penal “*Korrupsioni pasiv në zgjedhje*”, është regjistruar 1 procedim me 2 të pandehur, ndërsa nuk është regjistruar ndonjë procedim penal në vitin 2020.

✚ Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore dhe në zbatim të këtij rekomandimi të KM, e konsiderojmë të realizuar këtë rekomandim, për faktin se ka vijuar zbatimi i Aktit të Koordinimit Ndërinstitucional me Prokurorinë e Posaçme dhe i marrëveshjeve të bashkëpunimit me KLSH, ILDKPKI, DPPSH në nivel qendror dhe vendor, si dhe është rritur efektshmëria e hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit, përfshirë përdorimin me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit sipas kompetencës lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe është rritur dukshëm numri i procedimeve të regjistruara dhe i të personave të hetuar dhe të dërguar për gjykim për këto vepra penale.

2.5 Lidhur me rekomandimin: “5.Zhvillimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me fokus në luftën kundër korrupsionit me agjencitë e zbatimit të ligjit, si dhe me oficerët e policisë gjyqësore”, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

2.5.1 Në kuadrin e këtij rekomandimi, Prokuroria e Përgjithshme rritjen profesionale të prokurorëve e ka vlerësuar si domosdoshmëri për forcimin e kapaciteteve profesionale në luftën kundër korrupsionit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm. Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme ka bashkërenduar me Komisionin e Policisë Gjyqësore për forcimin e kapaciteteve profesionale të policisë gjyqësore të seksioneve, dhe jo vetëm, nëpërmjet realizimit dhe trajnimeve të përbashkëta me prokurorët dhe agjencitë ligjzbatuese të përfshira.

2.5.2 Referuar Udhëzimit të Përgjithshëm nr.4/2021 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, drejtuesit e prokurorive janë udhëzuar të koordinojnë dhe organizojnë trajnime të përbashkëta, si dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në trajnime në bashkëpunim edhe me agjencitë e tjera ligjzbatuese, ndërsa prokurorëve u kërkohet të synojnë rritjen/zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive profesionale të tyre, nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime apo në tryeza diskutimesh, si dhe në trajnime të përbashkëta me oficerët e policisë

gjyqësore të seksioneve dhe të strukturave hetimore në shërbimet policore, me fokus në fushat dhe drejtimet prioritare siç është dhe lufta kundër korrupsionit.

2.5.3 Në kuadrin e këtij rekomandimi, për forcimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore, janë angazhuar:

i) Projekti PAMECA V që ka bashkëpunuar dhe mbështetur Prokurorinë e Përgjithshme në zhvillimin e dy moduleve trajnimi online me tema: “Mbi pastrimin e parave dhe hetimet pasuror e financiar” dhe “Mbi veprat penale që lidhen me detyrën” të zhvilluara në janar 2021 ku morën pjesë prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve të posaçme, prokurorë të Prokurorisë së Posaçme, oficerë të policisë gjyqësore të shërbimeve në Policinë e Shtetit dhe përfaqësues të DPT, DPD, DPPPP, KLSH, ILDKPKI (gjithsej 148 pjesëmarrës).

2.5.4 Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës është angazhuar në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me pjesëmarrjen e prokurorëve, për forcimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve me synim forcimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit.

i) Në kuadrin e trajnimit vazhdues dhe në zbatim të ligjit, në vitin 2021 në Shkollën e Magjistraturës janë organizuar dhe zhvilluar trajnime me tema dhe në fushën e korrupsionit, ku përfshihen aktivitete trajnuese të zhvilluar me tema: -‘Korrupsioni si vepër penale në sektorin publik dhe privat’, ku morën pjesë 13 prokurorë; dhe -“Hetimi proaktiv në luftën kundër korrupsionit”, ku morën pjesë 16 prokurorë dhe me tema të tjera.

🚦 Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar këtë rekomandim prioritar, për faktin se evidentohen arritje, si në realizimin e politikave dhe masat administrative e procedurale institucionale të parashikuara në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.4/2021 për zbatimin e rekomandimeve prioritare, ashtu dhe forcimi i kapaciteteve profesionale të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve në Policinë e Shtetit, si dhe agjencive ligjzbatuese nëpërmjet trajnimeve në këtë fushë.

2.6 Lidhur me rekomandimin prioritar: “6.Ndjekjen me përparësi të kallëzimeve penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, duke kryer hetime të plota, të paanshme, të shpejta, me profesionalizëm dhe me efektivitet, në bashkëpunim me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe SPAK-un”, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

2.6.1 Në kuadrin e implementimit të ndryshimeve me paketën ligjore në fushën e zgjedhjeve, Prokurori i Përgjithshëm miratoi Udhëzimin e Përgjithshëm nr.2, datë 31.03.2021 “Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.3, datë 21.06.2019 “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore”, në përjasje dhe me ndryshimet e reja ligjore të Kodit Zgjedhor me ligjin 118/2020, ashtu dhe me ndryshimet në ligjin nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në RSH” me ligjin nr.184/2020, me synim unifikimin e masave në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore të vitit 2021.

2.6.2 Krahës Udhëzimit të Përgjithshëm nr.18, datë 31.12.2020 “Për masat administrative dhe procedurale për verifikimin e të dhënave të formularit të vetëdeklarimit nga struktura e posaçme në zbatim të ligjit nr.138/2015 dhe vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë”, Udhëzim i Përgjithshëm nr.4/2021 është nxjerrë, si për verifikimin e integritetit të personave/kandidat për t’u zgjedhur, ashtu dhe për rritjen e efektivitetit të hetimeve dhe ushtrimit të ndjekjes penale ndaj autorëve të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve ose të veprave penale të tjera që dëmtojnë procesin zgjedhor, në periudhën para dhe pas zgjedhore, si dhe për parandalimin e përgjithshëm të veprimtarisë kriminale në këtë fushë.

i) Në kuadrin e zbatimit të këtij udhëzimi, Prokurori i Përgjithshëm me Urdhrin nr.37, datë 31.03.2021 ngriti strukturën përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme si pikë kontakti me KQZ³¹ (para, gjatë dhe pas procesit zgjedhor) dhe për dhënie informacioni për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, në kompetencë lëndore të juridiksionit të përgjithshëm, duke garantuar ruajtjen e sekretit hetimor, ndalimin e publikimit të akteve dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas ligjit.

ii) Gjithashtu, në periudhën pas zgjedhore, në kuadrin e mbikëqyrjes³² të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.3/2019³³ i ndryshuar, dhe kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore në prokurori³⁴, Prokurori i Përgjithshëm me Qarkoren nr.571/11, datë 28.04.2021 drejtuar prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, i ka kërkuar drejtuesve të prokurorive dhe prokurorëve të vlerësojnë në dinamikë gjendjen, ecurinë e hetimeve, dhe nevojat e marrjes së masave procedurale, për rritjen e intensitetit të hetimeve dhe ushtrimit të ndjekjes penale në njësitë administrative që mbulon rrethi gjyqësor i prokurorisë, forcimin e bashkëpunimit me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve dhe SPAK, si dhe zbatimin nga drejtuesit të kompetencave të parashikuara në ligj³⁵, sipas fazave të procedimit penal, me synim rritjen e efektivitetit të hetimeve dhe ushtrimit të ndjekjes penale ndaj autorëve të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve ose të veprave penale të tjera që dëmtojnë procesin zgjedhor, në periudhën para, gjatë dhe pas zgjedhore.

iii) Në kuadrin e zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.3/2019 i përditësuar dhe Udhëzimit të Përgjithshëm nr.4/2021, prokurorët kanë rritur rolin aktiv në hetimet paraprake, si nëpërmjet shtimit të hetimeve të filluara kryesisht, ashtu dhe në kryerjen e hetimeve proaktive efektive me përdorim të

³¹ Shih, nenin 107/1 “Marrëdhëniet me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve” të ligjit nr.148/2020 që ka ndryshuar ligjin nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon: 1. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sipas juridiksionit përkatës, i japin KQZ-së informacion për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, që nuk cenon ruajtjen e sekretit hetimor sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale. Informacioni jepet me të dhënat për çështjet penale, numrin e personave nën hetim, kohëzgjatjen e hetimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për kërkesat e prokurorisë për gjykim, kohëzgjatjen e gjykimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për ankimimin e vendimeve gjyqësore, shkakun e ankimimit, si dhe të dhënat për faktin nëse çështjet janë gjykuar në apel ose në Gjykatën e Lartë dhe rezultatit të këtij gjykimi. Pjesë e informacionit duhet të jetë edhe informacioni për ekzekutimin e dënimeve. 2. Informacioni sipas pikës 1 të këtij neni përdoret nga KQZ-ja për nevojat e informimit publik për gjendjen dhe rezultatet e hetimeve penale për çështjet zgjedhore. 3. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u përgjigjen kërkesave të KQZ-së për informacion jo më vonë se 15 ditë nga data e kërkesës.”

³² Shih, nenin 38 pika 2 shkronja “b” e ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;

³³ Shih, udhëzimin e përgjithshëm nr.3, datë 21.06.2019 “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore” i ndryshuar/plotësuar me udhëzimin e përgjithshëm i PP nr.37/2021, datë 31.03.2021.

³⁴ Shih, nenin 38 pika 2 shkronja “f” e vijues të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

³⁵ Shih, nenin 42, 43, 45, 46, 48 e vijues të ligjit nr.97/2016 .

mjeteve të posaçme/speciale të hetimit, në funksion të rritjes së hetimeve të filluara kryesisht në bashkërendim me Prokurorinë e Posaçme, të cilës dy procedime për vepra korruptive në fushën e zgjedhjeve i janë referuar/transferuar nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

2.6.3 Ndërkohë, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, drejtuesit e prokurorive morën masat e nevojshme për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gadishmërisë në periudhën para, gjatë dhe pas zgjedhore, si dhe në Prokurorinë e Përgjithshme kanë raportuar periodikisht të dhëna për veprat penale që kanë prekur zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, raporte të cilat i janë dërguar institucioneve kushtetuese përkatëse dhe publikuar në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme (Web: www.pp.gov.al).

2.6.4 Referuar të dhënave statistikore (aneksi 1, tabela 33) në vitin 2021, evidentohet se në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm janë regjistruar dhe ndjekur 47³⁶ procedime penale për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve. Pëgjatë vitit, 7 çështje penale me 52 të pandehur janë dërguar për gjykim, dhe janë dënuar 46 persona, të cilët sipas veprave penale janë: -për “Pengim të subjekteve zgjedhore” të parashikuar nga neni 325 i K.Penal është dërguar për gjykim 1 çështje me 1 të pandehur; -për “Falsifikim të materjalit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhësve” të parashikuar nga neni 326 i K.Penal janë dërguar për gjykim 2 çështje me 6 të pandehur dhe janë dënuar 19 persona; -për “Shkelje të fshehtësisë së votimit” të parashikuar nga neni 327 i K.Penal janë dërguar për gjykim 2 çështje me 2 të pandehur dhe janë dënuar 2 persona; dhe -për veprën penale “Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar” parashikuar nga neni 327/a i K.Penal janë dërguar për gjykim 2 çështje me 43 të pandehur dhe janë dënuar 19 persona.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar këtë rekomandim prioritar të KM, për faktin se janë miratuar dhe po zbatohen, si Udhëzimi i Përgjithshëm nr.18/2020, që ka unifikuar masat administrative dhe procedurale për verifikimin e të dhënave të formularit të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015, ashtu dhe Udhëzimi i Përgjithshëm nr.2/2021 “Për disa ndryshime e shtesa në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.3, datë 21.06.2019 “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore”, në përqasje me ndryshimet e reja ligjore. Gjithashtu, është rritur bashkëpunimi e koordinimi me Prokurorinë e Posaçme dhe agjencitë ligjzbatuese në kryerjen e hetimeve proaktive, si dhe janë rritur procedimet e regjistruara dhe të dërguara në gjyq, veçanërisht rritur numri i të pandehurve të dërguar për gjykim.

Lidhur me rekomandimet në drejtimin: Lufta kundër krimit të organizuar.

2.7 Lidhur me rekomandimin prioritar: “1. Forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional ndërmjet strukturave të prokurorisë, policisë gjyqësore, policisë së shtetit dhe agjencive të tjera

³⁶ Koment:Ne shifren 47 procedime të regjistruara për këte grupvepra nuk janë përfshirë 13 procedime të regjistruara për korrupsion në zgjedhje sipas neneve 328 e 328/b Kodit Penal, të trajtuara ne grupveprat kundër korrupsionit.

shtetërore, për zbatimin e objektit dhe qëllimin e ligjit për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

2.7.1 Në kuadrin e këtij rekomandimi për luftën kundër krimit të organizuar, në vijim sa më sipër, referuar kompetencës lëndore që parashikon neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, evidentojmë se, rritja e efektivitetit në luftën kundër grupveprave të krimit të organizuar dhe kundër terrorizmit janë në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme, në bashkëpunim me institucionet e reja të luftës kundër krimit të organizuar (SPAK) dhe me agjencitë e tjera të specializuara ligjzbatuese.

2.7.2 Në këtë vështrim, Prokuroria e Përgjithshme për rritjen e cilësisë dhe efijencës në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale dhe prioriteteve në luftën kundër kriminalitetit, përfshi veprat penale që lidhen me krimin e organizuar, ka konsideruar domosdoshmëri qasjen e përbashkët dhe të unifikuar ndërmjet institucioneve ligjzbatuese, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë bashkëpunimit praktik vendor në punën e përditshme të drejtuesve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe në vijim të zbatimit të Aktit Koordinimit Ndërinstitucional, (datë 15.12.2020), mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme, duke respektuar veçoritë dhe kompetencat institucionale të parashikuara në ligj, ashtu dhe në vijim të zbatimit të memorandumit të bashkëpunimit ndërinstitucional (15 korrik 2020) ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme me: -Ministrinë e Brendshme dhe -Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ku përfshihen dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, për rritjen e efektivitetit në hetimet kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore, si dhe për vepra penale të fushës së krimeve të rënda që mund të lidhen me format e veçanta të bashkëpunimit³⁷.

2.7.3 Në kuadrin e këtij rekomandimi dhe Udhëzimit të Përgjithshëm nr.4/2021 prokurorët kanë rritur rolin aktiv në hetimet paraprake, si nëpërmjet shtimit të hetimeve të filluara kryesisht, ashtu dhe në kryerjen e hetimeve proaktive efektive me përdorim të mjeteve të posaçme/speciale të hetimit në funksion të rritjes së hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë.

i) Prokurorët sipas kërkesave dhe procedurave ligjore në vitin 2021 kanë rritur rolin aktiv në kryerjen e hetime proaktive me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në 331 procedime penale vetëm për grup vepra: -trafikimi, prodhimi dhe kultivimi i narkotikëve, -trafikimi dhe mbajtja e armëve e municioneve, pastrimi i parave, -trafikimi e ndihma për kalim të paligjshëm të personave, -vepra me qëllime terroriste dhe nxitja, thirrja për kryerje vepra terroriste. Ky proces i ka shërbyer, si parandalimit dhe/ose ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu dhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 418 personave të dyshuar për

³⁷ Shih, nenin 28 “Format e veçanta të bashkëpunimit” të Kodit Penal, që sipas nenit 75/a të K.Pr.Penale janë në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme.

kryerjen e veprave penale në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

ii) Gjithashtu, në hetimet për vepra penale në kompetencë lëndore të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, prokurorët me rol aktiv kanë vlerësuar të dhënat/indiciet e përfituara nga përdorimi i mjeteve të posaçme të hetimit edhe për kryerjen e veprave penale në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme. Në këtë vështrim dhe në kuadrin e mbikëqyrjes të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.4/2021, sipas të dhënave statistikore dhe informacionit nga Prokuroria e Posaçme, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë transferuar 93³⁸ procedime/referime penale në Prokurorinë e Posaçme ose me rritje 45.3 % të procedimeve të transferuara krahasuar me vitin 2020, prej të cilave 69 procedime janë pranuar e regjistruar, kryesisht për vepra penale me qëllime terroriste, trafikime të paligjshme dhe vepra penale në fushën e korrupsionit në kompetencë lëndore të asaj prokurorie, disa raste nga të cilët, kryerja e hetimeve proaktive ka çuar në zbulimin e ekzistencës së elementëve të bashkëpunimit të veçantë, për kryerjen e hetimeve të mëtejshme në kuadrin dhe të veprimtarisë kriminale të organizuar.

2.7.4 Në kuadrin e forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet strukturave të prokurorisë, policisë gjyqësore në seksionet e prokurorive dhe shërbimeve të policisë gjyqësore në policinë e shtetit dhe agjencitë e tjera shtetërore, referuar të dhënave statistikore të vitit 2021, evidentohet ndikimi i masave nëpërmjet hetimit dhe ndjekjes penale të autorëve të krimeve të rënda, përfshi trafikimet e paligjshme, prodhimi/kultivimi i narkotikëve, dhe krime të tjera të rënda, si më poshtë:

Trafikimi i paligjshëm i personave

i) Lidhur me **trafikimin e personave të rritur**, të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal, në vitin 2021, sipas të dhënave statistikore (aneksi 1, tabela 36) për këtë vepër janë regjistruar 8 procedime penale me 2 të pandehur, dhe 2 procedime me 4 të pandehur janë dërguar për gjykim, ose krahasuar me vitin 2020 me ulje 34.7 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe rritje të numrit nga 1 procedim me 2 të pandehur të dërguar për gjykim në vitin 2020 në 2 procedime me 4 të pandehur të dërguar për gjykim në vitin 2021 për këtë vepër penale.

ii) Për veprën penale **“Trafikimi i të miturve”** të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal, sipas të dhënave statistikore (aneksi 1, tabela 36) në vitin 2021 për këtë vepër janë regjistruar 2 procedime penale me 2 të pandehur, dhe 2 procedime me 2 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2020 me ulje 66.6 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe shifra të njëjta të numrit procedimeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë vepër penale.

Trafikimi i paligjshëm dhe mbajtja pa leje e armëve

³⁸ Sipas të dhënave statistikore, përgjatë vitit 2021 janë transferuar për kompetencë lëndore 93 procedime penale nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në Prokurorinë e Posaçme.

i) Prokuroria e Përgjithshme ka përmbushur detyrimet institucionale në kuadrin e zbatimit të Projektit të BE lidhur me Udhërrëfyesin Rajonal mbi Armët e Vogla dhe të Lehta. Në vitin 2021 evidentohen tregues në ulje të vepës penale “Trafikimi i armëve dhe municionit” dhe tregues në rritje të veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” të parashikuara përkatësisht nga nenet 278/a dhe 278 të Kodit Penal.

a) Lidhur me **trafikimin e armëve dhe municionit** nga të dhënat statistikore (aneksi 1, tabela 36) në vitin 2021, janë regjistruar 6 procedime penale me 12 të pandehur, dhe 3 procedime me 5 të pandehur janë dërguar për gjykim, ose krahasuar me vitin 2020 me ulje 50 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe ulje 50 % të numrit të procedime të dërguar për gjykim për këtë vepër penale.

b) Lidhur me **mbajtjen pa leje dhe prodhimin e armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit** nga të dhënat statistikore (aneksi 1, tabela 29) për vitin 2021 janë regjistruar 366 procedime me 311 të pandehur dhe 188 procedime me 215 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2020 vihet re rritje 16.93 % e numrit të procedimeve të regjistruara dhe 24.4 % e numrit të pandehurve të ndjekur penalisht dhe rritje 17.5 % e numrit procedimeve dhe 18.78 % e numri të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë vepër penale.

Trafikimi, prodhimi dhe kultivimi i narkotikëve

i) Lidhur me luftën kundër **trafikimit të narkotikëve** parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal nga të dhënat statistikore (aneksi 1, tabela 36) për vitin 2021 janë regjistruar 63 procedime me 82 të pandehur, dhe 23 procedime me 41 të pandehur janë dërguar për gjykim, ose krahasuar me vitin 2020 me ulje 14.86 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe me ulje 14.81 % të numrit të procedimeve të dërguara për gjykim për këtë vepër penale.

ii) Për veprën penale “**Prodhimi dhe shitja e narkotikëve**”, të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, në vitin 2021, sipas të dhënave statistikore (aneksi 1, tabela 37) për këtë vepër janë regjistruar 1030 procedime me 1031 të pandehur, prej të cilëve 470 procedime lidhur me 650 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2020 me rritje 23.5 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe me rritje 43.29 % të numrit të procedimeve dhe rritje 37.42 % të numrit të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë vepër penale.

iii) Për veprën penale “**Kultivimi i bimëve narkotikëve**” të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, në vitin 2021, sipas të dhënave statistikore (aneksi 1, tabela 37) për këtë vepër janë regjistruar 974 procedime me 521 të pandehur dhe 206 procedime me 319 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2020 me rritje 10.05 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe me rritje 43.052% të numrit të procedimeve dhe rritje 12.22 % të numrit të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë vepër penale.

Lufta kundër terrorizmit

i) Lidhur me këtë grup veprash, me krijimin e Prokurorisë së Posaçme kompetenca lëndore e hetimit të veprave me qëllime terroriste deri në qershor 2021 i përket prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndërsa sipas parashikimeve në nenin 39 të ligjit nr.41/2021 që ka

ndryshuar nenin 75/a të K.Pr.Penale, i cili ka hyrë në fuqi me datë 1 qershor 2021 këto vepra penale kanë kaluar në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme.

ii) Të dhënat statistikore (aneksi 1, tabela 25) në kuadrin e luftës kundër terrorizmit në vitin 2021, për këtë grup veprash penale janë regjistruar 9 procedime me 6 të pandehur. Konkretisht: -për nenin 230/a “Financimi i Terrorizmit” të Kodit Penal janë regjistruar 3 procedime me 2 të pandehur, prej të cilëve 1 procedim me 1 të pandehur është dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2020 me rritje në shfra të 1 procedimi të regjistruar dhe me rritje të 1 procedimi me 1 të pandehur të dërguar për gjykim për këtë vepër; -për nenin 230 “Vepra me qëllime terroriste” janë regjistruar 2 procedime me 2 të pandehur, prej të cilëve 1 procedim me 1 të pandehur është dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2020 me ulje në shfra të 1 procedimi të regjistruar dhe me rritje të 1 procedimi me 1 të pandehur të dërguar për gjykim për këtë vepër; -për nenin 232/a “Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste” është regjistruar 1 procedim dhe 1 procedim me 1 të pandehur është dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2020 me ulje në shfra të 5 procedime të regjistruar dhe me ulje të 1 procedimi me 1 të pandehur të dërguar për gjykim për këtë vepër; dhe - për nenin 232 “Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste” të Kodit Penal janë regjistruar 2 procedime.

 Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore dhe në zbatim të këtij rekomandimi të KM, e konsiderojmë të realizuar, për faktin se ka vijuar zbatimi i Aktit të Koordinimit Ndërinstitucional me Prokurorinë e Posaçme dhe i Memorandumit të Bashkëpunimit me DPPSH, DPPPP, DPT, DPD, AAPSK në nivel qendror dhe vendor, si dhe përgjithësisht është rritur efektshmëria e ndjekjes penale dhe e parandalimit të përgjithshëm për veprat penale në fushën e trafikimit të personave të rritur dhe të mitur, trafikimit të narkotikëve dhe trafikimit të armëve e municioneve me tendenca në ulje, përfshirë dhe përdorimin me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit sipas kompetencës lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe është rritur numri i procedimeve të regjistruara dhe i personave të hetuar dhe të dërguar për gjykim për veprat penale kultivimi dhe mbajtja narkotikëve dhe mbajtja e armëve pa leje, duke inkurajuar vijimin e përmirësimit të mëtejshëm, si për rritjen e cilësisë, ashtu dhe në rritjen e efektivitetit të këtij bashkërendimi e koordinimi ndërinstitucional në të ardhmen.

2.8 Lidhur me rekomandimin: “3.Fuqizimin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, etj”, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

2.8.1 Prokurori i Përgjithshëm në cilësinë e përfaqësuesit të autoritetit kompetent³⁹ për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Eurojust, në kuadrin e këtij rekomandimi prioritar dhe në përmbushje të rekomandimit të BE-së, ju informoj se, me datë 1 janar 2021ka filluar veprimtaria e Prokurorit Ndërlidhës të Shqipërisë në Eurojust dhe me datë 29 tetor 2021 Prokurori i Përgjithshëm

³⁹ Shih, “Marrëveshjen për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST”, të ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 113/2018, në nenin 4 pika 1 parashikon: “1.Autoriteti kompetent i Republikës së Shqipërisë për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje është Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë.”

i Shqipërisë dhe Presidenti i Eurojust përuruar Zyrën e Prokurorit Ndërlidhës të Shqipërisë pranë selisë së Eurojust në Hagë.

i) Me hapjen e zyrës u ofruan dhe u krijuan nga ana e Eurojust të gjitha mundësitë për aksesin në veprimtaritë e kësaj agjencie, në kuadër dhe në respekt të zbatimit të marrëveshjes mes Eurojust dhe Republikës së Shqipërisë⁴⁰, prania e të cilës do mundësojë konsolidimin e përvojës dhe kapaciteteve, si dhe do të përmirësojë përgjigjen në një mënyrë më të organizuar institucionale ndaj kërcënimit serioz të krimit të organizuar transnacional. Ky është një hap i rëndësishëm në drejtim të bashkëpunimit, koordinimit të hetimeve dhe shkëmbimit të shpejtë të informacionit me autoritet gjyqësor të vendeve evropiane dhe të vendeve të rajonit.

ii) Përgjatë vitit 2021 referuar raportit vjetor të Zyrës Ndërlidhëse Shqiptare në Eurojust janë regjistruar 21 çështje të reja me kërkesën e autoriteteve shqiptare kundrejt vendeve të Bashkimit Evropian, prej të cilave janë përfunduar 16 prej tyre. Janë hapur 3 çështje kundrejt shteteve të treta, jo anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat kanë zyra ndërlidhëse në Eurojust dhe 4 çështje kundrejt vendeve jo anëtare të BE-së.

iii) Ndërkohë, kundrejt Shqipërisë janë regjistruar 51-çështje të reja nga vendet e Bashkimit Evropian dhe ka patur në vijim 58 çështje të prejardhura nga vitet e kaluara, si dhe janë hapur 3 çështje nga vendet jo anëtare të Bashkimit Evropian.

iv) Në vitin 2021, gjithashtu, janë nënshkruar 5 marrëveshje të reja për ngritjen e Skuadrave të Përbashkëta Hetimore, si dhe ka vijuar zbatimi i 5 marrëveshjeve të Skuadrave të Përbashkëta Hetimore të mbartura nga vitet e kaluara me autoritetet gjyqësore të huaja, të asistuar dhe financuar nga Eurojust, të ngritura mbi marrëveshje të nënshkruara mes Prokurorisë së Posaçme, si autoriteti gjyqësor shqiptar dhe vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, për vepra penale të kryera nga grupet e strukturuar kriminale apo organizatat kriminale, kryesisht vepra penale të trafikimit të lëndëve narkotike, pastrimit të parasë, por edhe mashtrimit kibernetik.

v) Krijimi i Skuadrave të Përbashkëta Hetimore bazuar në dispozitat e reja⁴¹ të ligjit nr.10193/2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar, konfirmohet si një nga instrumentet më efektiv të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar i financuar dhe asistuar më së shumti nga Eurojust, si një mjet që lejon tejkalimin e letërkërkesave në marrjen e provave ndërkufitare, në kuadër të një aktiviteti të përbashkët hetimor të një natyre komplekse dhe operacionale ndërmjet autoriteteve të vendeve të ndryshme anëtare të BE dhe/ose jo anëtare, ku përfshihet territori i disa shteteve.

2.8.2 Në kuadrin e këtij rekomandimit prioritar prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokuroria e Përgjithshme për fuqizimin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare, në funksion të efektivitetit të hetimeve, për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, etj, kanë ndërvepruar për rritjen e efikasitetit në bashkëpunimin me autoritetet gjyqësore të

⁴⁰ Shih, po aty, “Marrëveshje për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST”, të ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 113/2018.

⁴¹ Shih, nenet 75/1 dhe 75/2, të ligjit nr. 97/2021, datë 7.7.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”.

huaja në fushën penale. Në këtë vështrim, referuar të dhënave statistikore të gjeneruara nga sistemi IMPRO i Prokurorisë së Përgjithshme, për periudhën raportuese rezultojnë përkatësisht:

- i) Për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve” janë trajtuar kërkesat:
 - Ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit -52 praktika;
 - Ekstradime nga jashtë drejt Shqipërisë - 19 praktika;
 - Letërporosi nga Jashtë – 55 praktika;
 - Letërporosi për Jashtë – 35 praktika.
- ii) Për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale” janë trajtuar kërkesat:
 - Ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit -5 praktika;
 - Ekstradime nga jashtë drejt Shqipërisë - 1 praktikë ;
 - Letërporosi nga Jashtë – 29 praktika;
 - Letërporosi për Jashtë – 153 praktika.
- iii) Për veprën penale “Financimi i terrorizmit” janë trajtuar kërkesat:
 - Letërporosi nga Jashtë – 2 praktika
 - Letërporosi për Jashtë – 3 praktika
- iv) Për veprën penale “Trafikimi i qenieve njerëzore” janë trajtuar kërkesat:
 - Ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit – 1 praktikë
 - Letërporosi nga Jashtë – 4 praktika

2.8.3 Ndërkohë, gjatë vitit 2021 të dhënat statistikore në kuadër të kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike në marrëdhënie me autoritetet e huaja;

- i) Rezultojnë të dhënat si më poshtë:
 - Ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit, 133 praktika të reja;
 - Ekstradime nga jashtë drejt Shqipërisë, 111 praktika;
 - Urdhërarreste ndërkombëtare të lëshuara nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë të cilët nuk mund të ekstradohen për shkak të shtetësisë shqiptare, në total 287 praktika;
 - Letërporosi nga Jashtë, 600 praktika;
 - Letërporosi për jashtë, 654 praktika;
 - Shpallje e shtetasve shqiptarë ose të huaj në kërkim ndërkombëtar, 172 praktika.
 - Heqje e shtetasve shqiptarë nga kërkimi ndërkombëtar 133 praktika.
 - Transferime të dënuarish nga jashtë, 2 praktika.
 - Transferime të dënuarish për jashtë, 7 praktika.
 - Transferim procedimi nga jashtë drejt Shqipërisë, 11 praktika.
 - Transferim procedimi nga Shqipëria për jashtë, 14 praktika.
 - Njohjet e vendimeve penale të ardhura nga jashtë, 36 praktika.
 - Njohjet e vendimeve penale shqiptare të dërguara jashtë vendit, 14 praktika.
- ii) Ndërkohë, ka vijuar zbatimi i një marrëveshje të një Skuadre të Përbashkët Hetimore ndërmjet autoriteteve gjyqësore italiane dhe Prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e mbartur nga vitet e kaluara (2019).

2.8.4 Në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 10/2020 “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare,

financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm”, përgjatë vitit 2021 Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme i ka dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit 62 praktika të ardhura nga autoritetet gjyqësore të huaja me qëllim kryerjen e verifikimeve paraprake lidhur me pasuritë e subjekteve dhe referimin sipas rastit pranë prokurorive kompetente, nga të cilat rezultojnë të përfunduara 19 praktika.

2.8.5 Në kuadrin e marrëdhënieve me autoritetet gjyqësore rajonale, Prokuroria e Përgjithshme nga tetori 2021, përfaqësohet në projektin “THB Balkans Gender and Transnational Crime Virtual Programme” financuar nga Republika Federale e Gjermanisë me objekt rritjen e kapaciteteve hetimore të agjencive ligjzbatuese të vendeve të Ballkanit si dhe fuqizimin e bashkëpunimit rajonal kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Projekti do të zhvillohet përgjatë harkut kohor shtator 2021-shtator 2023, periudhë në të cilën do të zhvillohen disa aktivitete të natyrës trajnuese, operacionale etj.

 Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar rekomandimin e KSA-së BE-Shqipëri dhe rekomandimin prioritar të KM, për faktin se, me 1 janar 2021 u mundësua fillimi i veprimtarisë të prokurorit ndërlidhës shqiptar në Eurojust. Gjithashtu, të dhënat dhe angazhimet institucionale të prokurorit ndërlidhës pranë Eurojust dhe prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, evidentojnë tregues në rritje të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe autoritetet gjyqësore të huaja në të gjithë fushat e bashkëpunimit ndërgjyqësor dhe forcimin e besimit ndaj institucionit të prokurorisë nga partnerët në marrëdhëniet juridiksionale me jashtë.

Lidhur me rekomandimet në drejtimin: Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut.

2.9 Lidhur me rekomandimin prioritar: ***“Shtimin e numrit të rasteve të zbatimit të instrumenteve lehtësuese penale (marrëveshje, urdhri penal) dhe rritja e rasteve të gjykimit të drejtpërdrejtë, me synim hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale në një afat sa më të shpejtë, duke mbajtur në konsideratë kompleksitetin, rrezikshmërinë e veprës, si dhe duke ruajtur efikasitetin dhe cilësinë e hetimeve”***, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

2.9.1 Në kuadrin e këtij rekomandimi, ka vijuar puna përgatitore dhe Prokurori i Përgjithshëm me datë 21.12.2021 ka miratuar Udhëzimin e Përgjithshëm nr.9, “Për marrëveshjen mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit/pranimin e fajësisë” i shoqëruar me akte/formular tip, të cilët janë pjesë e këtij udhëzimi të përgjithshëm, me synim shtimin e numrit të rasteve dhe unifikimin e veprimeve dhe akteve procedurale penale në zbatimin e institutit të marrëveshjes mbi kushtet për pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe për caktimin e dënimit ndaj tij në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, rritjen e efikasitetit në veprimtarinë e sistemit të drejtësisë penale, shkurtimin e procedurave dhe kohëzgjatjes së procedimit, uljen e kostove të shpenzimeve procedurale penale, rritjen e efikasitetit të ndjekjes penale në rastet kur mundësohet zbulimi i veprave penale të tjera apo i autorëve të tjerë të kryerjes së tyre, konfiskimin e mjetit të kryerjes së veprës penale dhe produktet/pasuritë e ardhura nga veprimtaria kriminale dhe mundësimin e të pandehurve që në këmbim

të pranimi të fajësisë të përfitojnë lehtësira në caktimin e llojit dhe/ose masës së dënimit, duke respektuar të drejtat e viktimës, dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar viktimës/dëmtuarit.

2.9.2 Në kuadrin e këtij rekomandimi, në zbatim dhe të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.4/2021 prokurorët janë udhëzuar për rritjen e numrit të kërkesave për gjykim të drejtpërdrejtë dhe për zbatimin e instituteve procedurale penale (gjykimi me marrëveshje dhe urdhri penal), duke vlerësuar kushtet dhe kriteret ligjore dhe synimet prioritare të rekomanduara.

2.9.3 Ndërkohë, Prokuroria e Përgjithshme ka mbikëqyrur nëpërmjet të dhënave statistikore periodike, treguesit në gjykimin e çështjeve në zbatimin e këtyre instituteve, ashtu dhe nëpërmjet informacioneve, për problematikat dhe praktikën e mira të shoqëruara me praktikë gjyqësore sa më të konsoliduar në zbatimin e këtyre instituteve të reja procedurale penale.

i) Referuar të dhënave statistikore për vitin 2021, në prokuroritë pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, numri i çështjeve të përfunduara në zbatim të instituteve të reja procedurale penale është për 1071 çështje, me 1096 të pandehur, shifra që zënë 11.27 % të numrit të çështjeve të dërguara për gjykim, duke shkurtuar kështu afatet e hetimit dhe të gjykimit për këto grup çështjesh.

2.9.4 Referuar të dhënave statistikore për vitin 2021 prokurorët kanë kërkuar në gjykatë: - miratimin e urdhrit penal për 264 çështje me 269 pandehur për kundravajtje penale ose me ulje 35,6 % të çështjeve krahasuar me vitin 2020, të cilat kryesisht janë për vepra penale me rrezikshmëri shoqërore të ulët; -miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë për 520 çështje me 537 të pandehur ose me ulje 29,7 % të çështjeve krahasuar me vitin 2020, si dhe kanë kërkuar gjykimin e drejtpërdrejtë për 287 çështje me 290 të pandehur ose me rritje 13.88% të çështjeve krahasuar me vitin 2020.

✚ Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar pjesërisht këtë rekomandim, si për faktin se është miratuar Udhëzimi i Përgjithshëm nr.9/2021 “Për marrëveshjen mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit”, dhe evidentohen shifra në rritje për gjykimet e drejtpërdrejta, por ka shifra në rënien tek urdhri penal dhe marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit, krahasuar me vitin 2020.

✚ Në vijim të zbatimit të dy instituteve për treguesin në ulje të urdhrit penal dhe marrëveshjes për pranimin e fajësisë do kërkohet nga drejtuesit e prokurorive për të analizuar shkaqet e rënies së zbatimit të këtyre dy gjykimeve të posaçme dhe marrjen e masave sipas ligjit, Udhëzimit të Përgjithshëm nr.9/2021 dhe këtij rekomandimi për rritjen e aplikimit të instituteve të reja procedurale penale për vitin 2022.

2.10 Lidhur me rekomandimin prioritar: **“Nxitjen e aplikimit të dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet e të miturve, personave vulnerabël dhe personave me probleme shëndetësore”,** janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

2.10.1 Në kuadrin e këtij rekomandimi, Prokuroria e Përgjithshme ka përgatitur Udhëzimin e Përgjithshëm “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive për veprat penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitarë” i miratuar me nr.8, datë 15.11.2021. Ndërkohë, Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Projektin “SIDA” dhe me mbështetjen e tij, Qendra (Zyra) e Zhvillimit⁴² ka vijuar përgatitjen e nëntë akteve/modeleve formular tip, të cilët janë pjesë e këtij udhëzimi të përgjithshëm (nr.8/2021). Ky udhëzim ka për qëllim rritjen e efikasitetit, efektivitetit dhe reduktimin e afatit, në hetimin dhe ndjekjen penale të çështjeve me/dhe ndaj të miturve, në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitar, të udhëhequr nga parimet e një drejtësie penale sa më miqësore dhe i interesit më të lartë të të miturit si dhe garantimi i të drejtave të tyre, në mënyrë që të kontribuohet në uljen e kriminalitetit të të miturit, në rehabilitimin, riintegrimin dhe eliminimin e dhunës ndaj tyre. Gjithashtu, udhëzimi synon unifikimin e disa procedurave e akteve procedurale penale në çështjet me të mitur, në përputhje me praktikën më të mirë dhe standardet ndërkombëtare në drejtësinë penale për të mitur.

i) Ky udhëzim në dispozita të veçanta normon shmangien e të miturit në konflikt me ligjin nga ndjekja penale dhe nga dënimi përmes masave alternative, si dhe udhëzon që në kërkesat për caktimin e masave të sigurimit dhe/ose për caktimin e dënimit ndaj të miturit, në çdo rast prokurori vlerëson dhe konsideron parësore interesin më të lartë të fëmijës që është rehabilitimi dhe riintegrimi i tij në shoqëri.

2.10.2 Në kuadrin e implementimit të sistemit të drejtësisë penale për të miturit në konflikt me ligjin e viktimën, Prokurori i Përgjithshëm miratoi Urdhrin nr.87, datë 28.07.2021 “Për miratimin e rregullave për përdorim të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur” në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, në përputhje me parashikimet në ligj⁴³, aktet nënligjore⁴⁴ dhe rregullat e përcaktuara në këtë urdhër, me synim që ky sistem të pasurohet me të dhëna elektronike të përditësuara për çështjet penale në të cilat përfshihen të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga veprat penale, në ecimin e procedimeve penale për këto vepra, deri në fazën e përfundimit të ekzekutimit të vendimeve.

i) Në këtë urdhër është parashikuar se përdoruesit e këtij sistemi, në çdo prokurori të shkallës së parë dhe apelit, ngarkohen/autorizohen nga drejtuesi i prokurorisë sipas ligjit⁴⁵ dhe aktit nënligjor⁴⁶ të cilët do të kenë akses në Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.

2.10.3 Prokuroria e Përgjithshme në kuadrin e mbikëqyrjes të zbatimit të Urdhrit nr.124/2020 “Krijimi i një regjistri të posaçëm në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”

⁴² Me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm në vitin 2019 në Prokurorinë e Përgjithshme është ngritur dhe funksionon, Qendra (Zyra) e Zhvillimit për drejtësinë penale për të mitur, me anëtar një prokuror dhe një oficer i policisë gjyqësore. Kjo zyrë është përqendruar në, përgatitjen e dokumentave, politikave, udhëzuesve, dhe manualeve në fushën e drejtësisë penale për të miturit, grumbullimin dhe ruajtjen e praktikave më të mira në shkallë vendi dhe ndërkombëtare në këtë fushë, shpërndarjen e praktikave më të mira dhe dhënien e mbështetjes dhe këshillave prokurorëve që trajtojnë çështjet me të mitur.

⁴³ Shih, nenin 136 të ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur”;

⁴⁴ Shih, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.149, datë 20.03.2019 “Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit e aksesimit, të dhënave parësore e dytësore dhe dhënien e informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur”;

⁴⁵ Shih, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, Kodi i Procedurës Penale, Kodi Penal, ligji nr.97/2016;

⁴⁶ Shih, pikën 11 e vijues të vendimin e Këshillit të Ministrave nr.149, datë 20.03.2019;

bazuar në informacionet e ardhura nga prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm evidentohet se prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në seksionet për të mitur kanë bërë kujdes që të procedohet në sa më pak raste me arrestime apo ndalime me subjekte procedurale të mitur, duke i kryer hetimet ndaj tyre me masa sigurimi “Vendosja në mbikëqyrje” dhe “Vendosja në një shërbim të specializuar”, të parashikuara nga nenet 83 e 84 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit apo në masa sigurimi të tjera alternative, si dhe ndaj tyre janë kërkuar masa alternative të dënimit, si shmangia, ndërmjetësimi, këshillimi për të miturin apo familjen dhe paralajmërimi me shkrim.

i) Referuar të dhënave statistikore për vitin 2021, bazuar në disponimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, janë regjistruar 704 procedime penale ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin, me rritje 47,28 % të numri të procedimeve krahasuar me vitin 2020. Janë regjistruar 744 të mitur në konflikt me ligjin si të pandehur ose persona nën hetim për kryerjen e veprave penale, me rritje 41,71 % të numrit të pandehurve/personave nën hetim të mitur në konflikt me ligjin krahasuar me vitin 2020.

ii) Ndaj të miturve në konflikt me ligjin janë vendosur 32 masa sigurimi personal arrest në burg, ose për rreth 4,3 % të të miturve të pandehur ose persona nën hetim, ose me ulje 1,6 % këtij raporti në përqindje të të miturve në konflikt me ligjin me masë sigurimi arrest krahasuar me vitin 2020.

iii) Lidhur me vendimmarrjen e prokurorit për çështjet ku përfshihen të mitur në konflikt me ligjin, të dhënat statistikore evidentojnë se, -është vendosur mosfillimi për 492 referime/kallëzime penale ndaj të miturve; -janë pushuar 302 çështje me 285 të pandehur të mitur në konflikt me ligjin ose me rritje 51,7 % të çështjeve të pushuara krahasuar me vitin 2020; dhe -janë dërguar për gjykim 210 çështje me 266 të pandehur të mitur në konflikt me ligjin ose me rritje 43,8 % të çështjeve të dërguara për gjykim krahasuar me vitin 2020.

iv) Sa i përket aplikimit të masës alternative të shmangies, nga të dhënat statistikore rezulton se: në kuadrin e procedimeve të mosfilluara në 164 raste është aplikuar shmangia, ndër të cilat në 4 raste këshillim për të miturin dhe familjen, në 1 rast është vendosur paralajmërim me gojë dhe në 159 raste është vendosur paralajmërim me shkrim, ndërkohë për çështjet e pushuara në 251 raste është aplikuar shmangia, ndër të cilat në një rast është vendosur ndërmjetësimi, në 4 raste është vendosur paralajmërim me gojë dhe në 246 raste është vendosur paralajmërim me shkrim. Aplikimi i shmangies nga dënimi i të miturit në konflikt me ligjin është rritur në masën 96,24 % krahasuar me vitin 2020.

v) Sipas të dhënave statistikore evidentohet se viktimat të mitur janë regjistruar në 612 procedime/çështje me 657 viktimat të mitura, prej të cilëve 285 femra dhe 372 meshkuj, të cilëve u janë siguruar të gjitha të drejtat dhe garancitë procedurale penale.

2.10.4 Sa i përket mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të viktimave gjatë procedimit penal deri në përfundimin e procesit gjyqësor, në vijimësi është kërkuar e po respektohet zbatimi i detyrimeve ligjore dhe atyre që rrjedhin nga udhëzimet e përgjithshme nr.17/2020 dhe nr.5/2018, lidhur me mbrojtjen e viktimave. Respektimi i këtyre detyrimeve po monitorohet si në kuadër të raportimeve periodike nga drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, ashtu edhe nga prokuroritë e apelit gjatë gjykimit të çështjeve të ankmuara.

✚ Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar këtë rekomandim prioritar, si për faktin se është miratuar Udhëzimi i Përgjithshëm nr.8/2021 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive për veprat penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitarë”, si dhe evidentohen shifra dukshëm në rritje për aplikimit të dënimeve alternative të shmangies në rastet e të miturve në konflikt me ligjin.

2.11 Lidhur me rekomandimin: “Vijimin e ashpërsimit të masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve”, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

2.11.1 Prokuroria e Përgjithshme për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme nr.5/2018 dhe nr.17/2020 në sistemin e prokurorisë, po bashkëpunon me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare dhe me mbështetjen e Ambasadës Hollandeze në kuadrin e projektit 3-vjecar, “Angazhim Proaktiv për mbrojtjen dhe zbatimin e ligjit kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”. Ky projekt synon të rrisë kapacitetet e prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe koordinatorëve për subjektet me status të veçantë, në përputhje me standardet ndërkombëtare për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, duke u përqendruar tek trajtimi i viktimave, si dhe do të synojë përmirësimin e mbledhjes dhe administrimit të të dhënave për këto vepra penale në standardet evropiane.

2.11.2 Në kuadrin e këtij rekomandimi, në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.4/2021 prokurorët janë udhëzuar për ndjekjen e një politikë penale eficiente dhe efektive, duke analizuar, vlerësuar dhe arsyetuar në aktet/kërkesat/konkluzionet procedurale, si rrethanat e faktit të bazuara në prova, ashtu dhe kushtet/kriteret ligjore, në ashpërsimin ... e politikës, si për caktimin e masave të sigurimit personal, ashtu dhe për mënyrën e caktimit të llojit dhe masës së dënimit, apo aplikimin e dënimeve alternative, sipas rekomandimeve prioritare dhe/ose për veprat penale prioritare të rekomanduara, me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër krimeve prioritare të rekomanduara, ashtu dhe për parandalimin e posaçëm dhe të përgjithshëm të veprave penale prioritare të rekomanduara, veçanërisht ato ndaj të miturit, dhunës në familje, dhunës gjinore dhe krimeve seksuale.

2.11.3 Prokuroria e Përgjithshme në kuadrin e mbikëqyrjes së zbatimit, si të Udhëzimit nr.5/2018, ashtu dhe të Udhëzimit nr.17/2020, në vijimësi ka kërkuar informacion si po respektohet zbatimi i detyrimeve ligjore dhe atyre që rrjedhin nga këto udhëzime të përgjithshme, lidhur me mbrojtjen e viktimave. Respektimi i këtyre detyrimeve është monitoruar në kuadër të informimeve periodike.

2.11.4 Referuar të dhënave statistikore, për “Krimet seksuale” nenet 100-108/a të Kodit Penal (aneksi 1, tabela 6), në vitin 2021 janë regjistruar 158 procedime penale, me 107 të pandehur ose me tendenca në rritje 13,92 % të procedimeve dhe 2,8 % të pandehurve të regjistruar. Janë dërguar

për gjykim 83 procedime me 93 të pandehur, ose me rritje 48,45 % të procedimeve dhe 52,45 % të të pandehurve të dërguar për gjykim, në krahasim me vitin 2020.

i) Në këtë vështrim, kërkesat e prokurorit lidhur me masat e sigurimit për persona që kanë kryer krime seksuale janë të ashpra, ku 98,6 % janë kërkesa për masa sigurimi me arrest dhe vetëm për 1.4 % është kërkuar caktimi i detyrimit për t'u paraqitur në policinë gjyqësore. Krahasuar me vitin 2020, ky raport është me rritje 4.1 %.

ii) E njëjta politikë vërehet edhe në lidhje me kërkesat për caktimin e dënimit, për të pandehurit e akuzuar për këto krime. Kështu, 81.9 % e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burg dhe 18.4 % për caktimin e alternativave të dënimit me burg. Krahasuar me vitin 2020, ky raport është më i ashpër, pasi ka qenë 80.4 % me burgim dhe 19.16% alternativa të dënimit me burgim.

2.11.5 Referuar të dhënave statistikore, për veprën penale “Trafikimi i të miturve” të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal, (aneksi 1, tabela 36) në vitin 2021 janë regjistruar 2 procedime penale me 2 të pandehur, dhe 2 procedime me 2 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2020 me ulje 66.6 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe shifra të njëjta të numrit procedimeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë vepër penale

i) Sa i përket politikës penale në veprat penale të trafikimit të fëmijëve, të dhënat tregojnë se, kërkesat e prokurorit lidhur me masat e sigurimit për persona që kanë kryer këtë vepër është e ashpër, ku 100 % është kërkesë për masë sigurimi me arrest në burg. Në lidhje me kërkesat për caktimin e dënimit, për të pandehurit e akuzuar për këtë krim rezulton se 67 % e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burg dhe 33 % për caktimin e alternativave të dënimit me burg.

🚦 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të përmbushur rekomandimin e KM, për faktin se, në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.4/2021 dhe Udhëzimit të Përgjithshëm nr.17/2020, treguesit statistikorë evidentojnë se politika penale e kërkesave të prokurorëve ka qenë e ashpër, si për caktimin e masave të sigurimit personal, ashtu dhe në caktimin e llojit të dënimit ndaj autorëve të veprave me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit, shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve.

2.12 Lidhur me rekomandimin: “Rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ashpërsimin e politikës penale për autorët e veprës penale të dhunës në familje”, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

2.11.1 Prokuroria e Përgjithshme ka marrë masa administrative dhe procedurale për mbikëqyrjen e zbatimit si të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.17/2020 dhe të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.5/2018, ashtu dhe të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.4/2021, nëpërmjet kërkesave për informacion në kuadrin e kujdesit për ushtrimin e kompetencave Kushtetuese e ligjore nga drejtuesit dhe prokurorët, duke garantuar pavarësinë e ushtrimit të funksioneve nga ana e tyre.

2.11.2 Referuar të dhënave statistikore, për veprat penale “Dhuna në familje” neni 130/a i Kodit Penal (aneksi 1, tabela 9), në vitin 2021 janë regjistruar 1406 procedime penale, me 1234 të pandehur ose me tendenca në rritje 12,39 % të procedimeve dhe 10,77 % të pandehurve të

regjistruar. Janë dërguar për gjykim 1037 procedime me 1119 të pandehur, ose me rritje 13,45 % të procedimeve dhe 14,3 % e të pandehurve të dërguar për gjykim, në krahasim me vitin 2020.

i) Efektiviteti i ndjekjes penale ka qenë i lartë edhe lidhur me veprën penale të dhunës në familje, ku evidentohet se çështjet e dëguara në gjyq janë në përqindje shumë më të lartë se ato të pushuara, përkatësisht 84.04 % dërguar gjyqit dhe 15.96 % të pushuara

ii) Sa i përket politikës penale në veprën penale “Dhuna në familje” sipas nenit 130/a i Kodit Penal, të dhënat statistikore evidentojnë se, kërkesat e prokurorëve lidhur me masat e sigurimit për persona që kanë kryer këtë vepër janë të ashpra, ku 89.22% janë kërkesa për masa sigurimi me arrest dhe për 1.4 % është kërkuar caktimi i detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore, ose krahasuar me vitin 2020 tregues në përqindje të njëjtë ashpërsie të kërkesave për caktimin e masës së sigurimit personal arrest me burg.

-Në lidhje me kërkesat për caktimin e dënimit, për të pandehurit e akuzuar për këtë vepër penale rezulton se 56,1 % e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burg dhe 43,9 % e kërkesave janë për caktimin e alternativave të dënimit me burg. Ndërkohë, në analizë të nivelit të masës së dënimit me burgim evidentohet se në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020: -janë ulur 10 % numri i kërkesave për dënim në minimumin që parashikon ligji, -janë rritur 21.32 % numri i kërkesat për dënimin mesatar që parashikon ligji, dhe -është rritur në shifra të ulta dënimi maksimal me burgim.

🚩 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar rekomandimin e KM, për faktin se, në kuadrin e masave administrative dhe procedurale për mbikëqyrjen e zbatimit si të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.17/2020 dhe të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.5/2018, ashtu dhe të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.4/2021, treguesit statistikorë evidentojnë si rritjen e cilësisë së hetimeve me ndikim në rritjen e numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim, ashtu dhe evidentohet politikë penale e ashpër në kërkesat e prokurorëve, për caktimin e masave të sigurimit personal dhe i disa elementëve në caktimin e llojit dhe masës së dënimit ndaj autorëve të veprave penale të dhunës në familje.

Lidhur me rekomandimet në drejtimin: Forcimi e bashkëpunimit ndërinstytucional.

2.12 Lidhur me rekomandimin prioritar: “Konsolidimin e bashkëpunimit nëpërmjet nxitjes për shkëmbim të të dhënave, kryerjes së analizave të përbashkëta për rastet e referuara, shkëmbimit dhe kërkimit të ekspertizës, krijimin e procedurave standarde hetimore me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të hetimit të specializuar, të shpejtë dhe të gjithanshëm të grupeve kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe lehtësimeve proaktive që lidhen me veprat penale në fushën e pastrimit të parave, pastrimit të ardhurave nga aktivitetet kriminale dhe terrorizmit”, krahas masave dhe aktiviteteve të trajtuara në kuadrin e zbatimit të kërksave të rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve prioritare KM të trajtuara më sipër, janë zhvilluar edhe aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

2.12.1 Në kuadrin e këtij rekomandimi, dhe në vijim të informacionit më sipër për ecurinë e secilit rekomandim prioritar, ritheksojmë se Prokuroria e Përgjithshme ka nxitur shkëmbimin e të dhënave me agjencitë ligjzbatuese për marrjen e aksesit në databaza shtetërore dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të suksesshme të kriminalitetit

sipas prioriteteve në luftën kundër tij, përfshi veprat penale që lidhen me detyrën dhe korrupsionin, veprat penale kunder pastrimit të parave, krimet e trafikimit dhe krime të tjera të rënda.

i) Prokuroria e Përgjithshme në zbatim të nenit 108/a të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i shtuar *për të drejtën e aksesit të drejtpërdrejtë, si subjekte të interesuara, në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore* me ligjin nr.42/2021, ligjit nr.112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, ligjit nr.154/2020 “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”, dhe vendimin nr.415, datë 08.07.2021 të Këshillit të Ministrave i nxjerrë për zbatimin e këtij ligji, dhe jo vetëm, ka kërkuar dhe është në pritje të përgjigjeve të vonuara për marrjen e aksesit në bazën e të dhënave në “regjistrin e pronarëve përfitues”, dhe “regjistrin qendror të llogarive bankare”, bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe bazën e të dhënave në Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në vartësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe në bazën e të dhënave në Sistemin Elektronik të çështjeve të Përmbartimit Gjyqësor dhe bazën e të dhënave Shtetërore të Shërbimit/Regjistrat Noterial Shqiptar në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë, për lehtësimin e hyrjes dhe përdorimit të bazave të të dhënave në funksion të hetimit dhe gjykimit në kuadrin veprave penale të korrupsionit dhe të lidhura me detyrën, si dhe pastrimit të parave, dhe jo vetëm, për sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve kriminale.

ii) Në këtë vështrim, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar Udhëzimin e Përgjithshëm nr.5, datë 19.07.2021 “Për një shtesë në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.14, datë 21.09.2020 “Për ushtrimin e të drejtës së hyrjes në bazat e të dhënave të të tretëve”, ku është normuar që prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore dokumentojnë me procesverbal kërkimin/këqyrjen e bërë në databazë dhe rezultatin e përftuar ose mungesën e informacionit të kërkuar, të cilët administrohen në fashikullin e hetimit në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, me synim për të dokumentuar veprimtarinë e përdoruesve që kanë të drejtë aksesit në bazat e të dhënave elektronike të të tretëve dhe shmangur veprimet abuzive në përdorimin e tyre.

2.12.2 Prokuroria e Përgjithshme në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, po bashkëpunon me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe me Shkollën e Magjistraturës, për të siguruar mbarëvajtjen e punës administrative në prokurori, rritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe lehtësimin drejt shmangies së problematikave që janë e po krijohen me vakancat e prokurorëve në sistemin e prokurorisë në këtë periudhë të procesit të rivlerësimit kalimtar. Në kuadrin e zbatimit të ligjit dhe bashkërendimit të punës me këto institucione janë kryer aktivitetet:

i) Prokurori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 105 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë...” me datë 27 maj 2021 raportoi në KLP “Për ecurinë e veprimtarisë së prokurorive me juridiksion të përgjithshëm”, ku janë trajtuar masat e mara, administrative dhe procedurale, për forcimin dhe garantimin e pavarësisë së prokurorëve, për rritjen e performancës së prokurorive nëpërmjet rritjes së rolit të drejtuesve të prokurorive sipas ligjit, përmirësimin e funksionimit të prokurorive, rritjen e efikasitetit të punës në veprimtarinë e çdo prokurorie, monitorimin e treguesve të veprimtarisë administrative dhe procedurale të prokurorive, objektivat prioritare për vitin 2021, si dhe problematikën, nevojat dhe mjetet ligjore për zgjidhjen e tyre.

ii) Prokurori i Përgjithshëm në kuadrin e bashkëpunimit me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Ministrin e Drejtësisë dhe në raportimin periodik në Kuvendin

e Shqipërisë, veç të tjerash, është angazhuar në diskutime dhe kërkesa si nevoja emergjente, si për miratimin e hartës së re gjyqësore, ashtu dhe për sistemin e menaxhimit të çështjeve (CAMS) dhe për përmirësime në infrastrukturë në sistemin e prokurorisë, për rritje të kapaciteteve akomoduese me ambiente pune për prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve, administratën dhe shërbimet mbështetëse në prokurori, me synim për të lehtësuar rritjen e ngarkesës dhe mbështetur veprimtarinë e prokurorëve me numër të reduktuar dhe pëmirësuar kushtet e punës, në gjithë sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm.

iii) Këto masa dhe kërkesa për forcimin e kapaciteteve institucionale në sistemin e prokurorisë janë shoqëruar dhe me kërkesën për projektbuxhetin e Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2022, i cili është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin e ri për buxhetin 2022.

2.12.3 Prokuroria e Përgjithshme, në zbatimin të Strategjive dhe Planeve të Veprimit ndërinstytucionale për aktivitete brenda vendit dhe me institucionet ndërkombëtare dhe rajonale ku është përfshirë prokuroria, veç sa më sipër, ka kontribuar periodikisht dhe përgatitur informacionet/materialet lidhur me progresin institucional të prokurorisë në zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SNSD), Strategjisë Kundër Korrupsionit (SNKK), Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur, Strategjisë Kundër Armëve të Vogla e të Lehta (SKAVL), Strategjisë Kundër Krimit të Organizuar (SKKO) dhe Strategjisë Kundër Veprave Penale me Qëllime Terroriste, si dhe i ka dërguar institucioneve përkatëse përgjegjëse (Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme) informacione dhe progresin për zbatimin e tyre.

2.12.4 Në kuadrin e grupit të punës ndërinstytucional, krijuar me urdhrin e PP nr.52, datë 12.05.2021, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të MD, KLP e ILD, me asistencën e ekspertëve të projektit EURALIUS V, misionit OPDAT dhe projektit PAMECA V, Prokuroria e Përgjithshme ka përgatitur projektpropozimin për iniciimin e ndryshimeve dhe shtesave në ligjin nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", si dhe ligjeve⁴⁷ të tjera të përfshira, si nevojë imediate për të adresuar një sërë problematikash të evidentuara gjatë zbatimit në praktikë të këtij kuadri ligjor të sistemit të prokurorisë, i cili ka për qëllim vazhdimin e implementimit të reformës në prokurori, pjesë e reformës në sistemin e drejtësisë penale, si dhe normalizimin e situatës së krijuar nga boshllëku ligjor, për të shmangur problematikat shqetësuese të evidentuara në performancën e veprimtarisë organizative dhe administrative të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe për të rritur efikasitetin dhe performancën në veprimtarinë e tyre.

i) Ky projektpropozim për iniciimin e ndryshimeve dhe shtesave në ligjin nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", si dhe ligjeve⁴⁸ të tjera, është përfshirë në Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërinstytucionale të Drejtësisë e miratuar në dhjetor 2021 dhe do të vijojë trajtimin sipas masave/aktiviteve të parashikuara dhe planifikuara në

⁴⁷ Shih ligjet e tjera që përfshihen: -ligji nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", -ligji nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë", dhe -ligji nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore";

⁴⁸ Shih ligjet e tjera që përfshihen: -ligji nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", -ligji nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë", dhe -ligji nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore";

këtë planveprim, ndryshime ligjore të cilat kërkojnë angazhimin dhe mbështetjen institucionale Tuaj.

🚩 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të realizuar këtë rekomandim prioritar të KM, për faktin se janë realizuar masat dhe aktivitetet më sipër në zbatim të këtij rekomandimi, krahas masave dhe aktiviteteve në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitutional të realizuara në zbatim të Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve të tjera prioritare të KM të trajtuara më sipër, ku përkohë dhe përfshihen edhe masa/aktivitete lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi.

2.13 Lidhur me rekomandimin: “Forcimin e efektivitetit të hetimeve ndaj subjekteve që priren të kryejnë evazion fiskal, por edhe nëpunësve publikë të administratës tatimore dhe asaj doganore, nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve ndërinstitutionale”, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

2.13.1 Prokuroria e Përgjithshme në kuadrin e këtij rekomandimi, rekomandimeve të KSA-së dhe të Planit Veprimit të ICRG/FATF, ka vijuar zbatimin e memorandumit të bashkëpunimit (15 korrik 2020) dhe ka iniciuar dhe miratuar në Korrik 2021 nga përfaqësuesit e PP, DPPSH, DPPPP, DPT,DPD, AAPSK-së urdhrin e përbashkët “Për ngritjen e Sekretariatit Teknik në Prokurorinë e Përgjithshme për zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit”, me synim rritjen e efikasitetit të koordinimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të memorandumit të bashkëpunimit dhe Udhëzimit të Përgjithshëm nr.10/2020 në nivel qendror dhe në nivel vendor, për rritjen e efektivitetit të hetimeve ndaj subjekteve që priren të kryejnë evazion fiskal, por edhe nëpunësve publikë të administratës tatimore dhe asaj doganore, si dhe përcaktimin e rregullave të funksionimit të këtij Sekretariati.

2.13.2 Referuar të dhënave statistikore për vitin 2021(aneksi 1, tabela 17), evidentohet se janë regjistruar 316 procedime penale me 78 të pandehur për grupveprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet ose krahasuar me vitin 2020 me rritje 5.33 % të numrit të procedimeve të regjistruara për këto vepra. Gjatë kësaj periudhe 94 çështje penale me 143 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2020 me ulje 12.14 % të numrit të procedimeve dhe rritje 5.14 % të numrit të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë grup veprash. Ndërkohë konstatohet se për veprën penale “Moskryerja e detyrave nga organet tatimore” të parashikuar nga neni 181/a i K.Penal nuk është regjistruar asnjë procedim penal.

2.13.3 Sa i përket politikës penale në veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet, të dhënat për vitin 2021 tregojnë se, kërkesat e prokurorit lidhur me masat e sigurimit për persona që kanë kryer këtë grupvepra penale 60.71 % janë kërkesë për masë sigurimi me arrest në burg ose krahasuar me vitin 2020 me rritje 19.01 të ashpërsimit të masës arrest në burg. Në lidhje me kërkesat për caktimin e dënimit, për të pandehurit e akuzuar për këtë grup veprash penale rezulton se 22.7 % e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burg, 54.6 % për caktimin e alternativave të dënimit me burg dhe 22.7 % për caktimin e dënimit me gjobë.

🚩 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar rekomandimin e KM, për faktin se treguesit statistikor evidentojnë si rritjen e numrit të hetimeve dhe rritje të numrit të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë grup veprash penale, ashtu dhe evidentohet një

politikë penale më e ashpër në kërkesat e prokurorëve, për caktimin e masave të sigurimit personal dhe në caktimin e llojit të dënimit ndaj autorëve të veprave penale në fushën e evazion fiskal.

3. Aktet normative të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre.

3.1 Prokurori i Përgjithshëm, në përmbushje të objektivave prioritare të prokurorisë lidhur me procesin e implementimit të reformës ligjore në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, në zbatim të detyrave Kushtetuese (*neni 148/b*) e ligjore (*nenet 38, 46, 103, 104 e vijues të ligjit nr.97/2016*), kërkesave të Rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë dhe Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave, dhe jo vetëm, me synim për të normuar dhe unifikuar veprimtarinë administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, përgjatë dy viteve ka vlerësuar detyrimet dhe nevojat për nxjerrjen e akteve të reja normative dhe/ose ndryshimin/plotësimin e tyre, dhe ka miratuar aktet normative si udhëzime të përgjithshme, urdhra për miratimin e rregulloreve ose planeve të veprimit për zbatimin e politikave institucionale, ndërinstitutionale dhe rekomandimeve të institucioneve kushtetuese e ndërkombëtare, ku për vitin 2021 mund të veçojmë aktet normative, si vijojnë:

3.1.1 Udhëzimet e Përgjithshme të miratuara nga Prokurori Përgjithshëm:

- ✓ “Për pastrimin, nxjerrjen jashtë përdorimit, shkatërrimit dhe asgjësimit të pajisjeve TIK në prokurori”, miratuar me nr.1, datë 30.01.2021;
- ✓ “Për disa ndryshime e shtesa në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.3, datë 21.06.2019 “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore”, miratuar me nr.2, datë 31.03.2021;
- ✓ “Për pastrimin dhe shkatërrimin e pajisjeve TIK që trajtojnë informacion të klasifikuar në Prokurorinë e Përgjithshme dhe strukturave në varësi”, miratuar me nr.3, datë 17.06.2021;
- ✓ “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” miratuar me nr.4, datë 09.07.2021;
- ✓ “Për një shtesë në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.14, datë 21.09.2020 “Për ushtrimin e të drejtës së hyrjes në bazat e të dhënave të të tretëve”, miratuar me nr.5, datë 19.07.2021;
- ✓ “Për disa ndryshime e shtesa në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.08, datë 19.05.2020 “Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, miratuar me nr.6, datë 23.07.2021;
- ✓ “Për administrimin, qarkullimin dhe ruajtjen e vendimeve të përgjimit parandalues të klasifikuara “Sekret Shtetëror”, me nr.7, datë 23.09.2021;
- ✓ “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktim dhe ose dëshmitar”, miratuar me nr.8, datë 15.11.2021;
- ✓ “Për marrëveshjen mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit”, miratuar me nr.9, datë 21.12.2021;
- ✓ “Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimi me institucionet kushtetuese e ligjore”, miratuar me nr.10, datë 30.12.2021;

3.1.2 Urdhra të Prokurorit të Përgjithshëm, ku ndër të tjerët, parashtroj:

- o “Plani i Veprimit “Për zbatimin e kërkesave të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 14.06.2021 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2021”, miratuar me urdhrin nr.78 datë 09.07.2021;
- o “Plani i Veprimit “Për zbatimin e “Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021”, miratuar me urdhrin nr.79, datë 09.07.2021;
- o “Për miratimin e rregullave për përdorimin e sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur”, miratuar me urdhrin nr.87, datë 28.07.2021;
- o “Për përdorimin e regjistrat elektronik dhe përfitim të statistikave për çështje të pastrimit të parave në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”, miratuar me urdhrin nr.92 datë 30.07.2021;

3.1.4 Udhëzimet e përgjithshme dhe aktet e tjera normative në zbatim të ligjit⁴⁹ janë të publikuara në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe i janë dërguar për zbatim të gjithë prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

3.1.5 Drejtuesit e prokurorive janë udhëzuar për marrjen e masave në zbatim të kompetencave ligjore të tyre, si për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm⁵⁰, dhe për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme⁵¹ për prokurorët për çështje konkrete, ashtu dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre sipas ligjit, me synim që të sigurohet respektimi i parimit detyrueshmëria⁵² e ndjekjes penale, efica, ligjshmëria dhe transparenca në veprimtarinë e prokurorive që drejtojnë, duke garantuar pavarësinë e prokurorit⁵³ në ushtrimin e funksioneve kushtetuese e ligjore.

3.2 Ashtu siç jeni informuar, në vitin 2021 vetëm kundër një udhëzimi të përgjithshëm të ndryshuar⁵⁴ është ushtruar ankimi në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i cili me vendimin nr.59 datë 18.03.2021⁵⁵ ka vendosur: *Rrëzimin si të pabazuar në ligj të dy kërkesave në ankimin e prokurorit..., duke arsyetuar se “...ky udhëzim... i përmbahet në mënyrë korrekte parashikimeve Kushtetuese dhe atyre ligjore...”*.

⁴⁹ Shih, nenin 46 pika 5 e ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

⁵⁰ Shih, po aty pikën 4 të nenit 46 që parashikon: “4. Drejtuesi i prokurorisë mund të nxjerr udhëzime të përgjithshme për çështje të organizimit dhe të funksionimit të prokurorisë që drejton, si dhe për lehtësimin e zbatimit të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm...”

⁵¹ Shih, po aty nenet 43 e 48. ⁵¹ Shih, po aty nenet 43 e 48.

⁵² Shih, po aty nenin 5 që parashikon: “Ushtrimi i ndjekjes penale është i detyrueshëm, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe”

⁵³ Shih, po aty, nenin 5 që në pikat 1 e 2 parashikon: “1.Në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët kryejnë veprime, parashitje kërkesa dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë. 2.Prokurorët u nënshtrohen udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të prokurorit më të lartë, sipas dispozitave të këtij ligji.”

⁵⁴ Udhëzimi i Përgjithshëm nr.12/2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokuroriaë. Informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” dhe Udhëzimi i Përgjithshëm nr.16/2020 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokuroriaë. Informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”

⁵⁵ Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr.59 datë 18.03.2021⁵⁵ ka vendosur: “1.Rrëzimin si të pabazuar në ligj të kërkesës së prokurorit A.K. për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Udhëzimit të Përgjithshëm 16, datë 14.12.2020 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” të Prokurorit të Përgjithshëm; 2.Rrëzimin si të pabazuar në ligj të kërkesës së prokurorit A.K. për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokuroriaë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, të Prokurorit të Përgjithshëm”.

3.3 Në kuadrin e mbikëqyrjes së zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme dhe kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë, në mbështetje të nenit 148/b shkronja “b” e Kushtetutës, neneve 38 pika 2 shkronjat “b”, “c”, “f”, 104 pika 2 e vijues të ligjit nr.97/2016 i ndryshuar, Prokurori i Përgjithshëm për të monitoruar si zbatimin, ashtu dhe si kanë ndikuar udhëzimet e përgjithshme në gjendjen e kriminalitetit në fushat e rekomanduara dhe efektivitetin e ushtrimit të ndjekjes penale në fushat përkatëse, periodikisht ka kërkuar informacione drejtuesve të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm lidhur me masat e marra në zbatim të kompetencave ligjore të tyre, nëse kanë nxjerrë udhëzime të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, dhe nëse kanë marrë masa, për koordinimin e veprimtarisë me prokuroritë e tjera, apo për kërkimin e informacionit për ecurinë e procedimeve dhe/ose për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për prokurorët lidhur me çështje konkrete, apo nxjerrjen e urdhrave për policinë gjyqësore lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre.

i) Kjo veprimtari ka synuar dhe synon që drejtuesit e prokurorive të sigurojnë efikasitetin, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e prokurorisë, si dhe efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurorët e prokurorisë që drejtojnë, në përmbushje të kërkesave dhe/ose rekomandimeve, si në marrëdhënie me institucionet kushtetuese brenda vendit, ashtu dhe në marrëdhënie me institucionet ndërkombëtare dhe në raportimin e progresit në kuadrin e integritetit evropian të vendit, gjithmonë duke garantuar pavarësinë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve kushtetuese e ligjore.

3.4 Në informacionet e përcjella nga drejtuesit e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm rezulton se pothuajse të gjitha prokuroritë kanë marrë masa për zbatimin e drejtpërdrejtë të këtyre udhëzimeve të përgjithshme dhe akteve nënligjore të tjera.

i) Në disa prokurori drejtuesit e prokurorisë kanë marrë, si masa administrative për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme dhe/ose hartimin e planeve të veprimit për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme dhe/ose planeve të veprimit të Prokurorit të Përgjithshëm, ashtu dhe masa procedurale për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme dhe/ose kërkuar informacion prokurorëve për ecurinë e çështje konkrete, duke garantuar pavarësinë e tyre.

ii) Në disa prokurori të tjera, drejtuesit e prokurorisë rezulton se nuk kanë marrë masa të plota administrative dhe/ose procedurale për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme dhe planeve të veprimit të Prokurorit të Përgjithshëm, të nxjerrë në kuadrin e Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve prioritare të KM, apo për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete, duke i zbatuar ato pjesërisht apo me mangësi serioze.

iii) Gjithashtu, konstatohen raste të mungesës së përsëritur të informimit dhe/ose mosrepektim i afatit të tij nga drejtuesit e disa prokurorive mbi zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme dhe/ose ngritjes së infrastrukturës përkatëse administrative për lehtësimin e kushteve për zbatimin e tyre, ose nuk i është dërguar Prokurorit të Përgjithshëm raporti vjetor brenda afatit, që është një detyrim ligjor⁵⁶ shumë i rëndësishëm.

⁵⁶ Neni 50 “Raportimi vjetor të Prokurorit të Përgjithshëm” i ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili në pikën 2 parashikon: “2. Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apelit të

3.5 Në këtë gjendje jo efiçente në marrëdhënie me drejtuesit e prokurorive dhe në veprimtarinë administrative të drejtuesve, vlerësojmë se ndikon edhe boshllëku i evidentuar në kuadrin ligjor në fuqi, ku mund të veçojmë drejtimit siç janë:

i) Rregullimi ligjor aktual vështirëson lidhjen organike efektive mes zyrave të prokurorisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, në kuptim të ushtrimit të detyrave ligjore dhe kushtetuese, ndërkohë që angazhimet institucionale që dalin nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave apo rekomandime të institucioneve ndërkombëtare kërkojnë një nivel më të lartë kohezioni institucional.

ii) Rregullimi ligjor aktual në procesin e promovimit/caktimit, vlerësimit të veprimtarisë, pezullimit apo shkarkimit të drejtuesve të prokurorisë nuk është i qartë dhe nuk parashikon vlerësimin e indikatorëve ligjorë matës të performancës së drejtuesve në veprimtarinë organizative dhe/ose administrative, dhe të marrëdhënieve të drejtuesit të prokurorisë me Prokurorin e Përgjithshëm në këtë fushë, elementë këto shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punës dhe në ushtrimin e kompetencave kushtetuese e ligjore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

iii) Në kuadrin ligjor në fuqi, gjithashtu evidentohet boshllëku ligjor në drejtim të vlerësimit të performancës së prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe përgjegjësia e drejtuesve për vlerësimin e performancës së prokurorisë që drejtojnë, e cila ndryshon nga vlerësimi individual i performancës së drejtuesve apo prokurorëve.

iv) Në këtë vështrim, vlerësimi i performancës së prokurorive kërkon një përfshirje më të madhe të Prokurorisë së Përgjithshme në procesin e llogaridhënies dhe evidentimit të përgjegjësiave e masave vijuese, për sa kohë Prokurori i Përgjithshëm kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore e kushtetuese të prokurorisë dhe është përgjegjës dhe për punën e prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

3.6 Sigurimi i pavarësisë së prokurorëve është një arritje, e cila duhet të garantohet, por problematikat dhe gjendja e kuadrit ligjor në drejtimit e evidentuara vlerësojmë se ka nevojë për ndërhyrje të nevojshme ligjore që do të sigurojnë funksionimin e prokurorisë si një e tërë, që vepron shpejt në drejtim të përcaktimit të prioriteve, ndjekjes së tyre në mënyrë të bashkërenduar brenda saj dhe me insitucionet e tjera, përmes masave organizative, administrative apo mirëpërdorimit të burimeve njerëzore e financiare, duke pasur në themel pavarësinë procedurale të prokurorëve.

3.7 Në këtë vështrim, referuar kuadrit Kushtetues dhe ligjor, konstatojmë se:

3.7.1 Kushtetuta në nenin 148/b dhe ligji 97/2016 në nenin 38 e vijues, kanë parashikuar kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm (në vijim PP), siç janë: -siguron mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë, -propozon dhe administron buxhetin e prokurorisë; -është drejtuesi i Prokurorisë së Përgjithshme dhe ka përgjegjësi për punën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të apelit dhe shkallës së parë; -kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore e kushtetuese të prokurorisë, -përcakton strukturat, organikën dhe rregulloret standard, etj.

juridiksionit të përgjithshëm, brenda muajit shkurt të çdo viti, raportin vjetor mbi ecurinë e punës në prokurorinë përkatëse dhe ia paraqesin Prokurorit të Përgjithshëm...”

i) Ndërsa, Kushtetuta dhe ligji, për Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP-në), nuk parashikon anjë kompetencë të tillë në raportë me sistemin e prokurorisë. Për më tepër, institucioni i KLP-së ka si funksion kushtetues, garantimin e pavarësisë, llogaridhënies, disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë dhe jo kompetenca për të siguruar mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë.

ii) Në këtë vështrim, gjithashtu, konstatojmë dhe vlerësojmë se, kompetencat e KLP-së të njësuara me ato të KLGJ në ligjin nr.96/2016 dhe në ligjin nr.97/2016, lidhur me caktimin e kancelarëve në prokurori apo caktimin e këshilltarit ligjor jomagjistrat në Prokurorinë e Përgjithshme (me ligjin nr.42/2021) apo kompetenca të tjera që lidhen me përgjegjësitë në veprimtarinë dhe mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë, çmojmë se nuk janë në përqasje me dispozitat e sipërcituara të Kushtetutës, të cilat ngarkojnë Prokurorin e Përgjithshëm dhe jo Këshillin e Lartë të Prokurorisë për ushtrimin e këtyre kompetencave dhe përgjegjësie.

iii) Në këto vështirime kushtetuese e ligjore, vlerësojmë se kompetencat e KLP-së në drejtim të organizimit dhe funksionimit administrativ të prokurorisë: -kanë krijuar një konflikt normativ kompetencash ligjore me ato kushtetuese; dhe -ndikojnë drejtëpërdrejtë në ushtrimin e detyrës të Prokurorit të Përgjithshëm, pasi përgjegjësia që i ngarkohet nuk është në përpjestim të drejtë me autoritetin që i është dhënë dhe instrumentat që disponon në marrëdhënie me hallkat e sistemit të prokurorisë, për të mundësuar përmbushjen e përgjegjësiave që e ngarkon Kushtetuta dhe ligji.

3.6.2 Për arsyet më sipër, sugjerohet rivlerësimi i dispozitave ligjore përkatëse në përqasje me dispozitat kushtetuese në fuqi për iniciimin e ndërhyrjeve të nevojshme në nenet përkatëse në ligjin 97/2016, ligjin nr.96/2016 apo ligjin nr.115/2016.

3.7 Për arsyet më sipër, në kuadrin e grupit të punës ndërinstitucional, krijuar me urdhrin e PP nr.52, datë 12.05.2021, me përfaqësues nga KLP, MD dhe ILD-ja, me asistencën e ekspertëve të projektit EURALIUS V, misionit OPDAT dhe projektit PAMECA V, Prokuroria e Përgjithshme ka përgatitur projektpropozimin për iniciimin e ndryshimeve dhe shtesave në ligjin nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", si dhe ligjeve⁵⁷ të tjera të përfshira, si nevojë imediate për të adresuar një sërë problematikash të evidentuara gjatë zbatimit në praktikë të këtij kuadri ligjor të sistemit të prokurorisë, i cili ka për qëllim vazhdimin e implementimit të reformës në prokurori, pjesë e reformës në sistemin e drejtësisë penale, si dhe normalizimin e situatës së krijuar nga boshllëku ligjor, për të shmangur problematikën e evidentuara në performancën e veprimtarisë organizative dhe administrative të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe për të rritur efikasitetin dhe performancën në veprimtarinë e tyre.

i) Ky dokument ofron një përmbledhje të projektpropozimit për iniciimin e ndryshimeve dhe shtesave në ligjin nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", me ndikim në disa dispozita në ligjin nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe ligjin nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë", i përgatitur pas një analize ligjore të krahasuara me dispozitat Kushtetuese përkatëse lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm në raport me

⁵⁷ Shih ligjet e tjera që përfshihen: -ligji nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", -ligji nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë", dhe -ligji nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore";

përgjegjësitë dhe kompetencat organizative dhe administrative, si të drejtuesit të prokurorisë dhe kancelarit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, ashtu dhe të Sekretarit të Përgjithshëm dhe këshilltarit ligjor jomagjistrat, etj në Prokurorinë e Përgjithshme.

ii) Ky projektpropozim për iniciimin e ndryshimeve dhe shtesave në ligjin nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", si dhe ligjeve⁵⁸ të tjera, është përfshirë në Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërinstitucionale të Drejtësisë i miratuar në dhjetor 2021 dhe do të vijojë trajtimi sipas masave/aktiviteve të parashikuara dhe planifikuara në këtë Planveprimi, të cilat kërkojnë angazhimin dhe mbështetjen institucionale Tuaj.

iii) Për më tepër, ky projekt propozim është mbështetur nga projekti EURALIUS V, në Raportin Përfundimtar, ku për Prokurorinë e Përgjithshme, krahas rekomandimeve për aktivitete të tjera vazhduese, ka rekomanduar "...Rishikimin e kuadrit ligjor që rregullon funksionimin e prokurorisë për t'i mundësuar Prokurorit të Përgjithshëm ushtrimin efikas të funksioneve dhe mbarëvajtjen e punës administrative në sistemin e prokurorisë...⁵⁹".

4. Përmbledhje e tendencave të kriminalitetit sipas grupveprave

Në analizë dhe vlerësim të ndikimit të politikave institucionale dhe politikave të rekomanduara në kërkesat e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave, rekomandimet e BE-së për Shqipërinë, dhe jo vetëm, të përcuara nga Prokurori i Përgjithshëm nëpërmjet udhëzimeve të përgjithshëm dhe akteve normative të tjera në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, se si kanë ndikuar ato, dhe jo vetëm, mbi tendenca e kriminalitetit të reflektuara në numrin e procedimeve të regjistruara, evidentohen treguesit statistikorë, si më poshtë:

4.1 Për vitin 2021 vërehet **tendenca në ulje e numrit të procedimeve të regjistruara** për veprat penale si më poshtë:

- "Krimet Kundër jetës të kryera me dashje⁶⁰", **14,17 %**;
- "Krimet kundër jetës të shkaktuar me pakujdesi", **12,5 %**;
- "Veprat Penale kundër shëndetit të kryera me dashje⁶¹", **4,41 %**;
- "Veprat penale kundër shëndetit të shkaktuar me pakujdesi", **41,17 %**;
- "Veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose nga mosdhënia e ndihmës⁶²", **17,84 %**;
- "Veprat penale kundër lirisë së personit", **11,2 %**;
- "Veprat penale kundër vjedhjes së pasurisë⁶³" **12,67 %**;
- "Veprat penale të falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë", **17,95%**;
- "Veprat penale kundër mjedisit⁶⁴", **5,14%**;

⁵⁸ Shih ligjet e tjera që përfshihen: -ligji nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", -ligji nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë", dhe -ligji nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore";

⁵⁹ Raporti Final 1 Prill 2018 – 31 Dhjetor 2021 të Projektit EURALIUS V, Rubrika "Rekomandime" parg.dytë, faqe 35.

⁶⁰ Veçuar vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare dhe vrasja e foshnjës;

⁶¹ Veçuar plagosja e rëndë në gjendje të tronditjes së fortë psikike;

⁶² Veçuar neglizhenca në trajtimin mjekësor;

⁶³ Veçuar vjedhja me pasojë vdekjen dhe trafikimi i mjeteve motorike dhe trafikimi i veprave të artit dhe kultures;

- “Veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit⁶⁵”, **21,44 %**;
- “Veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik⁶⁶”, **8,89 %**;
- “Veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë⁶⁷”, **1,83 %**;
- “Veprat penale të trafikeve të paligjshme⁶⁸”, **3,1 %**;

4.2 Për sa i përket veprave penale të mëposhtme, vihet re **një rritje e numrit të procedimeve të regjistruara** për vitin 2021. Kështu:

- “Krimet seksuale”, **16,18 %**;
- “Veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit”, **26,2 %**;
- “Veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes⁶⁹”, **10,13 %**;
- “Veprat penale të mashtrimit⁷⁰”, **20,74 %**;
- Veprat penale të shkatërrimit të pronës”, **1,4 %**;
- “Veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare⁷¹”, **20,93 %**;
- “Veprat penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare”, **18,75 %**;
- “Krimet në fushën e doganave”, **2,44 %**;
- “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet”, **5,33 %**;
- “Veprat penale të falsifikimit të dokumenteve⁷²”, **7,42 %**;
- “Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit”, **69,5 %**;
- Veprat penale që çënojnë regjimin juridik të tokës”, **11,89 %**;
- “Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike”, **9,62 %**;
- “Veprat penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale”, **5,24 %**;
- Veprat penale kundër drejtësisë”, **10,12 %**;
- “Veprat penale kundër prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve”, **16,68 %**.
- “Veprat penale kundër krimit kompjuterik”, **48,08 %**.

4.3 Referuar analizës dhe vlerësimit të tendencave të kriminalitetit sipas grupveprave më sipër, bazuar në të dhënat statistikore, të trajtuara edhe tek efektiviteti i ndjekjes penale në raport, evidentohet se tendencat në ulje dhe/ose në rritje të numrit të procedimeve të regjistruara për disa grup veprash penale, jo në të gjitha rastet kanë qenë të ndikuara nga efektiviteti i ndjekjes penale të ushtruar për këto grup veprash.

i) Analizës dhe vlerësimit të shkaqeve të uljes dhe/ose rritjes së tendencave të kriminalitetit, theksojmë se i mungon kontributi në raportet vjetore të ecurisë së punës të prokurorive të rretheve

⁶⁴ Veçuar menaxhimi i mbetjeve, shkatërrimi me zgjarr dhe/ose nga pakujdesia i pyjeve, braktisja e kafshës së shoqërimit, vrasja me dashje dhe keqtrajtimi i kafshës së shoqërimit;

⁶⁵ Veçuar korrupsioni, neni 244 K.Penal;

⁶⁶ Veçuar korrupsioni, neni 259 K.Penal;

⁶⁷ Veçuar ndihmën për kalim të paligjshëm të kufirit;

⁶⁸ Veçuar trafikimi i mjeteve motorike dhe trafikimi i veprave të artit dhe kultures;

⁶⁹ Veçuar trafikimi i të miturve dhe keqtrajtimi i të miturve;

⁷⁰ Veçuar krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin e vleres së shtuar, mashtrimi në sigurime dhe shkelja e të drejtës së pronësisë intelektuale;

⁷¹ Veçuar korrupsioni në sektorin privat;

⁷² Veçuar falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve;

gjyqësore, megjithë se ju është kërkuar zyrtarisht drejtuesve të prokurorive për të vlerësuar dhe pasqyruar në raportet vjetore për vitin 2021 dhe këtë aspekt të punës së prokurorisë që ata drejtojnë.

5. Efektiviteti i ndjekjes penale, cilësia e përfaqësimit të akuzës në gjyq dhe elemente të tjerë thelbësorë të veprimtarisë së institucionit

Në analizë dhe vlerësim të ndikimit të politikave institucionale dhe politikave të rekomanduara nga institucionet kushtetuese, të përcuara nëpërmjet udhëzimeve të përgjithshëm dhe akteve normative të tjera në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, mbi disa tregues sintetik siç janë dhe efektiviteti i ndjekjes penale, cilësia e përfaqësimit të akuzës në gjyq dhe elemente të tjerë thelbësor në ndjekjen penale, dhe jo vetëm, evidentohen treguesit statistikorë, si më poshtë:

5.1 Tregues të përgjithshëm të efektivitetit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të çështjeve/akuzave në gjyq

i) Gjatë vitit 2021 janë përfunduar 26169 çështje që përbën ulje prej 1,84 % të çështjeve të përfunduara krahasuar me vitin 2020, prej të cilave: 40,86 % janë dërguar për gjykim, 22,62 % janë pushuar, 33,72 % janë pezulluar dhe 2,8 % janë transferuar në prokuroritë kompetente.

ii) Janë dërguar në gjykatë 10507 çështje me akuzë ndaj 12353 të pandehurve. Krahasimisht me vitin 2020 rezulton një rritje prej 5,35 e numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë dhe 7,38 % e numrit të të pandehurve dërguar në gjykatë.

iii) Në lidhje me vendimet e gjykatës, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2021 janë dënuar 8371 të pandehur dhe për 144 të pandehur është dhënë vendim për deklarimin të pafajshëm ose krahasuar me vitin 2020 me rritje 4,35 % e numrit të pandehurve të dënuar dhe ulje 5,26 % e numrit të pandehurve të deklaruar të pafajshëm.

iv) Në gjykatë janë dërguar 264 kërkesa për miratim të urdhrit penal në lidhje me 269 të pandehur ose krahasuar me vitin 2020 me ulje 44,59 % të kërkesave dhe ulje 35,16% të kërkesave për miratimin e urdhrit penal, ndërsa nga gjykata është vendosur refuzimi i miratimit të urdhrit penal në 12 raste ose krahasuar me vitin 2020 me shifra të njëjta të rasteve që është vendosur nga gjykata refuzimi i miratimit të urdhrit penal dhe kthimi i akteve.

v) Në gjykatë, gjithashtu, janë dërguar 520 kërkesa për miratim të marrëveshjes së fajësisë në lidhje me 537 të pandehur ose krahasuar me vitin 2020 me ulje 29,7 % të kërkesave për miratim marrëveshje, ndërkohë nga gjykata është vendosur refuzimi i miratimit të marrëveshjes në 24 raste ose krahasuar me vitin 2020 me ulje 46,66 % të rasteve që është vendosur nga gjykata refuzimi i miratimit të marrëveshjes dhe kthimi i akteve.

vi) Gjatë vitit 2021, u dërguan në gjykatë për pushim 4686 çështje ose me rritje 0,83% krahasuar me vitin 2020, prej të cilëve 34,07 % janë pushuar për mungesë fakti. Nga të dhënat rezulton se për 144 çështje gjykata ka vendosur kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve ose me ulje 38,19 % krahasuar me vitin 2020, ndërsa në 6 çështje vendosi kthimin e akteve dhe urdhërimin e formulimit të akuzës, krahasuar me 5 vendime të tilla në vitin 2020.


vii) Ndërkohë, është kërkuar gjykimi i drejtëpërdrejtë për 278 çështje me 290 të pandehur, që krahasuar me vitin 2020, përbëjnë rritje prej 13,88% të numrit të çështjeve dhe 15,07 të numrit të të pandehurve për të cilët është kërkuar ky lloj gjykimi.

5.2 Efektiviteti i përgjimit të komunikimeve elektronike në hetimet paraprake


i) Gjatë vitit 2021, në kuadrin e 655 procedimeve penale, me anë të përdorimit të mjeteve të posaçme hetimore, në zbatim të kriterëve ligjore, është arritur në arrestimin/ndalimin e 640 personave të dyshuar për krime kundër rendit dhe sigurisë publike, kundër jetës dhe kundër autoritetit të shtetit, dhe për vepra penale kundër lirisë së personit, korrupsion, shpërdorim detyre, në fushën e narkotikëve, pastrimi produkteve të veprimtarisë kriminale, trafike të paligjshme vepra të tjera të rënda, duke parandaluar kështu pasoja e mëtejshme për shtetin dhe shtetasit.

ii) Në shifra të përgjithshme, gjatë vitit 2021 janë ekzekutuar gjithsej 1534 vendime për përgjim të autorizuara nga gjykata në hetimet paraprake dhe 741 autorizime dhe urdhëra të prokurorit. Për sa më sipër është mundësuar interceptimi për 3664 pajisje fundore në përdorim të 3412 personave të dyshuar si të përfshirë në vepra penale.

Ecuria e këtij mjeti kërkimi prove në dy vitet e fundit paraqitet në grafikun në vijim:



Grafiku mëposhtë paraqet procedimet sipas grupveprave penale për të cilat është kërkuar përgjimi i komunikimeve elektronike në hetimet paraprake:




II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT, TË DHËNA PËR NUMRIN, LLOJET, SHTRIRJEN TERRITORIALE DHE FORMAT E KRIMINALITETIT

VOLUMI I PUNËS NË HETIM PËR VITIN 2021⁷³

Gjatë vitit 2021, në organin e prokurorisë janë trajtuar 61015 materiale në shqyrtim⁷⁴ që përbën një rritje prej 4,35 % në krahasim me vitin 2020. Janë ndjekur gjithsej 47512 procedime penale, që përbëjnë një rritje prej 5,97 % në krahasim me vitin 2020, nga të cilat 28368 janë procedime penale të regjistruara, me një rritje prej 1.71 % në krahasim me vitin 2020 dhe 940 procedime penale të rifilluara, që tregon rritje prej 46,87 % në krahasim me vitin 2020. Janë mbartur, 18204 procedime penale me një rritje prej 11,65 % krahasuar me procedimet e mbartura në vitin 2020. Është vendosur mosfillimi për 13503 referime dhe kallëzime penale, që do të thotë një ulje prej 0.94 % në krahasim me vitin 2020.

Volumi i punës në hetim i organit të prokurorisë për vitin 2021 paraqitet si vijon:



2.2 ÇËSHTJE TË PËRFAQËSUARA NË GJYKATË

⁷³ Procedimi penal nuk njësohet me vepër penale, pasi:

- 1- Sistemi statistikor i prokurorisë regjistron të dhëna **për veprën penale më të rëndë**, pavarësisht se mund të jenë kryer disa vepra penale.
- 2- Në bazë të nenit 79 e 93 të Kodit të Procedurës Penale prokurori vendos bashkimin ose ndarjen e procedimeve.


⁷⁴ Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara/shqyrtuara përfshihen: procedimet e mbartura; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2021 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2021; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2021.

Gjatë vitit 2021 nga prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 10507 procedime penale (rritje prej 5,07 % në krahasim me vitin 2020) me 12353 të pandehur (rritje prej 7,14 % në krahasim me vitin 2020). Gjithashtu, janë paraqitur në gjykatë 14573 kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal.

Nga prokuroritë pranë gjykatës të apelit është përfaqësuar akuza në emër të shtetit shqiptar për 1491 çështje themeli (rritje prej 39,3 % në krahasim me vitin 2020) dhe 2774 raste për masat e sigurimit personal (rritje prej 10,03 % në krahasim me vitin 2020).

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar organin e akuzës pranë Gjykatës së Lartë në 54 çështje, prej të cilave 34 gjykime themeli (nga 4 gjykime themeli në vitin 2020), ku tre janë për vendime njësuese, dhe 20 gjykime masa sigurimi (asnjë gjykim për masa sigurimi në vitin 2020), si dhe në cilësinë e subjektit të interesuar pranë Gjykatës Kushtetuese për 5 çështje (nga 1 çështje në vitin 2020).

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat në përqindje për çështjet e përfaqësuara në gjykatë në të tre shkallët:




2.3 TREGUESIT KRYESORË TË PUNËS SË PROKURORISË NË PESË VITET E FUNDIT

Procedime të regjistruara dhe në ndjekje

Të dhënat statistikore për këtë tregues rezultojnë se, në vitin 2021 janë regjistruar 28368 procedime penale që përbën rritje prej 1,71 % krahasuar me vitin 2020.

Të dhënat statistikore për procedimet penale në ndjekje në vitin 2021 rezultojnë 47512 procedime që përbën rritje prej 5,97 % krahasuar me vitin 2020.


Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike procedimet penale të regjistruara dhe procedimet në ndjekje në pesë vitet e fundit nga organi i prokurorisë:



Ndjekja penale në bazë të Kodit Penal Ushtarak

Pesha specifike që zënë procedimet penale të regjistruara në bazë të Kodit Penal Ushtarak në numrin total të procedimeve penale të regjistruara në prokurori gjatë vitit 2021 është 0,07 %, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 0,14 %.


Grafikët në vijim paraqesin të dhënat e volumit të punës në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës, për veprat penale në fushën e zbatimit të Kodit Penal Ushtarak:



Siç vërehet nga grafiku, në vitin 2021, janë regjistruar 19 procedime penale në bazë të Kodit Penal Ushtarak, janë mbartur 12 procedime penale dhe është vendosur mosfillimi për 2 kallëzime/referime.

Gjatë vitit 2021 nga prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 10 procedime penale.

Procedimet penale janë regjistruar për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal Ushtarak që paraqiten në grafikun në vijim:



Në vijim të dhënat lidhen me vepra penale të parashikuara në Kodin Penal, ligji nr.7895/1995 i ndryshuar.

Çështje të përfunduara

Në lidhje me **çështjet e përfunduara**⁷⁵, të dhënat statistikore tregojnë se në vitin 2021 rezulton një ulje prej 1,84 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2020.

Në lidhje me **çështjet e pushuara**, në vitin 2021 rezulton një ulje prej 1,82 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2020.

Në lidhje me **çështjet e pezulluara**, në vitin 2021 rezulton një ulje prej 7,84 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2020.


Në lidhje me **çështjet e dërguara në gjykatë**, në vitin 2021 rezulton një rritje prej 5,25 % e çështjeve të dërguara në gjykatë⁷⁶ në krahasim me vitin 2020.

Lidhur me numrin e të **pandehurve** të dërguar në gjykatë vërehet se në vitin 2021 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është rritur me 7,3 % krahasuar me vitin 2020.


Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike të dhënat e pesë viteve të fundit:

⁷⁵ Në këtë tregues përveç çështjeve të pushuara, pezulluara dhe dërguar gjyqit mblihen edhe çështjet e transferuara.

⁷⁶ Në këtë tregues janë përfshirë edhe kërkesat për dërgimin e çështjes në gjykatë drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake si dhe kërkesat për miratimin e urdhrat penal dhe marrëveshjes së fajësisë.



Më poshtë paraqiten të dhëna në **lidhje me të pandehurit** sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake në pesë viteve të fundit:




Vendimmarrja e gjykatës

Vendi që zënë vendimet e gjykatës për **pushimin e çështjeve**, përkundrejt numrit total të çështjeve të dërguara në gjyq, në vitin 2021 përbën 1,35 % të çështjeve të dërguara në gjyq, ndërsa në vitin 2020 ky tregues është 1,28 %.

Në lidhje me **pushimin e akuzës** për të pandehurit, në vitin 2021 është vendosur pushimi i akuzës për 0,18 % të akuzave të ngritura, ndërsa në vitin 2020 është vendosur pushimi i akuzës për 0,13 % të akuzave të ngritura.

Në lidhje me **vendimet e gjykatës për pafajësinë**, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2021 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjykatë 1,17 % kanë marrë pafajësi, ndërsa në vitin 2020 kanë marrë pafajësi 1,32 % e totalit të pandehurve të dërguar në gjykatë.


Më poshtë paraqiten të dhëna në pesë vite (2017-2021) në lidhje me të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë nga organi i prokurorisë dhe vendimet e gjykatës për dhënie pafajësi:




Pezullimet

Në vitin 2021 procedimet që është vendosur pezullimi i hetimeve përbëjnë 33,73 % të procedimeve të përfunduara. Të dhënat tregojnë se ndër 8864 procedime të pezulluara, 8663 prej tyre janë pezulluar për shkak se nuk njihet autori i veprës penale dhe 1 procedim është pezulluar për shkak se i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm.

Grafiku në vijim paraqet të dhënat për procedimet e pezulluara në vitet 2017-2021:




Procedimet penale të pezulluara sipas grup veprave penale për vitin 2021, paraqiten grafikisht si më poshtë (në grafik nuk janë përfshirë procedimet e pezulluara për grup veprat penale numri i të cilave është më i ulët se 20):




Mosfillimet

Në lidhje me referimet dhe kallëzimet për të cilat është vendosur mosfillimi, nga të dhënat statistikore rezulton se, në vitin 2021 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 13503 referime dhe kallëzime ose një ulje prej 0,94 % krahasuar me vitin 2020.


Të dhëna të detajuara gjenden në grafikun e mëposhtëm:



2.4 PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA SIPAS PROKURORIVE PRANË GJYKATËS TË SHKALLËS SË PARË



Më poshtë paraqiten të dhënat në përqindje mbi procedimet penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitin 2021:



Paraqitja grafike evidenton se numrin më të madh të procedimeve e kanë regjistruar prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë me 31.31 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera me shifrat më të larta janë: Elbasan regjistruar 9.31 %, Durrës regjistruar 9.18 %, Vlorë regjistruar 6.77 %, Fier regjistruar 5.63 %, Shkodër regjistruar 5.44 % dhe Korçë regjistruar 4,73 %, të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Tropojë, Mat, Pukë, Përmet me më pak se 1% të numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi.

2.5 KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT PËR 100,000 BANORË⁷⁷


Koeficienti i kriminalitetit për procedimet penale të regjistruara, për 100,000 banorë në vitin 2021 është **1002**, ndërsa në vitin 2020 koeficienti i kriminalitetit ka qenë **979**. Në lidhje me koeficientet e kriminalitetit për 100,000 banorë sipas qarqeve, të dhënat statistikore rezultojnë si më poshtë:

⁷⁷ <http://ëëë.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/>

Në qarkun Berat që përfshin prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë në vitin 2021 është 789; në qarkun Dibër që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër dhe Mat, koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 633; në qarkun Durrës që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës dhe Krujë, koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 1087; në qarkun Elbasan që përfshin prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 736; në qarkun Fier që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Fier dhe Lushnjë koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 817; në qarkun Gjirokastrë që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Gjirokastrë dhe Përmet koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 1380; në qarkun Korçë që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Korçë dhe Pogradec koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 839; në qarkun Kukës që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Kukës dhe Tropojë koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 1122; në qarkun Lezhë që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lezhë dhe Kurbin koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 1382; në qarkun Shkodër që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Shkodër dhe Pukë koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 855; në qarkun Tiranë që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Tiranë dhe Kavajë koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 1063 dhe në qarkun Vlorë që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Vlorë dhe Sarandë koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 1509.

Siç rezulton nga të dhënat, përqindjen më të ulët të koeficientit të kriminalitetit edhe në vitin 2021 e ka qarku Dibër, ndërsa përqindjen më të lartë e ka qarku Vlorë.

Renditja dhe të dhënat e kriminalitetit në dy vitet e fundit paraqiten grafikisht në vijim:



2.6 TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE

Bazuar në të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2021 janë **filluar kryesisht** 125 procedime penale nga ana e prokurorisë.


Kallëzime nga nëpunësit publikë: në vitin 2021 rezulton të kenë ardhur në prokurori 810 kallëzime, që përbën ulje prej 3,57 % krahasuar me vitin 2020.

Kallëzime nga personeli mjekësor: në vitin 2021 dhe në vitin 2020 nuk rezultojnë kallëzime nga personeli mjekësor.

Kallëzime nga shtetasit: në vitin 2021 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2421 kallëzime, që përbën rritje prej 36,56 % krahasuar me vitin 2020.

Kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim: në vitin 2021 rezulton të kenë ardhur në prokurori 187 ankime nga viktimat, që përbën rritje prej 0,57 % krahasuar me vitin 2020.

Të dhëna në pesë vite për njoftimet për vepra penale paraqiten në grafikun më poshtë:



Në vitit 2021 rezulton të jetë marrë njoftim për 4461 ngjarje, që do të thotë ulje prej 8,9 % në krahasim me vitin 2020.


Referime nga Policia e Shtetit dhe polici të tjera me atributet e policisë gjyqësore, në vitit 2021 rezulton të kenë ardhur në prokurori 33662 referime, që përbën rritje prej 5,86 % në krahasim me vitin 2020.

2.7 TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2021 urdhrat për ekzekutim e vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë (në vijim: vendime) të dënimeve kryesore me burgim, gjobë dhe dënime plotësuese, zënë 32,63 % të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori, ndërsa urdhrat për ekzekutim të dënimeve alternative zënë 67,37% të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori. Krahasuar me vitin 2020, urdhrat e ekzekutimit për dënimet me burgim të përjetshëm, me burgim, me gjobë dhe dënime plotësuese kanë pësuar një rritje prej 61,68 %, ndërsa ato për dënimet alternative kanë pësuar një rritje prej 152 %.

Gjatë vitit 2021 janë ekzekutuar 5194 vendime, ndërsa kanë mbetur pa u ekzekutuar 5223 vendime. Numri i vendimeve sipas llojit të tyre të mbetura pa ekzekutuar është 11 për dënime me burgim të përjetshëm, 976 vendime me burgim, 736 vendime për dënime me gjobë, 91 dënime plotësuese dhe 3284 dënime alternative.


Grafikun në vijim paraqet raportin në përqindje të vendimeve të ekzekutuara dhe të vendimeve të pa ekzekutuara:



2.8 KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

Raporti krime dhe kundërvajtje

Më poshtë paraqitet analiza e strukturës së kriminalitetit për vitin 2021, sipas ndarjes në krime dhe kundërvajtje penale duke përfshirë të dhëna që lidhen me procedimet penale të regjistruara në prokurori sipas veprave penale:




Raporti i grupveprave me numrin e procedimeve të regjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal, rezulton si vijon:

- Raporti që zënë **krimet kundër njerëzimit**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 0 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera me dashje**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 1,62 %⁷⁸;
- Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera me pakujdesi** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 0,02 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër shëndetit të kryera me dashje** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 2,9 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër shëndetit të kryera me pakujdesi** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 0,04 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose mosdhënia e ndihmës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 1,23 %;
- Raporti që zënë **krimet seksuale** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 0,56 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së personit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 0,39 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 1,01 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 5,26 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së besimit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0 %;
- Raporti që zënë **vjedhja e pasurisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 27,86 %;
- Raporti që zënë **mashttrimet** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 2,65 %;
- Raporti që zënë **shkatërrimi i pronës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 4,08 %;
- Raporti që zënë **veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 0,19 %;
- Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me veprimtarinë bankare dhe financiare** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 0,07 %;
- Raporti që zënë **krimet në fushën e doganave** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 0,59 %;
- Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 1,11 %;

⁷⁸ Përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë.

- Raporti që zë **falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 0,23 %;
- Raporti që zë **falsifikimi i dokumenteve** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 2,99 %;
- Raporti që zënë **veprat penale në fushën e falimentimit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 0 %;
- Raporti që zë **zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 0,77 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që cënojnë regjimin juridik të tokës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 6,90 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër mjedisit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 1,11 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër pavarësisë dhe integritetit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 0,00 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër rendit kushtetues** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 0,01 %;
- Raporti që zënë **krimet që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 0 %;
- Raporti që zënë **veprat me qëllime terroriste** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 0,03 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 2,13 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 2,15 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 28,88 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 3,03 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër drejtësisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 1,96 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që prekin zgjedhjet e lira**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021, është 0,21 %.

Numri i procedimeve sipas grup veprave penale dhe raporti i tyre me numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara gjatë vitit 2021 dhe krahasuar me vitin 2020, paraqiten grafikisht si më poshtë:



Në vijim do të analizohet në mënyrë më të detajuar secili nga seksionet e Kodit Penal:

2.9 ANALIZA E VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

KRIME KUNDËR NJËRËZIMIT

Në vitin 2021 nuk rezultojnë procedime të regjistruara në lidhje me krimet e parashikuara në Kreun I të Kodit Penal, “Krime kundër njerëzimit”.

KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE


Pesha specifike⁷⁹ që zë ky grup veprash penale për vitin 2021 është 1,69 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2020 ky grup veprash përbënte 1,72 % të totalit të procedimeve. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2021 në krahasim me vitin 2020.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është, 16,96 ndërsa në vitin 2020 ka qenë 16,87.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 1), rezulton se në vitin 2021 ka një ulje prej 14,17 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër jetës të kryera me dashje” në krahasim me vitin 2020. Ndërkaq kemi një rritje prej 25,74 % të numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me një vit më parë. Në lidhje me të pandehurit regjistruar për këtë grup veprash penale, vihet re ulje prej 19,32 % përkundrejt këtij totali në vitin 2020, numri i të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë është rritur me 30,08 % dhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është rritur me 38,02 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e krimeve kundër jetës të kryera me dashje për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë e të pandehurve vihet re se 97,7 % e tyre janë meshkuj (nga të cilët 0,57 % janë të mitur) dhe 2,3 % janë femra (ndër të cilat nuk rezultojnë të mitura).

⁷⁹ “Pesha specifike” është llogaritur si raport i grupveprave të renditura në tabelë me numrin total të procedimeve të regjistruara. Për shkak të grupimit të veprave jo gjithmonë sipas strukturës së Kodit Penal, por edhe sipas fushës, mund të mos ketë përputhje midis këtij treguesi dhe raportit të grup veprave me numrin e procedimeve të regjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve, rezulton se për këto grup veprash penale 6,36 % e të pandehurve të regjistruar janë me arsim të lartë, 36,99 % e të pandehurve të regjistruar janë me arsim të mesëm dhe pjesa tjetër e të pandehurve, prej 56,65 % rezultojnë me arsim deri 9-vjeçar.


Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 72,9 % e të pandehurve janë të papunë, 26,17 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin privat dhe 0,9 % rezultojnë të punësuar në sektorin shtetëror.

Rezulton se, rreth 55,83 % e të pandehurve për këtë grup veprash janë banues në qytet dhe 44,17 % e tyre, në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vihet re se 13,25 % e tyre janë përsëritës për vepra të tjera dhe 86,75 % janë të padënuar më parë.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të krimeve kundër jetës të kryera me dashje në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për krime kundër jetës të kryera me dashje është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Tiranë regjistruar 19 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë grupvepra në shkallë vendi; Vlorë 12 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Shkodër 11 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, dhe në Fier, Elbasan Lezhë e Korçë regjistruar secila 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të

shkallës së parë, siç janë: Kavajë, Mat, Gjirokastrë, Dibër ku janë regjistruar 1 % e numrit total të procedimeve të regjistruar, si dhe në Përmet ku nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë grupvepra.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Vrasja me dashje

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” për vitin 2021 është 6,55 %, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 6,67 %.

Të dhënat statistikore tregojnë se në vitin 2021 janë regjistruar 27 procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me dashje”, që rezulton me një ulje prej 15,63 % në krahasim me vitin 2020.

Vrasja me paramendim

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” për vitin 2021 është, 10,2%, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 9,79 %.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2021, ka një ulje prej 10,64 % të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 78 “Vrasja me paramendim”, krahasuar me vitin 2020.

Vrasja në rrethana të tjera cilësuese

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” është 5,83 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 5,63 %.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2021, ka një ulje prej 11,1 % të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, krahasuar me vitin 2020.

Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” është 4,6 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 2,29 %.


Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2021 janë regjistruar 19 procedime penale për veprën penale të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare, që ndaj 11 procedimeve të regjistruara në vitin 2020, përbën rritje prej 72,73 %.

Kanosja

Në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” peshën specifike më të lartë e përbën vepra penale e parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja”, që në vitin 2021 është 69,66 % ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 70,42 %.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2021 janë regjistruar 287 procedime penale që përbëjnë një ulje prej 15,09 % krahasuar me vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 97,7 % janë meshkuj madhorë, 56,65 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 72,9 %, janë të papunë dhe 13,25 % janë të dënuar për vepra të tjera.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për krime kundër jetës me dashje, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 19 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqet Vlorë me 31 procedime, Lezhë me 29 procedime dhe në qarkun Kukës me 27 procedime.

Politika Penale: Për këtë grup veprash, 91,26 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërkohë që nga gjykata në 90,3 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat e prokurorit për llojin dhe masën e dënimit, rezulton se në 93,8 % të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 6,18 % dënim me gjobë (ku të gjitha rastet i përkasin kanosjes), ndërkohë që është kërkuar pushim çështjeje në 4 raste. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 16,48 % të të pandehurve (73,3 % e të cilëve të akuzuar për kanosje), 10,9 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum (të gjitha rastet janë të akuzuar për kanosje), 53,85 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, 15,38 % në maksimumin e dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 3,3 % e kërkesave rezultojnë për dënim të përjetshëm. Gjykata ka vendosur në 92,7 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 7,3 % dënim me gjobë, ndërkohë që kemi 7 pushim çështjeje dhe 1 vendim pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 21,35 % të të pandehurve (78,95 % e të cilëve për kanosje), 21,35 % e dënimeve rezultojnë për caktimin e dënimit në minimum (89,5 % e të cilëve për kanosje), 46,07 % në marzhin mesatar të

dënimit të parashikuar nga dispozita, 7,86 % në maksimumin e dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 3,37 % dënime të përjetshme.

Siguria publike: Për këtë grup veprash, në vitin 2021 janë pezulluar hetimet për 67 procedime që përbëjnë 16,26 % të procedimeve të regjistruara, ndërkohë që në vitin 2020 kjo peshë ishte 19,58 %.

Viktimat: Për këtë grup veprash në vitin 2021 nga numri total i viktimave rezultojnë 98,33 % viktima të rritur dhe 1,67 % (të mitur nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 86,4 % janë meshkuj dhe 13,56 % janë femra.

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI

Nga të dhënat statistikore (tabela 2) rezulton se në vitin 2021 ka ulje të lehtë të treguesve lidhur me “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi”. Konkretisht nga 8 procedime penale me 8 të pandehur të regjistruar në vitin 2020, në 7 procedime penale me 2 të pandehur të regjistruar në vitin 2021. Procedimet e dërguara në gjykatë rezultojnë me rritje nga 5 në vitin 2020, në 6 procedime me 9 të pandehur në vitin 2021, ndërkohë është dënuar 1 i pandehur për këtë vepër gjatë vitit 2021.

Për këtë grup veprash në vitin 2021, viktimat rezultojnë në shifra të ulta të cilat të përkthyer në përqindje janë: nga numri total i viktimave, 66,67 % janë viktima të rritur, (të gjithë meshkuj) dhe 33,33 % të mitur (nën 18 vjeç).

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE


Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2021 është 2,9 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2020 ky grup veprash përbënte 3,09 % të totalit të procedimeve. Pra, vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2021 në krahasim me vitin 2020.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 29,08, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 30,25.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 3), rezulton se, në vitin 2021 numri i procedimeve të regjistruara është ulur me 4,41 %, numri i procedimeve dërguar në gjykatë ka pësuar rritje prej 9,27 %, numri i të pandehurve të regjistruar rezulton me ulje 7,22 %, numri i të pandehurve të dërguar në gjykatë është rritur me 10,13 % dhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është rritur me 15,13 % krahasuar me vitin 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë e të pandehurve vihet re se 1,79 % e tyre janë femra dhe 98,21 % janë meshkuj, ndër të cilët 4,81 % janë të mitur (14-18 vjeç).

Ndër të pandehurit rezultojnë edhe 5 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se për këto grup veprash penale 6,84 % e tyre janë me arsim të lartë, 37,3 % e të pandehurve janë me arsim të mesëm dhe pjesa tjetër prej 55,86 % e të pandehurve, rezultojnë me arsim deri 9-vjeçar.


Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 78,31 % e të pandehurve janë të papunë, rreth 21,08 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin privat dhe 0,6 % të punësuar në sektorin shtetëror.

Rezulton se 59,62 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 40,38 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 7,46 % prej tyre janë të dënuar për vepra të tjera penale dhe 92,54 % janë të padënuar më parë.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprat penale të kryera me dashje kundër shëndetit është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Tiranë regjistruar 26 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto grupvepra në shkallë vendi, Elbasan 13 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Vlorë 10 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Fier 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë siç janë: Gjirokastrë, Kavajë e Lushnje përkatësisht secila regjistruar rreth 2 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, Përmet, Pukë, Mat, Tropojë, Kurbin regjistruar më pak se 1% e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, për për këtë grupvepra.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Plagosja e rëndë me dashje

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit” për vitin 2021 është 12,5 %, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 13,23 %.


Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2021, vihet re tendencë ulje prej 9,65 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal “Plagosja e rëndë me dashje”, në krahasim me vitin 2020.

Plagosja e lehtë me dashje

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit” për vitin 2021 është 82,99 %, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 83,18 %.

Në vitin 2021, të dhënat statistikore tregojnë tendencë në ulje prej 4,61 % të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal “Plagosja e lehtë me dashje”, krahasuar me vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 98,21 % janë meshkuj madhorë, 55,86 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 78,31 % janë të papunë, ku 7,46 % janë të dënuar për vepra të tjera.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për krime kundër shëndetit me dashje, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 26 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Vlorë me 57 procedime, qarku Elbasan me 39 procedime dhe qarku Lezhë me 35 procedime.

Politika Penale: për këtë grup veprash, 77,55 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërkohë që nga gjykata në 70,47 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 69,03 % e të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 30,97 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka patur 1 kërkesë për pushim akuze dhe 48 kërkesa për pushim çështjeje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 51,87 % të të pandehurve, 20,09 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 25,7 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 2,30 % në maksimumin e dënimit të parashikuar nga dispozita.

Gjykata ka vendosur në 69,7 % të dënimeve dënim me burg dhe në 30,3 % dënim me gjobë, ndërkohë që është vendosur 1 pushim akuze, 69 pushim çështje dhe 1 vendim pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 55,5 % të të pandehurve, në 15,18 % është vendosur caktimi i dënimit në minimum, 28,27 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.

Siguria publike: pezullimi i procedimit për këto grupvepra përbën 7,65 % të çështjeve të regjistruara në vitin 2021 dhe 7,66 % në vitin 2020, përkatësisht 63 procedime të pezulluara në vitin 2021 dhe 63 procedime të pezulluara në vitin 2020.

Viktimat: Për këtë grup veprash në vitin 2021 nga numri total i viktimave rezultojnë 98,22 % viktima të rritur dhe 1,78 % (të mitur-nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 89,55 % janë meshkuj dhe 10,45 % janë femra.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA

Të dhënat statistikore (tabela 4) tregojnë se numri i procedimeve penale për “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia” të regjistruara në vitin 2021 është ulur në 10 nga 17 procedime të regjistruara në vitin 2020. Për këtë periudhë nuk ka asnjë procedim i dërguar në gjykatë, janë 4 të pandehur të regjistruar dhe nuk rezultojnë të pandehur të dënuar.

VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZËNËSISË OSE MOSDHËNIA E NDIHMËS


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,23%. Ky tregues për vitin 2020 ka qenë 1,53 %, pra vihet re ulje e tij për vitin 2021 në krahasim me vitin 2020.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 12,37, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 14,97.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 5) rezulton se në vitin 2021 ka një ulje prej 17,84 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënësisë ose nga mosdhënia e ndihmës”, në krahasim me vitin 2020. Numri i procedimeve dërguar në gjykatë është rritur nga 13 në 14, numri i të pandehurve të regjistruar është ulur me 77,78 % dhe numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është rritur nga 14 në 17. Po kështu vërehet ulje edhe në lidhje me numrin e të pandehurve të dënuar nga gjykata nga 5 të pandehur në vitin 2020 në 1 të pandehur të dënuar në vitin 2021.

Grafikisht tendenca e veprave penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënësisë ose mosdhënia e ndihmës për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të gjithë të pandehurit rezultojnë të moshës madhore, ku 83,3 % e përbëjnë meshkujt dhe 16,7 % femrat.


Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 66,67 % e të pandehurve janë me arsim të lartë, me arsim të mesëm janë 22,2% e të pandehurve dhe me arsim deri në 9 vjeçar, 11,1 % e të pandehurve.

Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 50 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin shtetëror.

Rezulton se 72,2 % e të pandehurve e kanë vendbanimin në qytet ndërsa pjesa tjetër në fshat, ndërsa në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, të gjithë të pandehurit janë të padënuar më parë.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatëzënisë ose mosdhënia e ndihmës është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, siç janë: Tiranë regjistruar 21 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Fier regjistruar 15 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Elbasan regjistruar 12 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Korçë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Vlorë dhe Durrës regjistruar secila 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Berat, Krujë, Tropojë, Mat, Sarandë, Kurbin regjistruar secila rreth 1 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, për vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatëzënisë ose mosdhënia e ndihmës.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Neglizhenca në trajtimin mjekësor

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatëzënisë ose nga mosdhënia e ndihmës” është 14,86 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 11,5 %.


Të dhënat statistikore tregojnë se numri i procedimeve penale të regjistruara në vitin 2021 për këtë vepër penale është rritur me 6,2 % krahasuar me vitin 2020.

Shkaktimi i vetëvrasjes

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia” është 84,86 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 88,5 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje prej 21,2 % e procedimeve të regjistruara në vitin 2020, për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes”, në krahasim me vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Për këtë grup veprash në vitin 2021 nga numri total i viktimave rezultojnë 96,77 % viktima të rritur dhe 3,23 % (të mitur-nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 75,56 % janë meshkuj dhe 24,44 % janë femra.

KRIME SEKSUALE


Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,56 % ndërkohë që për vitin 2020 ka qenë 0,49 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 5,58 ndërsa në vitin 2020 ka qenë 4,78.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 6) rezulton se në vitin 2021 ka rritje prej 16,18 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime seksuale në krahasim me vitin 2020 dhe një rritje prej 48,2 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2020. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2020 prej 2,89 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë me 52,46 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 3,3 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e krimeve seksuale për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, moshja, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë dhe moshën për të pandehurit, nga të dhënat statistikore rezulton se 96,7 % e të pandehurve (mbi 18 vjeç) janë meshkuj dhe 3,3 % janë femra. Ndërkohë nga numri i përgjithshëm i të pandehurve meshkuj, 5,65 % janë të mitur (14-18 vjeç).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 64,8 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 30,5 % me arsim të mesëm dhe 4,7 % me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se 92,65 % e të pandehurve janë të papunë, 7,35 % e të pandehurve janë nga sektori privat ndërkohë asnjë i pandehur nuk është i punësuar në sektorin shtetëror.

Rezulton se 65,85 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 34,15 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 87,9 % e të pandehurve janë të padënuar më parë dhe 12,1 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme nga ajo që procedohen.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për krime seksuale është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, siç janë: Tiranë regjistruar 30 %, e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Elbasan dhe Berat regjistruar 9 %, Durrës regjistruar 8 %, Fier regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Pukë, Dibër, Mat, Kurbin, Krujë, Kukës regjistruar secila rreth 1 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, dhe në prokuroritë e shkallës së parë Përmet e Tropojë nuk janë regjistruar asnjë procedim penal për këtë grup veprash.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime seksuale” në vitin 2021 është 15,8 %, ndërsa për vitin 2020 ka qenë 16,18 %.


Në vitin 2021 vihet re rritje e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, prej 16,64 % në krahasim me vitin 2020.

Ngacmimi seksual

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime seksuale” është 43,04 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 42,65 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi krahasuar me vitin 2020.

Në vitin 2021, në grupin e krimeve seksuale vihet re një rritje prej 17,24 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 108/a i Kodit Penal “Ngacmimi seksual”, në krahasim me vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIMET

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 96,7 % janë meshkuj madhorë, 5,65 % janë të mitur, 64,8 % janë me arsim deri 9 – vjeçar, 92,65 % janë të papunë dhe 12,1 % janë të dënuar për vepra të tjera.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për krime seksuale, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 30 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqet Gjirokastrë me 14 procedime dhe qarku Berat me 12 procedime.

Politika Penale: për këtë grup veprash, 89,87 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 88,3 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në të gjitha rastet është kërkuar dënim me burg. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 18,03 % të të pandehurve, 11,48 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 60,66 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 9,84 % rezulton caktim dënimi në maksimum. Gjykata ka vendosur në të gjithë dënimet, dënim me burg. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 24,2 % të të pandehurve, 12,9 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 56,45 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 6,45 % në maksimum të dënimit që parashikon dispozita.

Siguria publike: pezullimi i procedimit për këto grupvepra përbën 10,13 % të çështjeve të regjistruara në vitin 2021 dhe 11 % në vitin 2020, përkatësisht 16 të pezulluara në vitin 2021 dhe 15 procedime të pezulluara në vitin 2020.

Viktimat: Për këtë grup veprash në vitin 2021 nga numri total i viktimave rezultojnë 77,27 % viktima të mitur-nën 18 vjeç) dhe 1,78 % të rritur. Nga viktimat e mitura, 5,88 % janë meshkuj dhe 94,12 % janë femra.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT


Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,36 % dhe për vitin 2020 ka qenë 0,42 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2021 në krahasim me vitin 2020.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 3,64, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 4,08.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 7) rezulton se në vitin 2021 ka një ulje prej 11,2 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër lirisë së personit” në krahasim me vitin 2020. Kemi ulje prej 12,5 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2020. Në lidhje me të pandehurit e regjistruar për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje përkundrejt këtij totali në vitin 2021 prej 33,34 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 24,6 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 134,78 %, përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e krimeve kundër lirisë së personit për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë, 95,65 % e të pandehurve janë meshkuj (mbi 18 vjeç) dhe 4,35 % janë femra (mbi 18 vjeç).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 50 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 40,79 % me arsim të mesëm dhe 9,21 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin privat janë regjistruar 21,87 % e të pandehurve, të punësuar në sektorin shtetëror nuk rezultojnë dhe të papunë janë 78,25 %.

Rezulton se 72,98 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 27,03 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 95,95 % e tyre janë të padënuar më parë dhe 4,05 % janë përsëritës për vepra të tjera.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër lirisë së personit është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, siç janë: Tiranë regjistruar 26 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Vlorë regjistruar 13 %, Shkodër regjistruar 10 %, Elbasan regjistruar 7 %, Fier dhe Durrës regjistruar 6 %, e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Sarandë, Diber, Pogradec, Krujë, Lezhë, Berat regjistruar rreth 2 % dhe Tropojë, Kurbin, Kavajë, Mat regjistruar rreth 1 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për grupvepra kundër lirisë së personit, ndërkohë prokuroria e shkallës së parë Pukë nuk ka regjistruar asnjë procedim penal për këtë grup veprash.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër lirisë së personit” është 12,62 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 12,07 %.

Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale për vitin 2021, në grupin “Vepra penale kundër lirisë së personit” është 45,63 % ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 48,28 %.


Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” prej 16,07 %, në krahasim me vitin 2020.

Heqja e paligjshme e lirisë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër lirisë së personit” është 26,2 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 23,28 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet se kemi te njëjtin numër procedimesh penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal “Heqja e paligjshme e lirisë me vitin 2020 (27 procedime).

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 95,65 % janë meshkuj madhorë, 50 % janë me arsim deri 9 vjeçar, 78,25 % janë të papunë, dhe 4,05 % rezultojnë të dënuar për vepra të tjera.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër lirisë së personit është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 26 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Gjirokastrë me 12 procedime dhe Vlorë me 8 Procedime.

Politika Penale: për këtë grup veprash 82,93 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërkohë që nga gjykata në 60,98 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 98,18 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 1 rast dënim me gjobë. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 35,19 % të të pandehurve, 35,19 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 27,78 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 1 rast në maksimum të dënimit të parashikuar. Gjykata ka vendosur në 98,15 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 1,85 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 1 vendim pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 33,96 % të të pandehurve, 49,06 %

rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 16,98 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.

Siguria publike: për këtë grup veprash, në vitin 2021 janë pezulluar 23 procedime që përbëjnë 22,33 % të procedimeve të regjistruara, ndërkohë që në vitin 2020 pesha që zinin procedimet e pezulluara ishte 15,52 %.

Viktimat: Për këtë grup veprash në vitin 2021 nga numri total i viktimave rezultojnë, 87,5 % viktima të rritur dhe 1,78 % (të mitur nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 71,43 % janë meshkuj dhe 28,57 % janë femra.

VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1% ndërkohë që në vitin 2020 ky tregues ka qenë 0,81 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 10,03 ndërsa në vitin 2020 ka qenë 7,91.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 8) rezulton se në vitin 2021 ka një rritje prej 26,2 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” në krahasim me vitin 2020. Ndërkaq kemi ulje prej 16,16 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2020, rritje në lidhje me numrin e të pandehurve regjistruar për këtë grup veprash penale prej 16,13 % përkundrejt këtij totali në vitin 2020, rritje me 4,4 % të numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë dhe rritje me 37,84 % të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata, krahasuar me vitin 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë dhe moshën për të pandehurit, nga të dhënat statistikore rezulton se 77,27 % e të pandehurve (mbi 18 vjeç) janë meshkuj dhe 22,73 % janë femra. Ndërkohë nga numri i përgjithshëm i të pandehurve meshkuj, 1,65 % janë të mitur (14-18 vjeç).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 43,95 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 42,68 % me arsim të mesëm dhe 13,38 % të pandehur me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore, rezulton se nga sektori privat janë regjistruar 47,69 % e të pandehurve dhe 50,77 % rezultojnë të papunë.

Rezulton se 68,59 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 31,4 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 85,9 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 10,9 % e tyre janë përsëritës në vepra penale të ndryshme dhe 3,2 % janë përsëritës për të njëjtën vepër penale.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike eidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, siç janë: Tiranë

regjistruar 37 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Elbasan regjistruar 11 %, Shkodër regjistruar 8 %, Berat regjistruar 7 %, e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Kukës, Tropojë, Mat, Gjirokastrë regjistruar rreth 1 % dhe Kurbin, Sarandë, Përmet, Lezhë regjistruar më pak se 1 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, si dhe Pukë nuk ka regjistruar ndonjë procedim penal për këtë grup veprash.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shfrytëzimi i prostitucionit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” është 8,09 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 14,22%.


Nga të dhënat statistikore vihet re në vitin 2021 tendenca në ulje 28,13 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit”, në krahasim me vitin 2020.

Përndjekja

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” është 51,06% për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 57,78 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2021 janë regjistruar 11,54 % më pak procedime penale sesa në vitin 2020 për veprën penale të parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal “Përndjekja”.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: meshkuj madhorë janë 77,2 % dhe femra janë 22,73 %, si dhe 43,95 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 50,77 % janë të papunë, 10,9 % e tyre janë përsëritës në vepra penale të ndryshme dhe 3,2 % janë përsëritës për të njëjtën vepër penale.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 37 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Berat me 16 procedime dhe qarqet Elbasan, Shkodër dhe Tiranë me 8 procedime.

Politika Penale: për këtë grup veprash, 85,53 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërkohë që nga gjykata në 78,95 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 96,08 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 3,92 % dënim me gjobë, ndërkohë që është kërkuar në 2 çështje pushimi i tyre. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 40,82 % të të pandehurve, 24,5 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 33,67 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 98,04 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 1,36 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur në 2 raste pushim çështje. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 44 % të të pandehurve, 36 % e dënimeve rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 20 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.

Siguria publike: pezullimi i procedimit për këto grupvepra përbën 16,55 % të çështjeve të regjistruara në vitin 2021 dhe 19,56 % në vitin 2020, përkatësisht 47 të pezulluara në vitin 2021 dhe 44 procedime të pezulluara në vitin 2020.

Viktimat: Për këtë grup veprash në vitin 2021 nga numri total i viktimave rezultojnë, 85,19 % viktima të rritur dhe 14,81 % (të mitur-nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 4,35 % janë meshkuj dhe 95,65 % janë femra.

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 5,25 % ndërsa për vitin 2020 ka qenë 4,85 %.


Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 52,6 ndërsa në vitin 2020 ka qenë 47,51.

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore në vitin 2021 për “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”, rezulton rritje prej 10,13 % e numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2020 e ndërkohë kemi rritje prej 13,12 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2020. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2020

prej 8,44 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë me 14,05 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 24,8 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

93 % e të pandehurve janë meshkuj ku 1,43 % e përbëjnë të miturit dhe 7 % janë të pandehura femra mbi 18 vjeç.

Për këto vepra, rezultojnë edhe 4 të pandehur me shtetësi të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 53,58 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 40,37 % me arsim të mesëm dhe 6,05 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 0,6 % e të pandehurve, në sektorin privat 30,6 % e të pandehurve dhe të papunë 68,8 %.

Rezulton se 54,96 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 45,04 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 86,56 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 2,4 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 11,03 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, është regjistruar në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, siç janë: Tiranë regjistruar 29 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Durrës regjistruar 10 %, Elbasan dhe Vlorë regjistruar 7 %, Fier dhe Berat regjistruar 6 %, e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Dibër, Pogradec e Mat regjistruar rreth 1 % dhe Pukë, Përmet e Tropojë regjistruar më pak se 1 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruar për këtë grup veprash.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Braktisja e fëmijëve të mitur

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” për vitin 2021 është 1,75 % ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 1,78 %.


Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje për veprën penale të parashikuar nga neni 124 i Kodit Penal “Braktisja e fëmijëve të mitur”, në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020, nga 24 në 26 procedime të regjistruara ose 8,3 %.

Keqtrajtimi i të miturit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” për vitin 2021 është 2,15 %, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 3,55 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje për veprën penale të parashikuar nga neni 124/b i Kodit Penal “Keqtrajtimi i të miturit”, në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020, nga 48 në 26 procedime të regjistruara, ose 45,83 %.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Dhuna në familje

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” për vitin 2021 është 94,43 %, ndërsa në vitin 2020 pesha e kësaj vepre rezultoi në masën 92,53 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vihet re tendenca në rritje prej 12,4 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a të Kodit Penal “Dhuna në familje”, në krahasim me vitin 2020.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, tregon se në vitin 2021 është arritur rritja në masën 7,33 % i numrit të procedimeve të regjistruara krahasuar me vitin 2017.



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezultoi se:

Profili i të pandehurve: 93 % janë meshkuj madhorë, 53,58 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 68,8 %, janë të papunë, 2,4 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën veprë penale, ndërsa 11,03 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 29 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqet Lezhë me 88 procedime dhe qarku Vlorë me 80 procedime.

Politika Penale: për këtë grup veprash, 87,69 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 84,3 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest, ndërkohë që janë vendosur edhe 7 masa ndaluese.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 99,9 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 0,1 % dënim me gjobë, ndërkohë që është kërkuar pushimi në 6 çështje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 44,18 % të të pandehurve, për 0,1 % është kërkuar ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, 18,39 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 36,9 % në marzhin mesatar dhe 0,33 % në marzhin maksimal të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 99,9 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 0,1 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 7 pushim çështje dhe 2 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 45,02 % të të pandehurve, për 0,1 % është kërkuar ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, 30,05 % e dënimeve rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 24,5 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 0,1 %, me marzhin maksimal të dënimit.

Viktimat: Për këtë grup veprash në vitin 2021, nga numri total i viktimave rezultojnë, 91,52 % viktima të rritur dhe 8,48 % (të mitur-nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 75,48 % janë femra dhe 24,52 % janë meshkuj.

VEPRAT PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT

Në lidhje me veprat penale kundër lirisë së besimit, gjatë vitit 2021 është regjistruar 1 procedim penale për veprën penale “Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit”.

VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE VJEDHJA E PASURISË


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 27,26 %, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 30,70 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 273,13, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 300,46.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 11) rezulton se në vitin 2021 ka një ulje prej 12,67 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vjedhjen e pasurisë dhe një ulje prej 5,36 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2020. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2020 prej 17,59 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 3,67 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 11,43 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale të vjedhjes së pasurisë për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

94,09 % e të pandehurve janë meshkuj, ku 12,84 % e përbëjnë të miturit, dhe 5,91 % janë të pandehura femra ndër të cilat rezultojnë të jenë 6,45 % të mitura.

Në këtë grup veprash janë marrë të pandehur 36 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 69,4 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 25,3 % me arsim të mesëm dhe 5,3 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 0,69 % e të pandehurve, në sektorin privat 17,4 % e të pandehurve dhe të papunë 81,78 %.

Rezulton se 62,15 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 37,85 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 80,9 % e të pandehurve janë padënuar më parë, 6,3 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 12,8 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike eidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për grupveprat e vjedhjes së pasurisë është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, siç janë” Tiranë regjistruar 43 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Durrës regjistruar 12 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Vlorë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Elbasan 5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Dibër, Tropojë, Kukës, Krujë regjistruar përkatësisht rreth 1 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe Mat, Pukë, Përmet, Pogradec regjistruar më pak se 1 % e totalit e numrit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2021, për veprat penale të vjedhjes së pasurisë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Vjedhja

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” është 90,69 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 91,36 %.

Nga të dhënat vihet re se procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal “Vjedhja”, në vitin 2021 janë ulur me 10,27 % në krahasim me vitin 2020.

Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale kundër vjedhjes së pasurisë në vitin 2021 është 1 %, ndërsa për vitin 2020 ky tregues ka qenë 0,80 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca në rritje prej 14,7 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”, në krahasim me vitin 2020.

Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale kundër vjedhjes së pasurisë në vitin 2021 është 0,05 %, ndërsa për vitin 2020 ky tregues ka qenë 0,07 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet trendi në ulje i lehtë, i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit”, në krahasim me vitin 2020, nga 6 procedime në 4 procedime të regjistruara.

Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” për vitin 2021 është 6,48 %, ndërkohë që për vitin 2020 ka qenë 6,12 %.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2021 numri i procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 137 “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” i Kodit Penal, ka një ulje prej 4,2 % në krahasim me vitin 2020.

Vjedhja me dhunë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” për vitin 2021 është 1,45 % ndërkohë që për vitin 2020 ka qenë 1,43 %.


Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2021 ka ulje prej 8,94 % të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal “Vjedhja me dhunë”, në krahasim me vitin 2020.

Vjedhja me armë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” për vitin 2021 është 0,14 % ndërkohë që për vitin 2020 ka qenë 0,18 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet një ulje e se numri i procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal “Vjedhja me armë” prej 26,7 %.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 94,04 % janë meshkuj nga të cilët të mitur 12,84 %, 69,4 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 81,78 % janë të papunë, 6,3 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 12,8 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme. **Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për vjedhjen e pasurisë, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 43 % e tyre, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Tiranë me 386 procedime, qarkun Vlorë me 385 procedime dhe qarkun Durrës me 344 procedime.

Politika Penale: për këtë grup veprash, 80,4 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 76,8 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest, ndërkohë që janë vendosur edhe 3 masa ndaluese.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 97,55 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 2,45 % dënim me gjobë, ndërkohë që është kërkuar pushimi i 2 çështjeve. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 46,13 % të të pandehurve, për 0,09 % është kërkuar ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, 16,83 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 35,78 % në marzhin mesatar, 1,16 % në marzhin maksimal të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 97,53 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 2,5 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur kthim aktesh në 2 çështje, 4 pushim çështje dhe 15 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 46,84 % të të pandehurve, për 26,87 % e dënimeve rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 23,66 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, 2,53 % në marzhin maksimal të dënimit.

Siguria publike: për këtë grup veprash, në vitin 2021 janë pezulluar 6622 procedime që përbëjnë **85,68 %** të procedimeve të regjistruara. Ky tregues është me rritje krahasur me 6497 procedime të pezulluara në vitin 2020, gjatë të cilit procedimet e pezulluara përbënin një peshë prej 77,44 % të procedimeve të regjistruara.

Viktimat: Për këtë grup veprash në vitin 2021 nga numri total i viktimave rezultojnë, 96,73 % viktimat të rritur dhe 3,67 % (të mitur-nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 81,08 % janë meshkuj dhe 18,91 % janë femra.

MASHTRIMET


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 2,4 %, ndërsa në vitin 2020 është 2,02 %. Pra, vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2021 në krahasim me vitin 2020.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 24,07, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 19,82.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 12) rezulton se në vitin 2021 ka një rritje prej 20,74 % e numrit të procedimeve regjistruar krahasuar me vitin 2020 dhe ulje prej 4,9 % e procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2020. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2020 prej 7,69 %, një ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 9,89 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 10,11 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale të mashtrimeve për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Rezulton se 86,08 % e të pandehurve janë meshkuj dhe 13,92 % e të pandehurve janë femra.

Në këtë grup veprash rezultojnë të pandehur edhe 16 shtetas të huaj.

Për sa i përket arsimit të të pandehurve rezulton se 24,1 % e të pandehurve janë me arsim deri 9 vjeçar, 51,77 % me arsim të mesëm dhe 24,11 % me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se në sektorin privat rezultojnë 50,96 % e të pandehurve dhe 49,04 % janë të papunë.

Rezulton se 77,78 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 22,22 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 0,66 % e tyre rezultojnë përsëritës për të njëjtën vepër, 8,19 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme, ndërsa 91,15 % janë të padënuar më parë.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për grupveprat e mashtrimit është në prokuroritë pranë gjykatave së shkallës së parë, siç janë: Tiranë, 48 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Durrës 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Vlorë 7 % dhe Shkodër 4 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike,

ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Tropojë, Kurbin, Mat ku janë regjistruar rreth 1 % ose më pak se 1% e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi dhe Pukë ku nuk ka asnjë procedim të regjistruar për këtë grupvepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Mashtrimi

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Mashtrimet” është 85,02 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 80,50 %.

Në këtë grup veprash penale në vitin 2021 vihet re një tendencë në rritje prej 27,53 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi”, në krahasim me vitin 2020.

Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Mashtrimet” është 0,59 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 2,66 %.

Për këtë vepër vërehet ulje prej 73,3% e numrit të procedimeve regjistruar gjatë vitit 2021, ku ky tregues është 4 procedime, ndërkohë që në vitin 2020 janë regjistruar 15 procedime penale për krijimin e skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar.

Mashtrimi në sigurime

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Mashtrimet” është 2,35 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 5,50 %.


Nga të dhënat statistikore vihet re rritje me 48,39 % e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”, krahasuar me vitin 2020.

Mashtrimi në kredi

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale kundër mashtrimit për vitin 2021 është 9,4 %, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 6,56 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca në rritje prej 72,98 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 146 i Kodit Penal “Mashtrimi në kredi”, krahasuar me vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 86,08 % janë meshkuj madhorë, 51,77 % janë me arsim të mesëm, 49,04 % janë të papunë, 0,66 % e tyre rezultojnë përsëritës për të njëjtën vepër, 8,19 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për vjedhjen e pasurisë, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 48 % e tyre, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Tiranë me 37 procedime, Vlorë me 35 procedime dhe Durrës 23 procedime.

Politika Penale: për këtë grup veprash, 70,27 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 62,2 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 96,7 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 3,26 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë kërkuar 5 pushim çështjeje dhe 1 pafajësi. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 32,69 % të të pandehurve, për 31,73 % të kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 44,13 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 1,44 % në marzhin maksimal. Gjykata ka vendosur në 95,4 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 4,59 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 4 pushim çështje, 1 kthim aktesh dhe 13 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 40,1 % të të pandehurve, 33,15 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 25,13 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 1,6 % në marzhin maksimal.

Siguria publike: për këtë grup veprash, në vitin 2021 janë pezulluar 153 procedime që përbëjnë 22,47 % të procedimeve të regjistruara. Ky tregues është me rritje prej 2,3 herësh krahasuar me 64

procedime të pezulluara në vitin 2020, gjatë të cilit procedimet e pezulluara përbënin një peshë prej 11,35 % të procedimeve të regjistruara.

Viktimat: Për këtë grup veprash në vitin 2021 nga numri total i viktimave rezultojnë, 96,67 % viktima të rritur dhe 3,33 % (të mitur-nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 72,41 % janë meshkuj dhe 27,59 % janë femra.


SHKATËRRIMI I PRONËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 4,08 %, tregues i përafërt me vitin 2020. Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 40,92, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 40,13.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 13) rezulton se në vitin 2021 ka trend në rritje të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të shkatërrimit të pronës në krahasim me vitin 2020, e konkretisht 1,4 %. Ndërkohë vërehet rritje prej 4,04 % e numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2020, rritje 20,47 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2020, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 19,15 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 9,26 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale të shkatërrimit të pronës për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit 4,7 % janë femra dhe 95,3 % meshkuj të rritur.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 53,38 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 39,86 % me arsim të mesëm dhe 6,76 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Rezulton 1 shtetas i huaj ndër të pandehurit për këto grup vepra.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektor shtetëror janë regjistruar 1,35 % e të pandehurve, në sektorin privat rezultojnë 40.54 % e të pandehurve dhe 58,1 % janë të papunë.

Rezulton se 61,8 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 38,19 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre janë të padënuar më parë, 90,71 % e të pandehurve, ndërsa 9,29 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike eidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për grupveprat e shkatërrimit të pronës është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Tiranë 19 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Vlorë 12 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Elbasan 9 % dhe Fier 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Mat, Kurbin, Pukë, Tropojë, Përmet ku janë regjistruar rreth 1 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shkatërrimi i pronës

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” është 42,66 % për vitin 2021, ndërkohë që për vitin 2020 ka qenë 44,31 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vihet re se numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës” është në ulje me 2,37 % në krahasim me vitin 2020.

Shkatërrimi i pronës me zjarr

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” është 43 % për vitin 2021, ndërkohë që për vitin 2019 ka qenë 41,24 %.


Nga të dhënat statistikore në vitin 2021, vihet re tendenca në rritje me 5,73 % e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, në krahasim me vitin 2020.

Shkatërrimi i pronës me eksploziv

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” për vitin 2021 është 2,76 %, ndërsa në vitin 2020 ky tregues ka qenë 2,89 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re një ulje e lehtë e procedimeve të regjistruara në vitin 2021, për veprën penale të parashikuar nga neni 152 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”, në 32 procedimeve penale të regjistruara ndaj 33 procedimeve në vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 95,3 % janë meshkuj madhorë, 53,38 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 58,1 %, janë të papunë dhe 9,29 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për shkatërimin e pronës, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 19 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqet Gjirokastrë me 105 procedime dhe qarku Vlorë me 93 procedime.

Politika Penale: për këtë grup veprash, 66,67 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 59,09 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 73,02 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 26,98 % dënim me gjobë, ndërkohë që është kërkuar në 2 raste pushim çështjeje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 58,69 % të të pandehurve, për 17,39 % të kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 21,74 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 2,18 në maksimumin e parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 76,27 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 23,73 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 2 pushim çështjeje, 1 kthim aktesh dhe 3 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 60 % të të pandehurve, 15,56 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 22,22 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 2,2% në marzhin maksimal të parashikuar.

Siguria publike: Për këtë grup veprash, në vitin 2021 janë pezulluar 604 procedime që përbëjnë 52,16 % të procedimeve të regjistruara, një rritje krahasuar me vitin 2020 ku procedimet e pezulluara përbënin 51,23 % të numrit të procedimeve të regjistruara.

Viktimat: Për këtë grup veprash në vitin 2021 nga numri total i viktimave rezultojnë, 97,22 % viktima të rritur dhe 2,78 % (të mitur-nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 85,7 % janë meshkuj dhe 14,3 % janë femra.

VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,18 %, ndërkohë që për vitin 2020 ka qenë 0,15 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 1,84, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 1,51.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 14) rezulton se në vitin 2021 numri i procedimeve penale të regjistruara është rritur me 20,93 %, numri i procedimeve të dërguar në gjykatë është ulur me 76 % në krahasim me vitin 2020, numri i të pandehurve të regjistruar është ulur me 69,57 %, numri i të pandehurve të dërguar gjykatë është ulur me 70 %, krahasuar me vitin 2020, numri i të pandehurve të dënuar është ulur me 12,5 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale të kryera në shoqëritë tregtare për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, tregojnë se, të gjithë të pandehurit janë meshkuj të moshës madhore.


Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 11,1 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 88,89 % me arsim të mesëm.

Lidhur me vendbanimin rezulton se 73,33 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 26,67 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 93,33 % janë të padënuar më parë dhe 6,67 % janë përsëritës për vepra penale të ndryshme nga ajo që procedohet.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive, ku vërehet se prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat e Tiranë, kanë regjistruar numrin më të lartë të procedimeve penale për këtë grupveprash përkatësisht me 44 % dhe 12 %, ndërkohë që prokuroritë e shkallës së parë Pukë, Krujë, Lushnjë, Përmet, Korçë, Mat, Kurbin, Gjirokastrë e Sarandë, nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal për vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare.




VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Punësimi i paligjshëm

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare” në vitin 2021 është 75 %, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 72,09 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 170/a i Kodit Penal “Punësimi i paligjshëm”. Kështu në vitin 2021 janë regjistruar 39 procedime penale, kundrejt 31 procedimeve penale të regjistruara në vitin 2020 ose 25,8 % më shumë.

Grafikisht, ecuria 5-vjeçare e kësaj vepre paraqitet si vijon:



VEPRA PENALE NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është aq sa në vitin 2020, 0,067 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 0,67, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 0,56.

TENDENCA

Në vitin 2021 (tabela 15) numri i procedimeve të regjistruara për vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare në krahasim me vitin 2020 ka pësuar rritje nga 16 në 19 procedime, ndërkohë që numri i të pandehurve të regjistruar është ulur nga 22 në 12. Numri i procedimeve të dërguara gjyqit dhe numri i të pandehurve dërguar gjyqit është rritur nga 7 procedime me 12 të pandehur në 12 procedime me 25 të pandehur, ndërkohë që të pandehurit e dënuar nga gjykata rezultojnë me ulje nga 19 në 6 të pandehur.

Grafikisht tendenca e veprave penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare, për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,59 %, pothuajse e njëjtë me vitin 2020.


Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 5,94, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 5,76.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 16) rezulton se në vitin 2021 ka një rritje prej 2,44 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime në fushën e doganave në krahasim me vitin 2020. Ndërkaq kemi rritje prej 4,12 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2020. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2020 prej 2,21 %, numri i të pandehurve të dërguar në

gjykatë është ulur me 10,87 %, ndërsa numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është rritur me 24,05 % krahasuar me vitin 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale në fushën e doganave për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Rezulton se 90,86 % e të pandehurve të rritur janë meshkuj dhe 9,14 % janë femra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 20,92 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 68,37 % me arsim të mesëm dhe 10,71 % të pandehurve janë me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2021 gjithsej të punësuar në sektorin privat zënë 59,43 % të numrit të të pandehurve dhe 40,57 % rezultojnë të papunë.


Rezultojnë edhe 9 shtetas të huaj të pandehur për këtë grup veprash penale në vitin 2021.

Sa i përket vendbanimit, 79,46 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 20,54 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 97,38 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 0,54 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale dhe 1,08 % përsëritës për vepra të tjera të ndryshme.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për krime në fushën e doganave është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë siç janë: Tiranë, 35 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Shkodër 14 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Durrës dhe Gjirokastrë nga 13 % dhe Fier 11% e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Kurbin, Sarandë, Përmet, Vlorë, Lezhë, Berat ku janë regjistruar rreth 1 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi dhe Mat, Pukë, Tropojë, Krujë ku nuk ka asnjë procedim të regjistruar për këtë grupvepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2021 në grupin e krimeve në fushën e doganave është 13,1 %, ndërsa për vitin 2020 ky tregues ka qenë 17,68 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”, në shifra nga 29 në 22 procedime ose 24,14 % në krahasim me vitin 2020.

Kontrabanda me mallra të tjera

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime në fushën e doganave” është 18,45 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 21,34 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re se procedimet penale të regjistruara për këtë vepër janë ulur me 11,43 %, konkretisht në vitin 2021 janë regjistruar 31 procedime penale kundrejt 35 procedimeve të regjistruara në vitin 2020 për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera”.

Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë


Në grupin e krimeve në fushën e doganave në vitin 2021 vihet re tendenca në rritje me 34,29 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”, ku kjo vepër ka një peshë prej 27,98 % të procedimeve të regjistruara.

Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë

Në grupin e krimeve në fushën e doganave në vitin 2021 vihet re tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal “Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë”, ku kjo vepër ka një peshë prej 21,43 % të procedimeve të regjistruara.

Nga të dhënat statistikore vërehet se për vitin 2021 janë regjistruar 36 procedime penale ndaj 40 procedimeve të regjistruara në vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 90,86 % janë meshkuj madhorë, 20,92 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 59,43 %, janë të punësuar në sektorin privat, 0,54 % janë përsëritës për të njëjtën vepër dhe 1,08 % janë të dënuar për vepra të tjera.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për krime në fushën e doganave, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 35 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqet Gjirokastrë me 38 procedime dhe qarku Shkodër me 12 procedime.

Politika Penale: Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 78,79 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 21,21 % dënim me gjobë. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 78,2 % të të pandehurve. Gjykata ka vendosur në 74,5 % të dënimeve, dënim

me burg dhe në 25,5 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 1 pushim akuze dhe 1 pafajësi. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 78,08 % të të pandehurve.

Siguria publike: Për këtë grup veprash, në vitin 2021 janë pezulluar 15 procedime që përbëjnë 8,93 % të procedimeve të regjistruara, tregues në ulje krahasuar me vitin 2020 ku procedimet e pezulluara përbënin 15,85 % të numrit të procedimeve të regjistruara.

VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,11 %, ndërsa për vitin 2020 është 1,08 %. Pra vihet re një rritje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2021 në krahasim me vitin 2020.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është, 11,17 ndërsa në vitin 2020 ka qenë 10,54.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 17) rezulton se në vitin 2021 ka një rritje prej 5,33 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” në krahasim me vitin 2020. Ndërkaq rezulton ulje prej 12,15 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2020. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2020 prej 26,42 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 5,15 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 20,99 %.

Grafikisht tendenca e veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të pandehurit janë të gjithë të rritur ku 8,33 % femra dhe 91,67 % meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 23,94 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 45,59 % me arsim të mesëm dhe 27,47 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për këto vepra rezultojnë të marrë si të pandehur edhe 11 shtetas të huaj.


Sa i përket gjendjes shoqërore, 78 % e të pandehurve rezultojnë të punësuar në sektorin privat, 22 % janë të papunë.

Lidhur me vendbanimin, rezulton se 78,41 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 21,59 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 93,52 % janë të padënuar më parë, 5,04 % e tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 1,44 % përsëritës për të njëjtën vepër.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë siç janë: Tiranë 19 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Berat 13 %, Elbasan 9 % dhe Durrës me 8% e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Kurbin, Sarandë, Kavajë, Diber, Tropojë, Përmet, Lushnjë, Krujë, ku janë regjistruar rreth 1 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi dhe prokuroritë Mat e Pukë nuk kanë asnjë procedim të regjistruar për këtë grupvepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Fshehja e të ardhurave

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet” është 73,1 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 56 %.


Nga të dhënat statistikore të vitit 2021 vërehet tendenca në rritje prej 37,5 % e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal “Fshehja e të ardhurave” në krahasim me vitin 2020.

Mospagimi i taksave dhe i tatimeve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” është 14,56% për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 30%.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara në vitin 2021 për veprën penale të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal “Mospagimi i taksave dhe i tatimeve”, prej rreth 48,89 % krahasuar me procedimet e regjistruara në vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 91,67 % janë meshkuj madhorë, 23,94 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 78 %, janë të punësuar në sektorin privat dhe 5,04 % janë të dënuar për vepra të tjera.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 19 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqet Kukës me 30 procedime dhe qarku Lezhë me 22 procedime.

Politika Penale: Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 77,23 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 22,77 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë kërkuar 2 pushim çështje dhe 2 kërkesa për tërheqje aktesh. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 70,51 % të të pandehurve, 24,36 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 5,13 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 76,53 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 23,47 % dënim me gjobë, ndërkohë ka vendosur 3 pushim çështje dhe 4 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 82,66 % të të pandehurve.

Siguria publike: Për këtë grup veprash, në vitin 2020 janë pezulluar 12 procedime, ndërkohë që në vitin 2020 janë pezulluar 7 procedime.

FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0.23 %, ndërsa në vitin 2020 ishte 0,28.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 2,26, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 2,74.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 18) rezulton se në vitin 2021 ka një ulje prej 17,95 % të numrit të procedimeve të regjistruara për grupveprat e “Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë” në krahasim me vitin 2020 dhe rritje prej 9,52 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2020 prej 43,48 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 26,09 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 35 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale të falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit madhorë, 94,74 % janë meshkuj dhe 5,26 % janë femra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 39,47 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 44,74 % me arsim të mesëm dhe 15,79 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Në lidhje me gjendjen shoqërore rezulton se 55,56 % e të pandehurve kanë qenë të papunë, 44,44 % të punësuar në sektorin privat.

Rezulton se 80,56 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 19,44 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 11,1 % rezultojnë përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 88,9 % e të pandehurve rezultojnë të padënuar më parë.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për falsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë është në prokuroritë pranë gjykatave së shkallës së parë, siç janë: Tiranë 20 % e numrit total të procedimeve, Elbasan dhe Vlorë 14 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Durrës me 13 % dhe Fier me 8% të numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Berat, Lezhë, Sarandë ku janë regjistruar rreth 2 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi dhe prokuroritë Mat, Pukë, Kavajë, Tropojë, Krujë, Kurbin Dibër nuk kanë asnjë procedim të regjistruar për këtë grupvepër.


VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Falsifikimi i monedhave

Për vitin 2021 pesha specifike e kësaj vepre përbën 96,88 % të procedimeve të regjistruara për grupin e veprave penale “Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë”, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 96,15 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedhave”, prej 17,33 % në krahasim me vitin 2020.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 94,74 % janë meshkuj madhorë, 44,74 % janë me arsim të mesëm, 55,56 %, janë të papunë dhe 11,1 % janë të dënuar për vepra të tjera.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për falsifikimin e monedhave, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 20 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqet Gjirokastrë me 7 procedime e Vlorë me 6.

Politika Penale: Për këtë grup veprash, sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 53,85 % të të pandehurve, 38,46 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 7,69 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata po ashtu ka vendosur në 53,85 % të dënimeve, aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë, në 38,46 % të dënimeve caktimin e dënimit në minimum dhe në 7,69 %, caktimin e dënimit në marzhin mesatar të përcaktuar nga dispozita.

Siguria publike: Për këtë grup veprash, në vitin 2021 janë pezulluar 41 procedime që përbëjnë 64,06 % të procedimeve të regjistruara, tregues në rritje krahasuar me vitin 2020, ku ky tregues përbënte 48,72 % të çështjeve.

Viktimat: Për këtë grup veprash në vitin 2021 shifra është e ulët për viktimat të gjithë të rritur, 33,33 % janë femra dhe 66,67 % janë meshkuj.

FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 2,71%, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 2,56 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 27,01, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 25,09.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 19) rezulton se në vitin 2021 ka rritje prej 7,42 % të numrit të procedimeve të regjistruara për grupveprat e falsifikimit të dokumenteve në krahasim me vitin 2020, rritje të numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë me 8,91 %, rritje të numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2020 prej 16,24 %, rritje të numrit të të pandehurve të dërguar në gjykatë prej 7,88 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 32,21% përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale të falsifikimit të dokumenteve për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të dhënat lidhur me gjininë e të pandehurve tregojnë se nga të pandehurit madhorë 87,2 % e tyre janë meshkuj dhe 12,8 % janë femra.

Në vitin 2021 rezultojnë të pandehur 47 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve, rezulton se 30,26 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 45,18 % me arsim të mesëm dhe 26,56 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror janë 17,82 % e të pandehurve, të punësuar në sektorin privat janë 21,29 % e të pandehurve dhe pjesa tjetër prej 60,89 % e të pandehurve, rezultojnë të papunë.

Rezulton se 75,51 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 24,49 % e të pandehurve në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 96,2 % e tyre janë të padënuar më parë dhe 3.8 % e tyre rezultojnë të dënuar për vepra penale të ndryshme.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për falsifikimin e dokumenteve është në prokuroritë pranë gjykatave së shkallës së parë, siç janë: Tiranë, 40 % e numrit total të procedimeve, Durrës, Vlorë e Shkodër secila nga 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj, sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Kurbin, Përmet, Mat, Kavajë regjistruar rreth 1 % dhe Krujë e Pukë, regjistruar më pak se 1 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Falsifikimi i dokumenteve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” është 62,45 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 53,08 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet rritje prej 20,65 % e numrit të procedimeve të regjistruara për vitin 2021 në krahasim me vitin 2020, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, “Falsifikimi i dokumenteve”.

Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i Dokumenteve” për vitin 2021 është 19,8 %, ndërkohë që vitin 2020 është 21,85 %.


Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2021 procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, kanë pësuar një ulje prej 2,56 % krahasuar me një vit më parë.

Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” është 8,21 % për vitin 2021, ndërkohë që për vitin 2020 rezulton 16,67 %.

Nga të dhënat statistikore, në vitin 2021 vërehet ulje prej 47,06 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, në krahasim me vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 87,2 % janë meshkuj madhorë, 45,18 % janë me arsim të mesëm, 60,89 %, janë të papunë dhe 3,8 % janë të dënuar për vepra të tjera.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për falsifikimin e dokumenteve, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 40 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Gjirokastrë me 41 procedime dhe qarkun Vlorë me 40 procedime.

Politika Penale: Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 98,04 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 1,96 % dënim me gjobë, ndërkohë që është kërkuar pushimi i çështjes në 3 raste. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 65 % të të pandehurve, 23,5 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 11 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 98,02 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 1,98 % dënim me gjobë, ndërkohë ka vendosur 2 pushim çështje dhe 8 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 71,21 % të të pandehurve, 22,22 % e dënimeve rezulton për caktimin e

dënimit në minimum dhe 6,06 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Në 1 rast është vendosur dënimi nën minimum, parashikuar nga neni 53 i kodit penal.

Siguria publike: Për këtë grup veprash, në vitin 2021 janë pezulluar 140 procedime që përbëjnë 18,25 % të procedimeve të regjistruara, tregues në ulje krahasuar me vitin 2020 ku procedimet e pezulluara përbënin 21,29 % të numrit të procedimeve të regjistruara.

Viktimat: Për këtë grup veprash në vitin 2021, viktimat janë të gjitha në moshë madhore, nga ku 83,33 % janë meshkuj dhe 16,67 % janë femra.

VEPRAT PENALE NË FUSHËN E FALIMENTIMIT

Tabela 20 paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të parashikuara në seksionin e IX-të të Kreut të tretë të Kodit Penal, veprat penale në fushën e falimentimit, ku siç vërehet gjatë vitit 2021 nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë grupvepër, janë 3 të pandehur të dërguar në gjykatë dhe 3 të pandehur të dënim nga gjykata.

ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,76 %, ndërsa për vitin 2020 është 0,46 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 7,66, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 4,50.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 21) rezulton se në vitin 2021 ka një rritje të numrit të procedimeve të regjistruara për grupveprat penale “Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit”, në krahasim me vitin 2020 me 69,5 %, numri i procedimeve të dërguara në gjykatë ka pësuar rritje me 48,28 %, numri i të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale është rritur me 68,79 % përkundrejt këtij totali në vitin 2020, numri i të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë me 2,97 herë dhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është rritur me 42,86 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale të zhvillimit të palejuar të lojërave të fatit për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të pandehurit rezultojnë 98,3 % meshkuj të rritur dhe 1,69 % femra të rritura.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 19,66 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 61,36 % me arsim të mesëm dhe 18,98 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Sa i përket gjendjes shoqërore, të punësuar në sektorin privat rezultojnë 67,5 % e të pandehurve, 32,5 % rezultojnë të papunë.

Nga treguesit vërehet se 71,28 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 28,72 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve, 98,96 % janë të padënuar më parë dhe 1,04 % rezultojnë të dënuar për vepra të tjera.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për zhvillimin e palejuar të lojrave të fatit është në prokuroritë pranë gjykatave së shkallës së parë, siç janë: Tiranë 27 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Berat 11%, Vlorë 9%, Korçë, Durrës dhe Elbasan secila 8 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Kavajë, Krujë, Kurbin etj, ku janë regjistruar rreth 1 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi dhe prokuroritë Pukë, Tropojë, Kukes, nuk kanë asnjë procedim të regjistruar për këtë grupveprë.


VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Organizimi i lotarive të palejuara

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit” është 93,55 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 95,31 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re tendencë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal “Organizimi i llotarive të palejuara”, në vitin 2021, me 66,34 % në krahasim me vitin 2020.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 98,3 % janë meshkuj madhorë, 61,36 % janë me arsim të mesëm, 67,5 %, janë të punësuar në sektorin privat dhe 1,04 % janë të dënuar për vepra të tjera.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për zhvillimin e palejuar të lojërave të fatit është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 27 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Berat me 19 procedime dhe qarkun Korçë me 13 procedime.

Politika Penale: Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 92,96 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 7,04 % dënim me gjobë. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 77,27 % të të pandehurve. Gjykata ka vendosur në 92,86 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 7,14 % dënim me gjobë, ndërkohë ka vendosur kthim aktesh në 1 rast. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 83,08 % të të pandehurve.

VEPRA PENALE QË CËNOJNË RREGJIMIN JURIDIK TË TOKËS


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 6,9 %, ndërsa për vitin 2020 ky tregues ka qenë 6,28 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 69,15, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 61,42.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 22) rezulton se në vitin 2021 ka një rritje prej 11,89 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që çenojnë rregjimin juridik të tokës në krahasim me vitin 2020, dhe ulje prej 4,55 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje prej 8,71 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2020, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 2,58 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 1,33 % krahasuar me vitin 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër rregjimit juridik të tokës për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë se 7,09 % e përbëjnë femrat dhe 92,91 % meshkujt.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 36,06% janë me arsim të mesëm, 4,72 % të pandehur me arsim të lartë dhe pjesa tjetër prej 59,22 % me arsim 9 vjeçar.


Në sektorin privat rezultojnë të punësuar 36,54 % e të pandehurve, në sektorin shtetëror 0,16 % dhe pjesa tjetër e të pandehurve prej 63,33 % janë të papunë.

Nga treguesit vërehet se 33,08 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 66,92 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre, 97,06 % janë të padënuar më parë, 0,38 % e të pandehurve përsëritës për të njëjtën vepër dhe 2,56 % përsëritës për vepra të ndryshme penale.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike eidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale që çënojnë rregjimin juridik të tokës është në prokuroritë pranë gjykatave së shkallës së parë, siç janë: Tiranë 19 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Shkodër e Vlorë 10%, Durrës e Elbasan 9 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Gjirokastrë, Kurbin Pogradec, Kavajë ku janë regjistruar rreth 1 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi dhe prokuroritë Pukë, Mat, Përmet regjistruar më pak se 1 % e procedimeve për këtë grupvepër.


VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Ndërtimi i paligjshëm

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale që çënojnë rregjimin juridik të tokës është 89,78 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 89,13 %.

Vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal “Ndërtimi i paligjshëm” në vitin 2021 prej 10,78 % në krahasim me vitin 2020.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 92,91 % janë meshkuj madhorë, 59,22 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 63,33 % janë të papunë.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër rregjimit juridik të tokës, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 19 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Vlorë me 187 procedime dhe qarkun Kukës me 172 procedime.

Politika Penale: Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 88,27 % të të pandehurve është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë. Gjykata ka vendosur në 92,18 % të dënimeve, aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë.

Viktimat: Për këtë grup veprash në vitin 2021 të gjitha viktimat janë në moshë madhore, nga ku 76,19 % janë meshkuj dhe 28,81 % janë femra.

VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,12 %, ndërkohë që për vitin 2020 është 1,19 %. Pra vihet re ulje e lehtë e peshës specifike të këtij grupi veprash penale për vitin 2020.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 11,09, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 11,63.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 23) rezulton se në vitin 2021 ka një ulje prej 5,14 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe rritje prej 25 % të procedimeve të dërguara në gjykatë, për vepra penale kundër mjedisit, në krahasim me vitin 2020. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2020 prej 8,23 %, rritje e numrit të të pandehurve të dërguar në gjykatë prej 27,14 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 38,29 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër mjedisit për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të pandehurit rezultojnë 97,16 % meshkuj të rritur dhe 2,84 % femra të rritura.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 54,61 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 43,97 % me arsim të mesëm dhe 1,42 % me arsim të lartë.


Të punësuar në sektorin privat rezultojnë 34,48 % e të pandehurve dhe të papunë rezultojnë të jenë 65,52 %.

Ndërsa lidhur me vendbanimin rezulton se 29,6 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 70,4 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre, 80,8 % janë të padënuar më parë, 12 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër dhe 7,2 % janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, siç janë: Tiranë regjistruar 12 % e numrit total të procedimeve për këto vepra në shkallë vendi, Elbasan regjistruar 9 %, Lezhë dhe Dibër me nga 8 % të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Sarandë, Mat, Pukë, ku janë regjistruar rreth 1 % e numrit të procedimeve penale në shkallë vendi për këtë grupvepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Ndotja e ajrit, e ujrave dhe e tokës

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” është 7,64% për vitin 2021, ndërkohë që për vitin 2020 ka qenë 12,39 %.

Nga të dhënat statistikore, vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal “Ndotja e ajrit” në krahasim me vitin 2020, me 41,46 %.

Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” është 4,46 % për vitin 2021, ndërkohë që për vitin 2020 ka qenë 7,25 %.


Nga të dhënat statistikore, vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 202/b i Kodit Penal “Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore” në krahasim me vitin 2020, me 41,67 %.

Prerja e paligjshme e pyjeve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” për vitin 2021 është 47,13 %, ndërsa në vitin 2020 është, 55,89 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal “Prerja e paligjshme e pyjeve”, në vitin 2021 prej 20 % në krahasim me vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: Meshkuj madhorë janë, 97,16 % e të pandehurve; me arsim deri 9-vjeçar, 54,61 % të papunë janë, 65,52 % përsëritës për të njëjtën vepër janë 12 % dhe 7,2 % janë përsëritës për vepra të tjera.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër mjedisit, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë me 12 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqun Kukës me 36 procedime dhe qarkun Gjirokastrë me 26 procedime.

Politika Penale: Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se 33,34 % e kërkesa kanë qenë për dënimin me gjobë dhe 66,66 % për dënimin me burg, ku është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 84,09 % të rasteve. Gjykata ka vendosur në 29,23 % të dënimeve dënimin me gjobë dhe në 70,77 % dënimin me burg, ku në 71,74 % të rasteve është pezulluar vendimi i dënimit me burgim dhe i pandehuri është vendosur në provë. Në 1 rast është vendosur pushim çështje dhe 1 rast pafajësi.

Siguria publike: Për këtë grup veprash, në vitin 2020 janë pezulluar 80 procedime që përbëjnë 25,48 % të procedimeve të regjistruara, tregues në rritje krahasuar me vitin 2020 ku procedimet e pezulluara përbënin 21,45 % të numrit të procedimeve të regjistruara.

KRIME KUNDËR PAVARËSISË E RENDIT KUSHTETUES

dhe

KRIME QË CËNOJNË MARRËDHËNIET ME SHTETET E TJERA

Pesha specifike që zënë krimet kundër rendit kushtetues dhe krimet që çënojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021 është 0,007 %, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 0,03 %.

Krime kundër rendit kushtetues

Të dhënat statistikore (tabela 24) tregojnë se gjatë vitit 2021 janë regjistruar 2 procedime penale për krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, ndërkohë që janë dënuar 3 të pandehur nga gjykata. Konkretisht, janë regjistruar 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 223 i Kodit Penal “Thirrjet publike për veprime të dhunshme”, të dyja procedime të pezulluara.

VEPRA ME QËLLIME TERRORISTE

Pesha specifike që zënë veprat me qëllime terroriste në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021 është 0,03 %, ndërsa në vitin 2020 ky tregues ka qenë 0,04 %.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 25) rezulton se totali i procedimeve të regjistruara për vepra penale me qëllime terroriste në vitin 2021 është 9, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 9.

Prokuroria në vitin 2021 ka regjistruar:

2 procedime penale për nenin 230 të Kodit Penal “Vepra me qëllime terroriste”;

3 procedime penale për nenin 230/a të Kodit Penal “Financimi i terrorizmit”;

2 procedime penale për nenin 232 të Kodit Penal “Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”;

1 procedim penal për nenin 232/a të Kodit Penal “Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”, ndërkohë që për këtë vepër 2 të pandehur janë dërguar për gjykim;

1 procedim penal për nenin 232/b të Kodit Penal “Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”.

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHETETËRORE TË KRYERA NGA SHETETASIT


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 1,89 %, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 2,45 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 18,91, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 23,93.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 27) rezulton se në vitin 2021 ka një ulje prej 21,44 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” dhe ka një ulje prej 14,84 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2020. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje 27,75 % e numrit të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2020, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 18,8 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 9,93 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, rreth 1,49 % kanë qenë të pandehur të mitur. Të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) rezultojnë 97,58 % meshkuj dhe 2,42 % femra.

Në këtë grup veprash rezultojnë edhe 4 të pandehur të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 40 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 50,37 % me arsim të mesëm dhe 9,63 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror rezultojë 1,05 % e të pandehurve, nga sektori privat janë regjistruar 23,86 % e të pandehurve dhe të papunë 75,09 %.

Rezulton se 66,15 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 33,85 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve rreth 92,2 % janë të padënuar më parë ndërsa 7,63 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme, 0,16 % përsëritës për të njëjtën vepër penale.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, siç janë: Tiranë regjistruar 33 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në

shkallë vendi, Elbasan 9 %, Korçë 7 % e procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Mat, Tropojë, Lushnjë, Krujë, ku janë regjistruar rreth 1 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër, si dhe në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Përmet dhe Pukë nuk është regjistruar asnjë procedim për këtë grupvepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” është 23,55 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 28,93 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje prej 36,04 % e procedimeve të regjistruara në vitin 2021 për veprën penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” në krahasim me vitin 2020.

Goditjet për shkak të detyrës

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” në vitin 2021 është 17,38 %.


Për këtë vepër penale rezulton tendenca në ulje prej 7 % e procedimeve të regjistruara në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.

Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik

Pesha specifike që zë kjo vepër në grupin e veprave penale “Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” është 40 % në vitin 2021, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 40,53%.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendencë në ulje prej 22,46 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”, në krahasim me vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 97,58 % janë meshkuj madhorë, 50,37 % janë me arsim të mesëm, 75,09 %, janë të papunë dhe 7,63 % janë përsëritës.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 33 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Kukës me 34 procedime dhe qarkun Lezhë me 28 procedime.

Politika Penale: për këtë grup veprash, 61,1 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 55,28 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 68,32 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 31,68 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë kërkuar edhe 5 pushim çështjeje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 59,32 % të të pandehurve, për 18,25 % të kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 18,63 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, ndërsa për 0,38 është kërkuar masa maksimale e dënimit. Për 2,66 % të rasteve është kërkuar dënimi i të pandehurve me masën e paraburgimit. Gjykata ka vendosur në 69,95 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 30,05 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 5 pushim çështjeje dhe 1 vendim pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 63,36 % të të pandehurve, 17,18 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe po aq në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, në 1 rast është vendosur dënimi nën minimum dhe për 1 të pandehur është vendosur dënimi me masën e paraburgimit.

Viktimat: Për këtë grup veprash në vitin 2021 nga numri total i viktimave rezultojnë, 97,06 % viktimat të rritur dhe 2,94 % (të mitur-nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 78,79 % janë meshkuj dhe 21,21 % janë femra.

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 2,09 %, ndërsa në vitin 2020 pesha e këtyre veprave ka qenë 2,34 %. Pra, vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2021 në krahasim me vitin 2020.


Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 20,99, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 22,91.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 28) rezulton se në vitin 2021 ka një ulje prej 8,89 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit

shtetërorë ose në shërbim publik, në krahasim me vitin 2020 dhe ulje prej 17,44 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2020 prej 47,5 %, numri i të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë është ulur 16,2 %, ndërsa numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është ulur me 23,46 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit, për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të pandehurit e rritur (mbi 18 vjeç) rezultojnë 12,67 % femra dhe 87,33 % meshkuj.

Lidhur me arsimin rezulton se 74,74 % e tyre janë me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror janë 62,94 % e të pandehurve, nga të cilët 58,04 % janë nëpunës të thjeshtë.

Rezulton se 80,28 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 19,73 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 98,96 % e të pandehurve janë të padënuar më parë.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, siç janë: Tiranë regjistruar 22 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Vlorë 9 %, Elbasan 8 %, Durrës dhe Shkodër nga 7 % të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Përmet, Kurbin, Mat, ku janë regjistruar rreth 1 % ose me pak se 1 % e numrit të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë grupvepër, si dhe në Pukë nuk është regjistruar asnjë procedim për këtë grupvepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shpërdorim detyrë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2021 në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik” është 93,09 %, ndërsa për vitin 2020 ky tregues ka qenë 92,94 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorim detyrë”, në vitin 2021, prej 8,75 % në krahasim me vitin 2020.

Kryerja e veprimeve arbitrare

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik” në vitin 2021 është 4,89 % ndërsa në vitin 2020 ka qenë 5,52 %. Pra ky tregues rezulton në ulje për vitin 2020.


Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal “Kryerja e veprimeve arbitrare” në vitin 2021 është ulur me 19,45 %, krahasuar me vitin 2020.

Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim

Pesha specifike që zë kjo vepër në grupin e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë në vitin 2021 është 0,17 % ndërsa në vitin 2020 ka qenë 0,61 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet se për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” ka tendencë në ulje të numrit të procedimeve e konkretisht nga 4 procedime të regjistruara në vitin 2020, në 1 procedim të regjistruara në vitin 2021.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 87,33 % janë meshkuj madhorë dhe 74,74 % janë me arsim të lartë.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 22 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Kukës me 47 procedime dhe qarkun Gjirokastrë me 45 procedime.

Politika Penale: për këtë grup veprash, 48,3 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 40,45 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 97,3 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 2,7 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë kërkuar në 6 raste pushim akuze. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 63,89 % të të pandehurve, për 13,89 % të kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 22,22 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 98,4 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 1,6 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 6 pushim akuze, 2 pushim çështje dhe 14 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 72,12 % të të pandehurve, 13,11 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 11,47 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 3,27 nën minimumin e parashikuar nga ligji.

VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 20,21 % ndërsa në vitin 2020 ka qenë 18,77 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2021 në krahasim me vitin 2020.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 202,49, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 183,66.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore për “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” (tabela 29) rezulton se në vitin 2021 ka një rritje prej 9,62 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe rritje prej 6,94 % e numrit të të pandehurve të regjistruar në krahasim me vitin 2020. Në lidhje me numrin e procedimeve të dërguara në gjykatë për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje përkundrejt këtij totali në vitin 2020 prej 5,76 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 8,69 % si dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 16,19 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Nga të pandehurit, 4.3 % kanë qenë të pandehur të mitur dhe 95,7 % të rritur (mbi 18 vjeç). Të pandehurit meshkuj përbëjnë edhe për këtë grup veprash pjesën më të madhe e konkretisht 95,56 % ndër të cilët 4,44 % të mitur dhe 3,16 % femra të rritura.

Rezultojnë 22 të pandehur me shtetësi të huaj.


Në lidhje me arsimin e të pandehurve, rezulton se 41,62 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 47,91 % me arsim të mesëm dhe 10,47 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror janë rreth 1,21 % e të pandehurve, në sektorin privat rezultojnë të punësuar 32,82 % e të pandehurve dhe të papunë 65,97 %.

Rezulton se 62,08 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 37,92 % prej tyre në fshat. Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 95,28 % e tyre janë të padënuar më parë, 4.37 % prej tyre janë përsëritës në vepra penale të ndryshme dhe 0,35 % përsëritës për të njëjtën vepër.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, siç janë: Tiranë regjistruar 34 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra, Durrës 9 %, Elbasan 8 %, Lezhë 6 % e procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Mat, Pukë, Tropojë, Përmet, ku janë regjistruar rreth 1 % ose me pak se 1 % e numrit të procedimeve penale në shkallë vendi për këtë grupvepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Vetëgjyqësia

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2021 është 3,53 %, ndërsa për vitin 2020 ka qenë 4,40 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca e në ulje prej 12,17 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal “Vetëgjyqësia”, në krahasim me vitin 2020.

Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2021 është 6,39 %, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 5,99 % ose me e ulët.


Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca në rritje prej 16,94 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” i Kodit Penal në krahasim me vitin 2020.

Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2021 është 3,4 %, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 2,03 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca në rritje prej 83,96 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”, në krahasim me vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2021 është 16,91 %, ndërkohë që për vitin 2020 ka qenë 15,23 % ose më e ulët.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca në rritje prej 21,73 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, në krahasim me vitin 2020.

Largimi nga vendi i aksidentit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” është 4,92 % për vitin 2021, ndërsa në vitin 2020 pesha specifike e kësaj veprë ka qenë 5,74 %.


Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet se procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal “Largimi nga vendi i aksidentit”, janë ulur 6 % krahasuar me vitin 2020.

Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2021 është 54,5 %, që përbën edhe peshën më të lartë, ndërsa në vitin 2020 ky tregues ka qenë 53,85 % ose më i ulët.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” në vitin 2021, prej 10,94 % në krahasim me vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIMET

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 96,56 % janë meshkuj të rritur, 41,62 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 65,97 % janë të papunë, 0,35 % janë përsëritës për të njëjtën vepër dhe 4,37 % janë të dënuar për vepra të tjera.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër rendit dhe sigurisë, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 34 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Lezhë me 421 procedime dhe qarkun Tiranë me 224 procedime.

Politika Penale: për këtë grup veprash, 21,93 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 18,89 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 95,4 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 4,6 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë kërkuar tërheqja e akteve në 4 raste, 1 pushim akuze dhe 7 pushim çështjeje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 77,2 % të të pandehurve, për 0,1 % të tyre është kërkuar ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, për 12,8 % të kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 9,5 % në marzhin mesatar dhe 0,1 % në marzhin maksimal të dënimit të parashikuar nga dispozita, në 0,27 % të rasteve është dënim me kohën e paraburgimit. Gjykata ka vendosur 93,57 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 6,43 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 9 kthim aktesh, 12 pushim çështjeje dhe 25 vendime

pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 79,58 % të të pandehurve, për 0,24 % të tyre është vendosur ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, 13,13 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 6,84 % në marzhin mesatar dhe 0,07 % në marzhim maksimal të dënimit të parashikuar nga dispozita (0,14 % të liruar me kohën e paraburgimit).

Siguria publike: Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2021 është 392 ose 6,84 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2020, ky tregues përbënte 8,36 % të procedimeve të regjistruara.

Viktimat: Për këtë grup veprash në vitin 2021 nga numri total i viktimave rezultojnë, 95,67 % viktima të rritur dhe 4,33 % (të mitur-nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 71,85 % janë meshkuj dhe 28,15 % janë femra.

VEPRA PENALE QË LIDHEN ME PASTRIMIN E PARAVE


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,06 %, ndërsa në vitin 2020 ky tregues ka qenë 1,03 %. Pra vihet re një rritje e lehtë këtij treguesi për vitin 2021 në krahasim me vitin 2020.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 10,64, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 10,05 ose me i ulët.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 30) rezulton se në vitin 2021 ka një rritje prej 5,24 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, në krahasim me vitin 2020. Ndërkaq kemi ulje 21,74 %, të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2020. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar me 31,71 %, numri i të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë është ulur me 28,26 % ndërsa numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është rritur me 23,53 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër pastrimit të parave për vitet 2020-2021 paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i të pandehurve të rritur (mbi 18 vjeç), rezultojnë të pandehur meshkuj 92,71 % dhe femra 7,29 %.

Ndër të pandehurit, rezultojnë edhe 3 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 40,2% e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 46,4 % me arsim të mesëm dhe 13,4 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore rezulton se 41,03 % e të pandehurve janë nga sektori privat dhe 58,97 % janë të papunë.

Rezulton se 69,07 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 30,93 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 85,57 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, ndërsa 13,4 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme, 1,03 % janë të dënuar për vepra penale të njëjta.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike eidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër pastrimit të parave është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, siç janë: Tiranë regjistruar 19 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë vepër, Dibër, 13 %, Vlorë 11 %, Durrës 9 %, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Tropojë, Krujë, Pukë, ku janë regjistruar rreth 1 % ose me pak se 1 % e numrit të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë grupvepër, si dhe në Kukës, Kurbin dhe Mat nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë vepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale

Pesha specifike që zë kjo vepër në grupin e veprave penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale për vitin 2021 është 95,68 % ndërsa në vitin 2020 ka qenë 97,55 %.

Gjatë vitit 2021 vërehet tendenca në rritje prej 3,23 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, në krahasim me vitin 2020.

Ecuria e kësaj veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 92,71 % janë meshkuj, 46,4 % janë me arsim të mesëm, 58,97 % janë të papunë dhe 85,57 % janë të padënuar më parë.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër pastrimit të parave, është regjistruar në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë 19 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Dibër me 35 procedime dhe qarkun Gjirokastrë me 31 procedime.

Politika Penale: Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në të gjitha rastet është kërkuar dënim me burg. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 62,5 % të të pandehurve, 12,5 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 25 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në të gjithë rastet dënim me burg, ndërkohë që në 1 vendim ka vendosur pafajësi. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 61,9 % të të pandehurve, për 14,29 % të të pandehurve është vendosur dënim në minimum dhe 23,81 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.

Siguria publike: Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2021 është 52 ose 17,28 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2020, ky tregues përbënte 18,18 % të procedimeve të regjistruara.

VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHETËTORË


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2021 është 3,03 %, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 3,15 %. Pra vihet re një ulje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2021 në krahasim me vitin 2020.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 30,39 ndërsa, në vitin 2020 ka qenë 30,78.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 31) rezulton se në vitin 2021 numri i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë, është ulur 1,83 % në krahasim me vitin 2020 dhe numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është rritur 1,44 % në krahasim me një vit më parë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2020 prej 9,54 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 9,54 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 22,05 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë 96,68 % meshkuj dhe 3,32 % femra.

Të pandehur të huaj rezultojnë 40.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 53,66 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 42,25 % me arsim të mesëm dhe 4,09 % me arsim të lartë.


Të punësuar në sektorin privat janë regjistruar 4,99 % e të pandehurve, në sektorin shtetëror 0,81 % dhe pjesa tjetër prej 94,2 % rezulton e papunë.

Rezulton se 53,68 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 46,32 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 92,58 % e tyre janë të padënuar më parë, 6,75 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të tjera dhe 0,67 % përsëritës për të njëjtën vepër.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërore është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, siç janë: Tiranë regjistruar 35 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra, Pogradec dhe Gjirokastr nga 9 %, Korçë dhe Diber nga 8 % etj, sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepra është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Tropojë, Lushnjë, Lezhë, Kurbin ku janë regjistruar rreth 1 % ose me pak se 1 % e numrit të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë grupvepra, si dhe në Mat, Pukë, Përmet, Krujë e Kavajë nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këto grupvepra.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë” në vitin 2021 është 64,53 %, ndërsa në vitin 2020 ky tregues ka qenë 72,26 %.


Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca në ulje prej 12,32 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, në krahasim me vitin 2020.

Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë” për vitin 2021 është 34,3 %, ndërsa për vitin 2020 ky tregues ka qenë 27,28 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca në rritje prej 23,43 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”, në krahasim me vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 96,68 % janë meshkuj, 53,66 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 94,2 % janë të papunë dhe 6,75 % janë përsëritës, për vepra të ndryshme penale.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 35 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Gjirokastrë me 136 procedime, qarkun Kukës me 79 procedime dhe qarkun Korçë me 73 procedime.

Politika Penale: Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 44,8 % të të pandehurve është kërkuar dënim me gjobë dhe në 55,38 % dënim me burg, ndërkohë që ka patur 5 kërkesa për pushim çështje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 55,38 % të të pandehurve, në 1,15 % është kërkuar ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, 8,46 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 34,62 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 0,38 % në marzhin maksimal të dënimit. Gjykata ka vendosur në 45,16 % të dënimeve dënim me gjobë dhe në 54,84 % dënim me burg, ndërkohë që janë vendosur 4 pushim akuze, 2 pushim çështje dhe 4 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 61,18 % të të pandehurve, në 6,67 % është vendosur caktimi i dënimit në minimum dhe në 30,98 % të dënimeve me burg, është vendosur marzhi mesatar i dënimit i parashikuar nga dispozita, në 0,39 % të rasteve është vendosur marzhi maksimal i dënimit, në 0,78 % të rasteve është vendosur ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

Siguria publike: Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2020 është 33 ose 3,84 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2020, ky tregues përbënte 3,31 % të procedimeve të regjistruara.

VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 1,96 % ndërsa për vitin 2020 ka qenë 1,81 %. Pra vihet re rritje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2021 në krahasim me vitin 2020.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 19,61, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 17,71.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 32) rezulton se në vitin 2021 ka një rritje prej 10,12 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër drejtësisë në krahasim me vitin 2020 e ndërkaq numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është ulur me 9,73 %. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar prej 3,8 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 8,19 % përkundrejt këtij totali në vitin 2020 dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 13,36 % krahasuar me një vit më parë.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër drejtësisë për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Sa i përket gjinisë së të pandehurve nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezulton se 9.33 % janë femra dhe 90,67 % meshkuj.

Ndër të pandehurit rezultojnë edhe 5 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 53,32 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-veçar, 38,6 % me arsim të mesëm dhe 8,08 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin privat rezultojnë 27,14 % e të pandehurve dhe të papunë 72,49 %, ndërkohë që 0,37 % rezultojnë të punësuar në sektorin shtetëror.

Sa i përket vendbanimit, vërehet se 65,12 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 34,88 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 76,69 % janë të padënuar më parë, 23,15 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 0,16 % janë përsëritës për të njëjtën vepër.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërore është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, siç janë: Tiranë regjistruar 26 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra, Vlorë dhe Fier nga 9 %, Elbasan 8 % e numrit të procedimeve të regjistruara etj, sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Mat, Pukë, Tropojë, Përmet ku janë regjistruar rreth 1 % ose me pak se 1 % e numrit të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë grupvepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2021 është 11,7 %, tregues në ulje krahasuar me vitin 2020 gjatë të cilit pesha specifike e kësaj vepre ishte 13,89 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca në ulje prej 7,14 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal “Pengime për ekzekutimin e vendimit të gjykatës”, në krahasim me vitin 2020.

Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2021 është 25,59 %, ndërsa në vitin 2020 pesha që zinin procedimet e regjistruara për këtë vepër përbënte 20,04 % të totalit të grupit.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca në rritje prej 40,59 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 321 i Kodit Penal “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”, në krahasim me vitin 2020.

Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2021 është 21,26 %, ndërsa në vitin 2020 pesha që zinin procedimet e regjistruara për këtë vepër përbënte 22,22 %.


Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 323 i Kodit Penal “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, në vitin 2021, prej 5,36 % në krahasim me vitin 2020.

Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim

Pesha specifike e kësaj vepre në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2021 është 12,6 %, ndërkohë që në vitin 2020 ky tregues ishte më e lartë, 14,48 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca në ulje prej 4,1 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 324/a i Kodit Penal “Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim”, në krahasim me vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 90,67 % janë meshkuj, 53,32 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 72,49 % janë të papunë dhe 23,15 % janë të dënuar më parë.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër drejtësisë, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 26 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Lezhë me 34 procedime dhe qarkun Vlorë me 33 procedime.

Politika Penale: për këtë grup veprash, 83,6 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 76,23 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 85,95 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 14,05 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka patur 2 kërkesa për pushim çështje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 34,98 % të të pandehurve, 37,26 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 26,99 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, 0,38 % në marzhin maksimal dhe po aq kërkesa për dënimin me masën e paraburgimit. Gjykata ka vendosur në 85,2 % të dënimeve dënim me burg dhe në 14,8 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë vendosur 6 pushim çështjeje dhe 7 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 38,74 % të të pandehurve, në 34,78 % është vendosur caktimi i dënimit në minimum dhe në 24,9 % të dënimeve me burg, është vendosur marzhi mesatar i dënimit i parashikuar nga dispozita (1,58 % e të pandehurve dënuar me kohën e vuajtur në paraburgim).


Siguria publike: Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2021 është 35 ose 6,3 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2020, ky tregues përbënte 16,87 % të procedimeve të regjistruara.

VEPRA PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA DHE SISTEMIN DEMOKRATIK TË ZGJEDHJEVE

Të dhënat në lidhje me veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve (tabela 33) tregojnë se gjatë vitit 2021 janë regjistruar 47 procedime penale, ndërsa në vitin 2020 janë regjistruar 5 procedime penale.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Detyrimi për pjesmarrje në veprimtari politike

Kjo vepër zë peshën specifike më të madhe në grupin e veprave penale “Që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”, për vitin 2021 është 44,68 %, tregues në rritje krahasuar me vitin 2020 gjatë të cilit pesha specifike e kësaj vepre ishte 40 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca në rritje prej 21 procedime të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal “Detyrimi për pjesmarrje në veprimtari politike”, krahasuar me vetëm 2 procedime të regjistruara për vitin 2020.

Krahas kësaj vepre penale në këto grupvepra janë regjistruar dhe 26 procedime penale, janë dërguar për gjykim 7 çështje penale me 52 të pandehur dhe janë dënuar 46 persona, të cilët sipas veprave penale janë: -për “Pengim të subjekteve zgjedhore” të parashikuar nga neni 325 i K.Penal është dërguar për gjykim 1 çështje me 1 të pandehur; -për “Falsifikim të materjalit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhësve” të parashikuar nga neni 326 i K.Penal janë dërguar për gjykim 2 çështje me 6 të pandehur dhe janë dënuar 19 persona; -për “Shkelje të fshehtësisë së votimit” të parashikuar nga neni 327 i K.Penal janë dërguar për gjykim 2 çështje me 2 të pandehur dhe janë dënuar 2 persona; dhe -për veprën penale “Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar” parashikuar nga neni 327/a i K.Penal janë dërguar për gjykim 2 çështje me 43 të pandehur dhe janë dënuar 19 persona

VEPRAT PENALE TË KORRUPSIONIT

Nga të dhënat statistikore (tabela 34) rezulton se në vitin 2021 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm janë regjistruar 100 procedime penale për veprat penale të korrupsionit, në lidhje me 87 të pandehur. Janë dërguar në gjykatë 54 procedime me 55 të pandehur dhe janë dënuar 19 të pandehur për këto vepra.

Ndryshe nga viti 2020, këto të dhëna për vitin 2021 përfshijnë dhe veprat penale⁸⁰ të parashikuara nga pika 1 e nenit 244 “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, pikat 1 e 3 të nenit 245/1 “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, dhe

⁸⁰ Shih nenet 1, 2, 3, 4 të ligjin nr.43/2021 që ka ndryshuar/shtuar nenet 244, 245/1, 258 e 259 të Kodit Penal.

pika 1 e nenit 259 “Korrupsioni pasiv i personave me funksione publike” të Kodit Penal, të cilat deri në qershor të vitit 2021 ishin në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme⁸¹.

Sa i përket veprave penale të korrupsionit, në fushën e përgjegjësisë së prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, vërehet tendencë në rritje për vitin 2021, krahasuar me vitin 2020, konkretisht:

- Për nenin 244 të Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, janë regjistruar 66 procedime penale me 63 të pandehur, për vitin 2021;
- Për nenin 164/b të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv në sektorin privat”, janë regjistruar 2 procedime penal, kundrejt 1 procedimi të regjistruar për vitin 2020;
- Për nenin 328 të Kodit Penal “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” për vitin 2021 janë regjistruar 12 procedime penale me 8 të pandehur.
- Për nenin 328/b të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv në zgjedhje është regjistruar 1 procedim penale me 2 të pandehur.
- Për nenin 259 “Korrupsioni pasiv i personave me funksione publike”, janë regjistruar 15 procedime penale me 12 të pandehur për vitin 2021;

KRIMI KIBERNETIK


Pesha specifike që zë ky grup veprash penale në numrin total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2021, është 0,81 %, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 0,56.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 8,16, ndërsa në vitin 2020 ka qenë më i ulët ose 5,48%.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 35) rezulton se në vitin 2021 numri i procedimeve të regjistruara, është rritur me 48,08 % krahasuar me një vit më parë, ka një rritje të numrit të procedimeve dërguar në gjykatë, nga 6 procedime në vitin 2020 në 10 procedime dërguar në gjykatë në vitin 2021 (66,67 %), rritje të numrit të të pandehurve të regjistruar në vitin 2021 përkundrejt këtij totali në vitin 2020 nga 3 në 25 (8,3 herë), rritje të numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë nga 8 në 21 (2,6 herë) ndërsa numri i të pandehurve të dënuar për vepra penale kundër krimit kompjuterik nuk ka pësuar ndryshim, ngelet i njëjti 6.

Grafikisht tendenca e krimit kibernetik për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



⁸¹ Shih nenin 39 të ligjit nr.41/2021 që ka ndryshuar nenin 75/a të K.Pr.Penale, hyrë në fuqi me datë 1 qershor 2021.

TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:


Të pandehurit janë të gjithë të rritur (mbi 18 vjeç) nga të cilat 84,21 % meshkuj dhe 15,79 femra %. Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 73,68 % e tyre janë me arsim të mesëm, 15,79 % me arsim të lartë, 10,53 % me arsim deri 9-vjeçar.

Rezulton se 50 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet dhe 50 % në fshat.

Ndërsa lidhur me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se të gjithë të pandehurit janë të padënuar më parë.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për krimin kibernetik është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, siç janë: Tiranë regjistruar 65 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra, Elbasan dhe Shkodër nga 6 % e procedimeve të regjistruara, etj, sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Berat, Kukës, Lushnjë, Kavajë, Pogradec, Përmet, Dibër, Sarandë, Kurbin, Gjirokastrë ku janë regjistruar rreth 1 % ose me pak se 1 % e numrit të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë grupvepër, si dhe në Mat, Pukë e Krujë nuk është regjistruar asnjë procedim për këtë grupvepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Mashtrimi kompjuterik

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër krimit kompjuterik” për vitin 2021 është 30,74 %, ndërsa për vitin 2020 ka qenë 40,38 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca në rritje prej 12,69 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143/b i Kodit Penal “Mashtrimi kompjuterik”, në krahasim me vitin 2020.

Falsifikimi kompjuterik

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër krimit kompjuterik” është 32,03 % për vitin 2021, ndërsa në vitin 2020, ky tregues ka qenë 21,15 %.


Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara në vitin 2021 për veprën penale të parashikuar nga neni 186/a i Kodit Penal, “Falsifikimi kompjuterik”, është rritur nga 33 në 74 procedime ose 124,2 % (2,24 herë).

Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër krimit kompjuterik” është 30,3 % për vitin 2021, ndërsa në vitin 2020, ky tregues ka qenë 32,69 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara në vitin 2021 për veprën penale të parashikuar nga neni 293/b i Kodit Penal, “Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike”, është rritur nga 51 në 70 procedime ose 37,25 %.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 84,21 % janë meshkuj madhorë, 15,79 % janë me arsim të lartë, 50 % të punësuar në sektorin privat.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për krimin kibernetik, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 65 % dhe koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton po në qarkun Tiranë me 17 procedime.

Politika Penale: Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në të gjithë rastet është kërkuar dënim me burg dhe është vendosur nga gjykata dënim me burg, ndërkohë gjykata ka vendosur pafajësi për 3 raste. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 22,22 % të të pandehurve dhe po aq rezulton për caktimin e dënimit në minimum, në 55,56 % të rasteve është kërkuar dënimi në marzhin mesatar të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë për 50 % të të pandehurve, është vendosur caktimi i dënimit në minimum për 1 të pandehur dhe po për 1 të pandehur është vendosur marzhi mesatar i dënimit i parashikuar nga dispozita.

Siguria publike: Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2021 është 121 ose 52,38 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2020, ky tregues përbënte 71,15 % të procedimeve të regjistruara.

TRAFIQET E PALIGJSHME


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,88 %, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 0,93 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 8,83 ndërsa në vitin 2020 ka qenë 9,07.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 36) rezulton se në vitin 2021 ka një ulje prej 3,1 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të trafikeve të paligjshme në krahasim me vitin 2020. Numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është rritur 2,5 % ndërsa në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale vërehet një rritje prej 44,71 % e të pandehurve të regjistruar, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 18,75 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 48,28 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale të trafikeve për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Sipas gjinisë, rezultojnë se 3,15 % janë femra dhe 96,85 % janë meshkuj.

Në vitin 2021 rezultojnë si të pandehur për këto grup vepra 9 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 40,16 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 56,69 % me arsim të mesëm dhe 3,15 % me arsim të lartë.


Në lidhje me gjendjen shoqërore të të pandehurve rezulton se 45,16 % janë të punësuar në sektorin privat, 1,08 % janë të punësuar në sektorin shtetëror dhe 53,76 % janë të papunë.

Rezulton se 75,63 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 24,37 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 92,44 % e të pandehurve janë të padënuar më parë dhe 6,72 % prej tyre rezultojnë përsëritës në vepra penale të ndryshme.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për trafiket e paligjshme është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, siç janë: Durrës regjistruar 25 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto grupvepra në shkallë vendi, Tiranë 18 % Kukës 8 %, Vlorë dhe Shkodër nga 7 % e procedimeve të regjistruara etj, sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Dibër, Përmet Tropojë, Krujë, Kavajë ku janë

regjistruar rreth 1 % ose me pak se 1 % e numrit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për këtë grupvepër, si dhe në Mat e Pukë nuk është regjistruar asnjë procedim për këtë grupvepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Trafikimi i personave të rritur

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikeve të paligjshme” në vitin 2021 është 3,2 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021, vërehet një tendencë në ulje prej 65,2 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal “Trafikimi i personave të rritur” në krahasim me vitin 2020.

Trafikimi i të miturve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikeve të paligjshme” në vitin 2021 është 0,8 % ndërsa në vitin 2020 ka qenë 1,94 %.

Numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal “Trafikimi i të miturve”, në vitin 2021 është 2, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 5 procedime.

Trafikimi i mjeteve motorike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikeve të paligjshme” është 66,8 % për vitin 2021, ndërkohë që për vitin 2020 ka qenë 57,36 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendencë në rritje prej 12,84 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal “Trafikimi i mjeteve motorike”, në krahasim me vitin 2020.

Trafikimi i armëve dhe i municionit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikeve të paligjshme” është 2,4 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal “Trafikimi i armëve dhe i municionit”, është ulur nga 7 procedime penale të regjistruara në vitin 2020, në 6 procedime penale në vitin 2021.

Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikeve të paligjshme” është 1,2 %.

Trafikimi i narkotikëve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikeve të paligjshme” në vitin 2021 është 25,2 %, ndërkohë që në vitin 2020 ky tregues ka qenë 28,68 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2021 vërehet tendenca në ulje prej 14,86 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal “Trafikimi i narkotikëve”, në krahasim me vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME PRODHIMIN DHE KULTIVIMIN E NARKOTIKËVE


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2021 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 7,08 %, ndërsa për vitin 2020 ka qenë 6,18 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2021 në krahasim me vitin 2020.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2021 është 70,96, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 60,47.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 37) rezulton se në vitin 2021 ka një rritje prej 16,68 % të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë grup veprash penale në krahasim me vitin 2020 e ndërkaq kemi rritje prej 42,92 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2020. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2020 prej 26,14 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 31,84 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 66,67 % përkundrejt vitit 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë 98,08 % të pandehur meshkuj, (mbi 18 vjeç) nga totali i meshkujve, 3,23 janë % meshkuj të mitur (14 deri 18 vjeç). Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë 1,91 % femra nga të cilat 7,4 % janë të mitura.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 46,17 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 43,55 % me arsim të mesëm dhe 10,28 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Në vitin 2021 rezultojnë si të pandehur për këto grup vepra 14 shtetas të huaj.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori privat janë regjistruar 14,45 % e të pandehurve, të punësuar në sektorin shtetëror 0,14 % dhe të papunë 85,41 %.

Rezulton se 52,44 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 47,56 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 90,6 % e tyre janë të padënuar më parë, 1,35 % janë përsëritës për të njëjtën vepër, ndërsa 8,05 % janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2021, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:



Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprat penale të prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, siç janë: Tiranë regjistruar 19 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Vlorë 13 %, Shkodër 12 %, Krujë 10 %, e procedimeve të regjistruara etj, sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Pukë, Dibër, Pogradec, Kukës, Kavajë, Përmet, etj, ku janë regjistruar rreth 1 % ose me pak se 1 % e numrit të procedimeve penale në shkallë vendi për këtë grupvepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Prodhimi dhe shitja e narkotikëve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në këtë grup është 51,29 % për vitin 2021, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 48,46 %.


Nga të dhënat statistikore vihet re se në vitin 2021 për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, numri i procedimeve të regjistruara ka pësuar një rritje prej 23,5 % në krahasim me vitin 2020.

Kultivimi i bimëve narkotike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale këtë grup është 48,5 % për vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2020 ka qenë 51,42 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal “Kultivimi i bimëve narkotike” në vitin 2021, prej 10,05 % në krahasim me vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2017-2021 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 98,08 % janë meshkuj, 43,55 % janë me arsim të mesëm, 85,41 % janë të papunë dhe 1,35 % janë përsëritës për të njëjtën vepër dhe 8,05 % janë përsëritës për vepra të tjera.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë me 19 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Vlorë me 163 procedime dhe qarkun Lezhë me 148 procedime.

Politika Penale: për këtë grup veprash, 83,17 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 78,35 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 35,46 % të të pandehurve, 14,62 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 46,37 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 1,56 % në marzhin maksimal. Gjykata ka vendosur aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë për 39,84 % të të pandehurve, 16,09 % e dënimeve rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 42,52 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 0,94 % në marzhin maksimal.

Siguria publike: Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2021 është 648 ose 32,27 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2020, ky tregues përbënte 40,27 % të procedimeve të regjistruara.

VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

Profili i të pandehurve: 96,85 % janë meshkuj, 40,16 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 53,76 % janë të papunë dhe 6,72 % janë të dënuar më parë për vepra të ndryshme.

Gjeografia sociale: numri më i lartë i procedimeve për trafiket e paligjshme, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 25 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun me Gjirokastrë 33 procedime dhe qarkun Kukës me 27 procedime.

Politika Penale: për këtë grupveprash, 98,65 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 89,87 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 8,69 % të të pandehurve, për 8,69 % të kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 82,6 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë për 9,3 % të të pandehurve, po aq janë dënuar me marzhin minimal të dënimit, 81,39 % rezulton për caktimin e dënimit mesatar, ndërkohë që rezulton edhe 3 vendime pafajësie.


Siguria publike: Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2021 është 144 ose 57,6 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2020, ky tregues përbënte 42,64 % të procedimeve të regjistruara.

2.10 TREGUESI I EFEKTIVITETIT TË ORGANIT TË PROKURORISË NË VITE, NË NGRITJEN E AKUZËS NË FAZËN E HETIMIT PARAPRAK

Nga të dhënat statistikore rezulton se treguesi i efektivitetit të ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraparak ka qenë si më poshtë:


Në vitin 2021 janë përfunduar hetimet për 14979 të pandehur nga të cilët 12343 janë dërguar në gjykatë ose 82 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 2636 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 18 % të të pandehurve. Në vitin 2020 janë përfunduar hetimet për 13805 të pandehur nga të cilët 11503 janë dërguar në gjykatë ose 83 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 2298 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 17 % të të pandehurve. Në vitin 2019 janë përfunduar hetimet për 14423 të pandehur nga të cilët 12158 janë dërguar në gjykatë ose 84 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 2232 të pandehur janë pushuar hetimet ose për rreth 16 % të të pandehurve.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet efektiviteti i ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraparak për vitin 2021:




Treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në pesë vite, në dënimin e të pandehurve

Grafiku i mëposhtëm përmban të dhëna të detajuara lidhur me numrin e të pandehurve të deklaruar fajtor e dënuar dhe ata që kanë marrë pafajësi në pesë vitet e fundit:




Të dhëna mbi kërkesën e prokurorit dhe vendimet e gjykatës

Më poshtë paraqiten në përqindje të dhënat lidhur me kërkesat e prokurorit dhe vendimet e gjykatës gjatë vitit 2021, lidhur me dënimin me burgim, dënimin me gjobë dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë:




Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me **dënimin “Burgim i përjetshëm”** për periudhën 2017-2021:



Në lidhje me burgimin e përjetshëm, nga të dhënat statistikore sipas paraqitjes grafike pese vjecare rezulton se, në vitin 2021 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur me 50 % krahasuar me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur 20 % krahasuar me vitin 2019.

Ndërkohë nga të dhënat statistikore sipas paraqitjes grafike mesipër rezulton se, në vitin 2021 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2020 në masën 50 %, ndërsa në vitin 2020 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur në krahasim me vitin 2019 në masën 50 %


Paraqitja grafike mëposhtë eidenton të dhëna në lidhje me **dënimin e të pandehurve me burgim sa maksimumi i** parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete për vitet 2017-2021:



Nga të dhënat statistikore vihet re se në vitin 2021 ka një rritje prej 65,85 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020 ka një ulje prej 36,92 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin 2019.

Lidhur me vendimet e dënimit në maksimumin e masës së dënimit të parashikuar për veprën penale konkrete, gjatë vitit 2021 vërehet rritje prej 83,87 % krahasuar me vitin 2020, ndërsa gjatë vitit 2020 vërehet ulje prej 32,61 % krahasuar me vitin 2019.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për vitet 2017-2021 në lidhje me masën e **dënimit me burgim në minimumin** e parashikuar nga ligji:




Në lidhje me masën e dënimit me burgim në minimum, vihet re se, në vitin 2021 kërkesat e prokurorit janë rritur me 17,43 % krahasuar me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020 kërkesat e prokurorit janë ulur me 12,60 % krahasuar me vitin 2019.

Në vitin 2021 vihet re se vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë rritur me 15,57 % krahasuar me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020

vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë ulur me 1,44 % krahasuar me vitin 2019.


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me zbatimin e nenin 59 të Kodit Penal ku është parashikuar **“Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”** si kërtime të prokurorit ashtu edhe vendime të gjykatës, në pesë vitet e fundit:



Nga të dhënat statistikore, vihet re se në vitin 2021 ka një rritje prej 17,19 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”, ndërsa në vitin 2020 ka një ulje prej 3,07 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal.

Ndërkohë edhe vendimet e gjykatës në vitin 2021 kanë pësuar rritje prej 16,05 % në krahasim me vitin 2020.

Në lidhje me dënimin me gjobë, grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për pesë vitet 2017-2021:




Të dhënat statistikore në vitin 2021 tregojnë ulje të kërkesave të prokurorit për dënimin me gjobë prej 16,96 % në krahasim me vitin 2020, ndërsa dhe në vitin 2020 tregojnë ulje të kërkesave të prokurorit për dënimin me gjobë prej 27,20 % në krahasim me vitin 2019.

Sa i përket të dhënave lidhur me vendimet e dënimit me gjobë, vihet re se në vitin 2021 ka një ulje prej 14,52 % në krahasim me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020 ka një ulje prej 28,42 % në krahasim me vitin 2019.

2.11 TË DHËNA PËR TË PANDEHURIT PËR VITIN 2021

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për të pandehurit në hetim⁸² në pesë vitet e fundit (2017 – 2021):



Në lidhje me të pandehurit e regjistruar në vitin 2021, nga të dhënat statistikore rezulton se dinamika e këtij treguesi në pesë vite është si më poshtë:


Në vitin 2021 janë regjistruar 14374 të pandehur që do të thotë rritje prej 1,58 % në krahasim me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020 janë regjistruar 14151 të pandehur që do të thotë ulje prej 9,06 % në krahasim me vitin 2019.

Në lidhje me të pandehurit mbartur në hetim, duke marrë në referencë vitet 2017-2021 rezulton se; në vitin 2021 janë mbartur hetimet për 9359 të pandehur që do të thotë rritje prej 16,43 % në krahasim me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020 janë mbartur hetimet për 8038 të pandehur që do të thotë rritje prej 15,70 % në krahasim me vitin 2019.

Në lidhje me të pandehurit, për të cilët është vendosur rifillimi hetimeve rezulton se, në vitin 2021 janë rifilluar hetimet për 111 të pandehur që do të thotë rritje prej 141 % në krahasim me vitin 2020, ndërsa vitin 2020 janë rifilluar hetimet për 46 të pandehur që do të thotë ulje prej 62,60 % në krahasim me vitin 2019.

Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjininë e të pandehurve në vitet 2019-2021:



⁸² Në të dhënat e një viti përfshihen të pandehur çështjet e të cilëve janë mbartur nga viti i kaluar, të pandehur për të cilët është rifilluar hetimi nga organi i prokurorisë, të pandehur të regjistruar nga organi i prokurorisë.

Nga të dhënat statistikore rezulton se raporti i të pandehurve meshkuj-femra në vitin 2021 është 94,89 % meshkuj dhe 5,11 % femra, ndërsa në vitin 2020 është 95,09 % meshkuj dhe 4,91 % femra.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me arsimin e të pandehurve në vitet 2019-2021:




Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2021 rezultojnë 46,77 % e të pandehurve me arsim deri 9 vjeçar që përbën ulje në krahasim me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020 rezultojnë 51,11 % e të pandehurve me arsim deri 9 vjeçar që përbën rritje në krahasim me vitin 2019.

Me arsim të mesëm në vitin 2021 rezultojnë 42,73 % e të pandehurve, që përbën ulje krahasuar me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020 rezultojnë 40,08 % e të pandehurve, që përbën ulje krahasuar me vitin 2019.

Me arsim të lartë, në vitin 2021 rezultojnë 9,55 % e të pandehurve shifër e njëjtë në krahasim me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020 rezultojnë 9,55 % e të pandehurve shifër pothuajse në të njëjtin nivel në krahasim me vitin 2019.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen shoqërore të të pandehurve për vitet 2019-2021:




Për sa i takon gjendjes shoqërore të të pandehurve, nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2021 të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 4,63 % e të pandehurve, ndërsa në vitin 2020 të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 4,63 % e të pandehurve.

Të pandehurit e punësuar në sektorin privat në vitin 2021 përbëjnë 27,44 % të numrit të të pandehurve, ndërsa në vitin 2020 përbëjnë 24,21 % të numrit të të pandehurve.

Në vitin 2021 rezultojnë 70,02 % e të pandehurve si të papunë, ndërsa në vitin 2020 rezultojnë 71,38 % e të pandehurve si të papunë, si dhe në vitin 2019 rezultojnë 67,38 % e të pandehurve si të papunë.


Pra ajo që vërehet nga të dhënat statistikore është se gjatë tre viteve të fundit më shumë se 69,5 % e të pandehurve janë të papunë dhe ky tregues është një nga faktorët kryesor kriminogjenë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me vendbanimin e të pandehurve për vitet 2019-2021:



Sikurse rezulton edhe nga tabela e mësipërme, në lidhje me vendbanimin e personave të cilët janë marrë të pandehur, theksojmë se nga të dhënat statistikore rezulton se kriminaliteti mbetet një fenomen i pranishëm më shumë në qytet sesa në fshat edhe për vitin 2021 ku tendencat tregojnë se 60,05 % e të pandehurve rezultojnë me vendbanim në qytet dhe 39,95 % rezultojnë me banim në fshat.

Grafiku në vijim paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve për vitet 2019-2021:




Për sa i takon gjendjes gjyqësore të të pandehurve, në vitin 2021 rezulton se 1,32 % e të pandehurve janë përsëritës për të njëjtën vepër penale që do të thotë se ky tregues është ulur krahasuar me vitin 2020.

Përsëritës për vepra penale të ndryshme në vitin 2021 rezulton se janë 7,38 % e të pandehurve, që do të thotë rritje e lehtë krahasuar me vitin 2020.

Të pandehurit e padënuar më parë në vitin 2021 përbëjnë 91,3 % të të pandehurve.

Shtetësia e të pandehurve

Për sa i përket shtetësisë së të pandehurve, gjatë vitit 2021 rezulton se 1,63 % e tyre janë me shtetësi të huaj. Ky tregues rezulton në rritje 43,29 % krahasuar me numrin e të pandehurve të huaj të regjistruar në vitin 2020.



Të miturit 2021

Gjatë vitit 2021, bazuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, janë regjistruar 704 procedime penale ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin.

Nga të dhënat rezulton se janë regjistruar 744 të mitur si të pandehur ose persona nën hetim për kryerjen e veprave penale dhe ndaj 32 prej tyre është vendosur masë sigurimi arrest në burg, që zë rreth 4,3% të të miturve ose me ulje 1,6 % të këtij raporti me vitin 2020.


Lidhur me vendimarrjen e prokurorit për çështjet ku përfshihen të mitur në konflikt me ligjin, të dhënat tregojnë se është vendosur mosfillimi për 492 referime/kallzime penale ndaj të miturve, janë pushuar 302 çështje me 285 të pandehur të mitur në konflikt me ligjin ose me rritje 51,7 % të çështjeve krahasuar me vitin 2020 dhe janë dërguar për gjykim 210 çështje me 266 të pandehur ose me rritje 43,8 % të çështjeve të dëguara për gjykim krahasuar me vitin 2021.

Shkaqet e vendimarrjes në rastet e pushimit të çështjes, tregojnë se në 83,11 % të çështjeve janë vendosur masa alternative të shmangies dhe pjesa tjetër është pushuar për shkaqe të tjera procedurale.

Sa i përket aplikimit të masës alternative të shmangies, nga të dhënat rezulton se është aplikuar shmangia në 251 çështje me 283 të pandehur që është vendosur pushimi, ndër të cilat për 1 të mitur

në konflikt me ligjin është vendosur ndërmjetësimi, për 4 të mitur është vendosur paralajmërim me gojë dhe për 233 të mitur në konflikt me ligjin është vendosur paralajmërim me shkrim.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me aplikimin e masave të shmangies:



III. MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE

1. Gjatë vitit 2021, Prokuroria e Përgjithshme si autoriteti kompetent i Republikës së Shqipërisë për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Eurojust, ka vijuar masat dhe aktivitetet në përmbushje të kësaj marrëveshje për të mundësuar funksionimin sa më eficient të Prokurorit Ndërlidhës Shqiptar pranë Eurojust.

1.1 Me datë 1 janar 2021 ka filluar veprimtaria e Prokurorit Ndërlidhës të Shqipërisë në Eurojust, ndërsa me datë 29 tetor 2021 Prokurori i Përgjithshëm i Shqipërisë dhe Presidenti i Eurojust përuruan Zyrën e Prokurorit Ndërlidhës të Shqipërisë pranë selisë së Eurojust në Hagë.

1.2 Referuar Raportit Vjetor të Zyrës Ndërlidhëse Shqiptare në Eurojust për vitin 2021, evidentohen në mënyrë të përmbledhur mbështetja, masat/aktivitetet dhe treguesit statistikorë, si më poshtë:

i) Me hapjen e Zyres nga ana e Eurojust është ofruar dhe janë krijuar të gjitha mundësitë për aksesin në veprimtaritë e kësaj agjencie, në kuadër dhe në respekt të zbatimit të marrëveshjes me Eurojust dhe Republikës së Shqipërisë⁸³, prania e të cilës solli një rritje të dukshme të bashkëpunimit me autoriteteve të drejtësisë shqiptare dhe Eurojust, si agjenci ligjzbatuese e Bashkimit Evropian (BE). Të dhënat e përgjithshme, rezultojnë të jenë mjaft pozitive, si për rritjen e numrit të çështjeve të trajtuara, ashtu dhe sa i takon ndërgjegjësimin nga ana e autoriteteve gjyqësore shqiptare për rolin që ka Eurojust. Kështu, evidentohet rritja e nismave bashkërenduese në rastet komplekse të krimit transnacional, si e numrit të mbledhjeve të koordinuara, ashtu dhe ngritja e disa grupeve hetimore të përbashkëta, në bashkëpunim me autoritetet gjyqësore të vendeve të Bashkimit Evropian, por edhe vendeve të treta, të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi me Eurojust, siç është rasti i Zvicrës.

ii) Përgjatë vitit 2021 Zyra Ndërlidhëse Shqiptare në Eurojust ka regjistruar 21 çështje të reja me kërkesën e autoriteteve shqiptare kundrejt vendeve të Bashkimit Evropian, prej të cilave janë përfunduar 16 prej tyre. Janë hapur 3 çështje kundrejt shteteve të treta, jo anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat kanë zyra ndërlidhëse në Eurojust dhe 4 çështje kundrejt vendeve jo anëtare të BE-së.

iii) Ndërkohë, kundrejt Shqipërisë janë regjistruar 51 çështje të reja nga vendet e Bashkimit Evropian dhe ka patur në vijim 58 çështje të prejardhura nga vitet e kaluara, si dhe janë hapur 3 çështje nga vendet jo anëtare të Bashkimit Evropian.

iv) Gjithashtu, janë nënshkruar 5 marrëveshje të reja për ngritjen e Skuadrave të Përbashkëta Hetimore, si dhe ka vijuar zbatimi i 5 marrëveshjeve të Skuadrave të Përbashkëta Hetimore të mbartura nga vitet e kaluara me autoritetet gjyqësore të huaja, të asistuar dhe financuar nga Eurojust, të ngritura mbi marrëveshje të nënshkruara me Prokurorisë së Posaçme, si autoriteti gjyqësor shqiptar dhe vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, për vepra penale të kryera nga grupet

⁸³ Shih, po aty, “Marrëveshje për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST”, të ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 113/2018.

e strukturuar kriminale apo organizatat kriminale, kryesisht vepra penale të trafikimit të lëndëve narkotike, pastrimit të parasë, por edhe mashtrimit kibernetik.

2. Gjatë vitit 2021, gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme ka pasur në fokus të veçantë forcimin e bashkëpunimit me autoritetet homologe të huaja, si dhe ka dhënë kontribut nëpërmjet opinioneve dhe sugjerimeve edhe në kuadër të ndryshimeve ligjore apo nismave për marrëveshje dypalëshe në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në fushën penale, siç janë:

i) “Marrëveshja ndërmjet Mbretërisë së Spanjës dhe Republikës së Shqipërisë si shtesë e Konventës Europiane për Ekstradimin të vitit 1957” e nënshkruar, dhe e ratifikuar me ligjin nr.17/2022.

ii) Traktati i Ekstradimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës i nënshkruar, dhe i ratifikuar me ligjin nr. 67/2021.

iii) Dhënie mendimi dhe pjesëmarrjen në grupin e punës ndërinstitutional të krijuar nga Ministria e Drejtësisë në funksion të nismës ligjore për të bërë shtesat dhe ndryshimet e nevojshme në ligjin nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar/plotësuar me ligjin nr. 97/2021, i hyri në fuqi në datë 21 gusht 2021.

3. Treguesit statistikorë në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale për vitin 2021, sipas fushave respektive janë:

I. Ekstradime

i. Ekstradime nga jashtë

Gjatë vitit 2021 janë trajtuar gjithsej 117 praktika ekstradimi, për shtetas shqiptarë apo të huaj të cilët janë shpallur në kërkim ndërkombëtar nga prokuroria shqiptare mbi bazën e një vendimi penal dënimi të formës së prerë ose vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal “*arrest në burg*” të dhënë nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore të Republikës së Shqipërisë. Këta shtetas janë arrestuar ose lokalizuar nga autoritetet policore të shteteve të huaja, duke iniciuar kështu procedurën e ekstradimit nga jashtë vendit për në Shqipëri. Nga të dhënat statistikore rezulton se, për periudhën raportuese janë përfunduar gjithsej 36 praktika ekstradimi.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, në raport me vitin 2020 vërehet ulje tepër e lehtë e numrit të kërkesave të paraqitura nga autoritetet shqiptare për ekstradimin e subjekteve nga jashtë, e konkretisht në masën 1,7 %.


Më poshtë paraqesim në formë tabelare dhe grafike të dhënat për periudhën 2018-2021:

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Nr. kërkesave për ekstradim	171	180	119	117

Referuar të dhënave statistikore rezulton se, gjatë vitit 2021, numri më i madh i i personave të arrestuar jashtë vendit me qëllim ekstradimi në Shqipëri vijon të jetë me shtete si, Greqia 25, Italia 20 raste, Anglia 19, Gjermania 16, Kosova dhe Spanja me nga 5 raste, Belgjika 4, Maqedonia e Veriut dhe SH.B.A me nga 3 raste, Franca 2 dhe Emiratet e Bashkuara Arabe përkatësisht me 2 raste etj.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat statistikore për këtë tregues (*ekstradime nga jashtë*), si dhe grafiku përkatës sipas shteteve të cilëve i janë drejtuar kërkesat për ekstradim:

Shteti	Viti 2020	Viti 2021
Itali	31	20
Greqi	25	25
Angli	16	19
Gjermani	12	16
Francë	5	2
Kosovë	4	5
Spanjë	4	5
Hungari	1	1
SH.B.A	1	3
Zvicër	0	1



Në tabelën e mëposhtme ju paraqesim shpërndarjen e ekstradimeve nga jashtë sipas Prokurorive:

Ekstradime nga jashtë sipas prokurorive vitin 2021

<i>Prokuroria</i>	<i>Të regjistruara</i>	<i>Të përfunduara</i>
<i>Tiranë</i>	32	10
<i>Fier</i>	14	4
<i>Vlorë</i>	12	4
<i>Durrës</i>	9	3
<i>Elbasan</i>	7	1
<i>Gjirokastrë</i>	6	3
<i>Shkodër</i>	4	2
<i>Kukës</i>	4	1
<i>Korçë</i>	4	1
<i>Berat</i>	4	2
<i>Pogradec</i>	3	1
<i>Sarandë</i>	3	1
<i>Tropojë</i>	3	1
<i>Lezhë</i>	1	
<i>Lushnjë</i>	1	
<i>Krujë</i>	1	
<i>Mat</i>	1	

ii. Ekstradime për jashtë

Nga të dhënat statistikore rezulton se, gjatë vitit 2021 janë arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim ekstradimi drejt shteteve të tjera 128 shtetas (shqiptarë apo të huaj), një tregues ky i cili i krahasuar me një vit më parë rezulton me rritje në masën 12,3 %.

Ekstradime për jashtë

Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
128	157	114	128

Gjatë vitit 2021 numri më i lartë i praktikave të ekstradimit për shtetasit shqiptarë ose të huaj, të arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim ekstradimi jashtë vendit rezulton me Italinë me 66 të tilla⁸⁴, Gjermania 11, Kosova 10, Maqedonia e Veriut 4, Rumania 4, Belgjika 3, ekstradime për në Austri, Kroaci, Hollandë, Zvicër dhe SH.B.A rezultojnë 2 praktika, ndërsa nga 1 praktikë ekstradimi rezulton e filluar me shtetet si, Brazili, Bullgaria, Kanadaja, Çekia, Egjipti, Franca, Greqia, Kuvajti, Luksemburgu, Norvegjia, Pakistani, Polonia, Katari dhe Serbia.

⁸⁴ Për vitin 2021 rezultojnë në total 66 praktika të regjistruara fillimisht si praktika ekstradimi të subjekteve nga Shqipëria në Itali, nga të cilat 11 praktika, me kërkesë të autoriteteve italiane janë konvertuar në praktika njohje dhe ekzekutim në Shqipëri të vendimeve penale italiane.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e plota mbi praktikat e regjistruara në fushën e ekstradimit për jashtë, sipas shteteve, si dhe praktikat e përfunduara gjatë vitit 2021 për secilin shtet:

Ekstradime për jashtë 2021

	<i>Të regjistruara</i>	<i>Të përfunduara</i>
<i>Itali</i>	66	38
<i>Gjermani</i>	11	7
<i>Kosovë</i>	10	7
<i>Maqedoni e Veriut</i>	4	4
<i>Rumani</i>	4	3
<i>Belgjikë</i>	3	3
<i>Austri</i>	2	2
<i>Kroaci</i>	2	
<i>Hollandë</i>	2	
<i>Zvicër</i>	2	2
<i>SH.B.A</i>	2	2
<i>Brazil</i>	1	
<i>Bullgari</i>	1	1
<i>Kanada</i>	1	1
<i>Çeki</i>	1	1
<i>Egjipt</i>	1	
<i>Francë</i>	1	
<i>Greqi</i>	1	1
<i>Kuvajt</i>	1	
<i>Luksemburg</i>	1	1
<i>Norvegji</i>	1	1
<i>Pakistan</i>	1	1
<i>Poloni</i>	1	1
<i>Katar</i>	1	
<i>Serbi</i>	1	1
<i>Slloveni</i>	1	1
<i>Tailandë</i>	1	
<i>Turqi</i>	1	
<i>Turkmenistan</i>	1	1
<i>Emiratet e Bashkuara Arabe</i>	1	
<i>Mbretëria e Bashkuar</i>	1	1

Theksojmë se, në kuadër të trajtimit të kërkesave të ardhura nga autoritetet e huaja gjatë vitit 2021 (për ekstradimin e shtetasve nga Shqipëria drejt shteteve kërkuuese apo për njohjen dhe

ekzekutimin në Shqipëri të vendimeve penale të huaja të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë), mbështetur në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, i ndryshuar, dhe në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit nr. 1079, datë 15.07.2020, “Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve kriminale, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të KSA-së e FATF-së Planit të Veprimit ICRG/FATF” ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (përfshirë DPPPP, DPD e DPT) dhe Ministrisë së Brendshme, si dhe në vijim të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.10/2020, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë i ka kërkuar Drejtorisë për Krimin Ekonomik dhe Financiar në Policinë e Shtetit, në **75 raste**, zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së këtyre subjekteve dhe për **21 raste**⁸⁵ janë përfunduar verifikimet nga Policia e Shtetit, e cila ka njoftuar sipas rastit referimin pranë Prokurorive kompetente me juridiksion të përgjithshëm ose arkivimin e praktikave në rastet kur nuk janë identifikuar pasuri.

II. Kërkesa për ndihmë juridike (Letërporosi)

i. Letërporositë nga jashtë


Autoritetet gjyqësore të huaja, gjatë vitit 2021 kanë paraqitur në vendin tonë 599 kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të çështjeve penale, tregues i cili rezulton me rritje në masën 8,9% krahasuar me vitin 2020, vit në të cilin janë paraqitur gjithsej 550 letërporosi.

Në tërësi rezulton që gjatë vitit 2021, nga 599 letërporosi të dërguara në Shqipëri nga autoritetet e huaja rezulton të jenë ekzekutuar/përfunduar veprimet procedurale nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore gjithsej 397 letërporosi, ose 66,3 %.



⁸⁵ Të dhëna të regjistruara në sistemin IMPRO

Referuar të dhënave statistikore konstatohet se, ashtu si vitet e kaluara numri më i lartë i kërkesave për ndihmë juridike ka ardhur nga Portugalia me 103 letërporosi, Gjermania 78 Greqia 70, Kosova 67, Italia 47, Turqia 37, Mali i Zi 21, Maqedonia e Veriut 17, Kroacia 17, Sllovenia 16, Hungaria dhe Franca kanë dërguar nga 13 letërporosi, Austria 11, Zvicra dhe Belgjika 9, Holanda, Mbretëria e Bashkuar dhe Republika Çeke nga 8, Bullgaria 7, Polonia 6, Suedia 5, SH.B.A dhe Rumania 4 etj.



Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e regjistruara për kërkesat për ndihmë juridike, të ndara sipas shteteve, si dhe të dhënat respektive mbi letërporositë e përfunduara për çdo shtet.

Letërporosi nga jashtë viti 2021

	Të regjistruara	Të përfunduara	Të përfunduara në %
Rumani	4	4	100.0
Spanjë	3	3	100.0
Francë	13	12	92.3
Belgjikë	9	8	88.9
Slloveni	16	14	87.5
Bullgari	7	6	85.7
Hungari	13	11	84.6
Poloni	6	5	83.3
Portugali	103	79	76.7

<i>Maqedoni</i>	17	13	76.5
<i>Hollandë</i>	8	6	75.0
<i>SHBA</i>	4	3	75.0
<i>Kroaci</i>	17	12	70.6
<i>Turqi</i>	37	26	70.3
<i>Kosovë</i>	67	43	64.2
<i>Austri</i>	11	7	63.6
<i>Mali i Zi</i>	21	13	61.9
<i>Itali</i>	47	29	61.7
<i>Suedi</i>	5	3	60.0
<i>Greqi</i>	70	40	57.1
<i>Gjermani</i>	78	41	52.6
<i>Republika Çeke</i>	8	4	50.0
<i>Mbretëri e Bashkuar</i>	8	4	50.0
<i>Zvicër</i>	9	4	44.4

➤ **Letërporositë nga jashtë të ndara sipas grup veprave penale**

Gjatë vitit 2021 autoritetet gjyqësore të huaja kanë dërguar në Shqipëri kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruar për vepra të ndryshme penale, ndër të cilat⁸⁶ të grupuara sipas grupveprave penale rezultojnë:

- **44 letërporosi** të ardhura nga autoritetet e huaja gjyqësore për kryerjen e veprave penale të **trafikeve të paligjshme** (*kryesisht trafikimi i lëndëve narkotike*), të cilat janë dërguar nga shtete si Belgjikë, Bullgari, Finlandë, Gjermani, Greqi, Hollandë, Hungari, Itali, Mali i Zi, SH.B.A, Slloveni, Zvicër dhe Turqi;
- **154 letërporosi** të ardhura nga autoritetet e huaja gjyqësore për kryerjen e veprave penale të **falsifikimit të dokumenteve**, të cilat janë dërguar nga shtete si Portugali, vendet e rajonit, si dhe Mbretëria e Bashkuar;
- **11 letërporosi** për veprën penale të **pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale dhe financimi i terrorizmit**, nga shtete si, Itali, Greqi, Hollandë, Poloni, Republika Çeke, Mali i Zi etj;
- **34 letërporosi** për veprën penale të **mashtimit**, nga shtete si, Gjermani, Francë, Mali i Zi, Kosovë, Zvicër, Hollandë, Greqi etj.;
- **11 letërporosi** për veprat penale të **krimin kibernetik** të dërguara nga Gjermania, Portugali, Azerbajxhan, Kosovë, Sllovaki, SH.B.A etj.;
- **4 letërporosi** për veprën penale të **dhunës në familje**, dërguar nga Greqia, Italia dhe Kosova.

⁸⁶ Sipas të dhënave, të gjeneruara nga sistemi elektronik IMPRO

➤ ***Letërporosi nga jashtë me objekt ushtrim ndjekje penale në Shqipëri***

Të dhënat statistikore tregojnë se, gjatë vitit 2021 janë dërguar nga autoritetet e huaja gjithsej **12 kërkesa** për ndihmë juridike me objekt **ushtrimin në Shqipëri të ndjekjes penale** ndaj disa shtetasve, të cilat i janë transmetuar Prokurorive të Rretheve Gjyqësore sipas kompetencës. Më konkretisht, nga të dhënat rezultojnë se:

- Autoritetet **gjermane** kanë përcjellë **3 kërkesa** të tilla, me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale në Shqipëri, për kryerjen e veprave penale *“Trafikimi i lëndëve narkotike”, “Vrasje e mbetur në tentativë”, “Marrëdhënie seksuale me dhunë; plagosje”,* parashikuar nga legjislacioni penal gjerman. Këto kërkesa i janë përcjellë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Fier dhe Pukë;
- Autoritetet **greke** kanë përcjellë **2 kërkesa** të tilla, me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale në Shqipëri, për kryerjen e veprave penale *“Trafikimi i lëndëve narkotike”* dhe *“Kultivimi i lëndëve narkotike” në bashkëpunim*, parashikuar nga legjislacioni penal grek. Këto kërkesa i janë përcjellë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Gjirokastrë dhe Berat;
- Autoritetet **kroate** kanë përcjellë **2 kërkesa** të tilla, me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale në Shqipëri, për kryerjen e veprave penale *“Vjedhja e pronës”* dhe *“Falsifikimi i dokumenteve”*, parashikuar nga legjislacioni penal kroat. Këto kërkesa i janë përcjellë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Shkodër dhe Tiranë;
- Autoritetet **çeke** kanë përcjellë **2 kërkesa** me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale në Shqipëri, për kryerjen e veprave penale *“Përvetësim i paligjshëm”* dhe *“Shpërdorimi”*, parashikuar nga legjislacioni penal çek. Këto kërkesa i janë përcjellë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Shkodër dhe Tiranë;
- Autoritetet **e Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi** kanë përcjellë respektivisht nga **1 kërkesë** me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale në Shqipëri, për kryerjen e veprave penale *“Sulm ndaj personit zyrtar në kryerjen e detyrave të sigurisë”* dhe *“Tregëti e palejuar”*. Këto kërkesa i janë përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Shkodër;
- Autoritetet **zvicëre** kanë përcjellë **1 kërkesë** me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale në Shqipëri, për kryerjen e veprës penale *“Shkelje e rëndë e ligjit për lëndët narkotike dhe substancave psikotrope”*. Kjo letërporosi i është përcjellë për kompetencë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Disa prej praktikave më të suksesshme të bashkëpunimit të realizuara gjatë vitit 2021, në të cilat Prokuroria e Përgjithshme ka asistuar përfaqësuesit e shteteve të huaja në kryerjen e veprimeve procedurale në Shqipëri në ekzekutim të kërkesave për ndihmë juridike janë:

- Kërkesa për ndihmë juridike e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për Kosovën në Hagë;
- Dy kërkesa për ndihmë juridike e autoriteteve belge të drejtësisë.
- Kërkesa për ndihmë juridike e autoriteteve austriake;

➤ **Videokonferenca**


Rëndësi të veçantë kanë edhe rastet e kërkesave për ndihmë juridike me objekt zhvillimin e videokonferencave, të cilat janë shtuar gjatë vitit 2021 si rrethojë e pandemisë dhe kufizimeve apo vështirësisë së lëvizjes. Gjatë vitit 2021 autoritetet e huaja kanë paraqitur 10 kërkesa për marrjen në pyetje të personave ose dhënien e dëshmisë me videokonferencë.

ii. Letërporositë për jashtë

Gjatë vitit 2021, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të Republikës së Shqipërisë i kanë dërguar autoriteteve të huaja gjyqësore gjithsej 655 kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruara në Shqipëri ndaj shtetasve shqiparë dhe të huaj. Ky tregues ka pësuar rritje të lehtë me 5,6 % krahasuar me vitin 2020, në të cilin janë dërguar 620 letërporosi.


Gjatë vitit 2021, nga 655 letërporosi të dërguara nga autoritetet gjyqësore shqiptare jashtë vendit rezultojnë të jenë përfunduar/ekzekutuar nga autoritetet e huaja gjithsej 209 letërporosi, ose 31,9 % e tyre.

Letërporosi për jashtë	
Viti 2020	Viti 2021
620	655



Sa i përket shpërndarjes gjeografike sipas Prokurorive pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore rezultojnë se, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për periudhën raportuese ka dërguar jashtë vendit në funksion të hetimit 140 letërporosi, Prokuroria Durrës 74 letërporosi,

Shkodra 50, Fieri 48, Elbasani 46, Vlora 42, Korça 36, Gjirokastra 35 etj. (të dhëna të cilat paraqiten në grafikun e mëposhtëm)



Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat statistikore për letërporositë e dërguara nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të ndara sipas shteteve, si dhe të dhënat numerike dhe në përqindje të letërporosive të përfunduara nga secili shtet:

Letërporosi për jashtë viti 2021

<i>Shteti</i>	Të regjistruara	Të përfunduara nga shtetet	% e letërporosive të përfunduara
<i>Austri</i>	6	4	66.7
<i>Suedi</i>	15	9	60.0
<i>Turqi</i>	16	8	50.0
<i>Greqi</i>	109	51	46.8
<i>Zvicër</i>	14	6	42.9
<i>Serbi</i>	7	3	42.9
<i>Mali i Zi</i>	19	8	42.1
<i>Hollandë</i>	12	5	41.7
<i>Kosovë</i>	49	20	40.8
<i>Kroaci</i>	12	4	33.3
<i>Rumani</i>	9	3	33.3
<i>Itali</i>	133	38	28.6
<i>Poloni</i>	7	2	28.6
<i>Belgjikë</i>	18	5	27.8
<i>Gjermani</i>	48	13	27.1

<i>Kinë</i>	5	1	20.0
<i>Maqedoni e Veriut</i>	17	3	17.6
<i>Mbretëri e Bashkuar</i>	40	7	17.5
<i>Francë</i>	24	4	16.7
<i>Spanjë</i>	8	1	12.5

Të dhënat statistikore tregojnë se, numri më i madh i letërporosive i është dërguar shteteve kufitare dhe përkatësisht, Italisë i janë dërguar 133 kërkesa, Greqisë 109, Kosovës, 49, Gjermanisë 48, Mbretërisë së Bashkuar 40, Francës 24, SH.B.A 28, Malit të Zi 19, Belgjikës 18 etj. Vlen të përmendim se, kërkesa për ndihmë juridike i janë dërguar edhe shteteve si, Gjeorgji, Katar, Kolumbi, Malajzi, Marok, Moldavi, Nigeri, Qipro, Çeki, Seychelles, Sllovaki, Taiwan, Togo, Tunizi etj.

iii. *Letërporositë sipas veprave penale në kompetencë të Prokurorive me Juridiksion të përgjithshëm*

Gjatë vitit 2021, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore kanë dërguar pranë autoriteteve të huaja kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruar për vepra të ndryshme penale, të grupuara si më poshtë:


- **178 letërporosi për autoritetet e huaja (ose 27,2 % e totalit të letërporosive)** për kryerjen e veprave penale të **trafikeve të paligjshme**, përfshirë këtu trafikimin e personave të rritur, të të miturve, trafikimin e narkotikëve dhe trafikimin e mjeteve motorike;
- **155 letërporosi (ose 23,6 % e totalit të letërporosive)** për kryerjen e veprës penale të **pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale**;
- **62 letërporosi (ose 9,4 % e totalit të letërporosive)** për kryerjen e veprave penale të **krimin kibernetik**, të cilat i janë drejtuar shteteve si, Kinë, Itali, Gjermani, SHBA, Britani e Madhe, Malajzi, Hollandë, Poloni, Togo etj;
- **63 letërporosi (ose 9,6 % e totalit të letërporosive)** për veprat penale të **falsifikimit të dokumenteve**;
- **101 letërporosi (ose 15,4 % e totalit të letërporosive)** për veprat penale të **mashtimit**;
- **31 letërporosi (ose 4,7 % e totalit të letërporosive)** në kuadër të procedimeve për kryerjen e **krimeve kundër jetës të kryera me dashje**;
- **1 letërporosi** për kryerjen e veprave penale të **dhunës në familje** e dërguar në Itali nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

III. Njohjet e vendimeve penale

i. *Njohjet e vendimeve penale të huaja*

Referuar të dhënave statistikore rezulton se, për vitin 2021 autoritetet e huaja kanë paraqitur gjithsej 40 kërkesa për njohjen e vendimeve të tyre penale dhënë në ngarkim të shtetasve shqiptarë, tregues ky i cili rezulton me ulje në masën 31 % krahasuar me vitin 2020, vit në të cilin është kërkuar njohja e 58 vendimeve penale të huaja.

Njohje Vendimesh Penale të Huaja




Sikurse vërehet në tabelën e mëposhtme, Italia dhe Greqia kanë vijuar të zënë pjesën më të madhe të kërkesave për njohje vendimi penal përkatësisht me 29 dhe 7 kërkesa, ndërsa Belgjika ka paraqitur 4 kërkesa për njohjen me qëllim ekzekutimin në Shqipëri të vendimit penal të dhënë prej tyre në ngarkim të shtetasve shqiptarë.

Njohje vendimesh penale të huaja

Shteti	Viti 2021
Belgjikë	4
Greqi	7
Itali	29

ii. Njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit


Nga të dhënat statistikore rezulton se, gjatë vitit 2021 autoritetet shqiptare kanë paraqitur gjithsej 14 kërkesa për njohjen e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit, tregues me rritje të lehtë krahasuar me vitin 2020, në të cilin u paraqitën 12 kërkesa. Për periudhën raportuese, kërkesat për njohjen e vendimeve penale shqiptare i janë paraqitur përkatësisht 9 Kosovës, 2 Francës dhe nga 1 Turqisë, Polonisë e Bullgarisë.



IV. Transferimet e procedimeve penale

i. Transferimet e procedimeve penale

Gjatë vitit 2021, autoritetet e huaja gjyqësore kanë transferuar në Shqipëri 11 procedime penale me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale, ndërsa për periudhën raportuese Prokuroritë shqiptare kanë transferuar jashtë vendit gjithsej 13 procedime penale (*shih grafikun e mëposhtëm*).



Sikurse vërehet nga të dhënat rezulton se, për periudhën raportuese ka ulje të numrit të procedimeve penale të transferuara nga autoritetet e huaja në Shqipëri në raport me një vit më parë, e gjithashtu është ulur numri i procedimeve penale të transferuara nga prokuroria shqiptare drejt autoriteteve gjyqësore të huaja.

Më konkretisht, autoritetet e huaja gjyqësore kanë paraqitur 11 kërkesa për transferimin në Shqipëri të procedimeve penale të cilët rezultojnë përkatësisht, Greqia 1, Maqedonia e Veriut 1, Gjermania 1, Serbia 1, Mali i Zi 4 dhe Kosova 3.

Ndërsa, prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë në Republikën e Shqipërisë kanë vendosur transferimin e 13 procedimeve penale në total, përkatësisht 1 drejt Gjermanisë, 1 Greqisë, 1 Hungarisë, 1 Malit të Zi, 3 Italisë, 4 Kosovës dhe 2 Norvegjisë.


Shtetet	Transferime procedimesh penale nga jashtë	Transferime procedimesh penale për jashtë
Itali		3
Kosovë	3	4
Greqi	1	1
Maqedoni e Veriut	1	
Gjermani	1	1
Serbi	1	
Mali i Zi	4	1
Hungari		1
Norvegji		2
<i>Totali analitik</i>	11	13

V. Transferimet e personave të dënuar

i. Transferimet nga jashtë vendit të personave të dënuar


Gjatë vitit 2021 janë paraqitur gjithsej 2 kërkesa për transferimin e subjekteve të dënuar nga jashtë, tregues me ulje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2020, ku janë paraqitur 35 kërkesa të tilla.

Viti	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Transferimi i të dënuarve nga jashtë	4	34	35	2



ii. Transferimet për jashtë vendit të personave të dënuar në Shqipëri

Në vitin 2021 janë paraqitur 7 kërkesa për transferimin jashtë vendit të subjekteve të dënuar nga autoritetet shqiptare, duke konstatuar ulje krahasuar me vitin 2020, në të cilin është kërkuar transferimi nga 5 të dënuar.



VI. Urdhrat e arrestit ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet shqiptare

Referuar të dhënave statistikore rezulton se, gjatë vitit 2021 prokuroria shqiptare ka shpallur në kërkim ndërkombëtar gjithsej 172 shtetas (*shqiptarë apo të huaj*) të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë ose me vendim Gjykate është caktuar ndaj tyre masa e sigurimit personal “*Arrest në burg*”. Krahasuar me vitin 2020, në të cilin janë shpallur në kërkim ndërkombëtar 150 persona, për vitin 2021 ky tregues ka pësuar rritje në masën 14,6%.



Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore kanë kërkuar heqjen e 133 subjekteve nga listat e kërkimit ndërkombëtar për shkaqe të tilla,

- kur personi është deklaruar i pafajshëm nga gjykata;
- kur është parashkruar vepra penale/ekzekutimi i dënimit për të cilën është shpallur në kërkim ndërkombëtar.
- kur personi është ekstraduar drejt vendit tonë;
- kur personi është arrestuar në vendin tonë.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten shpalljet në kërkim ndërkombëtar për çdo prokurori, në total dhe të grupuara sipas vendimit të Gjykatës (*me masë sigurimi "Arrest në burg" apo me dënim penal për të vuajtur*):

Shpallje në kërkim ndërkombëtar për Vitin 2021

<i>Prokuroria</i>	Totali shpallje	Masë sigurimi "Arrest në burg"	Dënim me burgim
<i>Tiranë</i>	37	6	31
<i>Fier</i>	19	13	6
<i>Vlorë</i>	13	10	3
<i>Elbasan</i>	11	4	7
<i>Korçë</i>	11	4	7
<i>Kukës</i>	10	10	
<i>Mat</i>	10	5	5
<i>Durrës</i>	8		8
<i>Gjirokastrë</i>	7	3	4
<i>Lezhë</i>	6	3	3
<i>Sarandë</i>	6	2	4
<i>Tropojë</i>	6	2	4
<i>Berat</i>	6	3	3
<i>Shkodër</i>	4	2	2
<i>Pogradec</i>	4	2	2
<i>Dibër</i>	4	3	1

<i>Krujë</i>	4	3	1
<i>Kurbin</i>	2	2	
<i>Kavajë</i>	1		1
<i>Përmet</i>	1		1

VI. Urdhrat e arrestit ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë

Vlerësojmë të theksojmë se, përveç volumit të punës të trajtuar specifikisht sipas fushave të mësipërme në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, Prokuroria e Përgjithshme gjatë vitit 2021 ka trajtuar rreth **700 kërkesa të ndryshme** të ardhura nga autoritetet gjyqësore vendase e ato të huaja.

Zyra Qëndrore Kombëtare Interpol Tirana ka njoftuar në **299 raste** (praktika) shpalljen e shtetasve shqiptarë në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet e huaja, me të cilët Republika e Shqipërisë nuk ka marrëveshje ekstradimi. Prokuroria Përgjithshme për çdo rast i ka kërkuar ZQK Interpol Tiranës kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për identifikimin dhe lokalizimin në territorin shqiptar të këtyre subjekteve, në mënyrë që më pas të njoftohen autoritetet e huaja për të vlerësuar paraqitjen e kërkesës për transferimin e procedimeve penale, ushtrimin e ndjekjes penale apo njohjen e vendimeve penale të huaja në Shqipëri. Nga të dhënat statistikore rezulton se për periudhën raportuese janë përfunduar gjithsej 182 praktika të tilla. Sa i takon shteteve rezulton se, Greqia ka shpallur në kërkim ndërkombëtar gjithsej 57 shtetas shqiptarë, 36 Belgjika 54, Gjermania 64, Franca 47, Luksemburgu 15 etj.

IV. GARANTIMI INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE


Prokuroria e Përgjithshme në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka vijuar punën intensivisht dhe për vitin 2021, duke trajtuar çdo kërkesë të përcjellë nga institucionet përgjegjëse për verifikim të thelluar/plotë të të dhënave të pasqyruara në formularët e vetëdeklarimit nga subjektet të këtij ligji.

1. Për vitin 2021 janë regjistruar **181 procese** të verifikimit të plotë të të dhënave të formularëve të vetëdeklarimit të subjekteve të këtij ligji, si vijon:

- **84** (*tetëdhjetë e katër*) nga Departamenti Administratës Publike;
- **31** (*tridhjetë e një*) nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
- **27** (*njëzet e shtatë*) nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- **8** (*tetë*) nga Kuvendi i Shqipërisë;
- **6** (*gjashtë*) nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- **1** (*një*) nga Partia Demokratike;
- **19** (*nëntëmbëdhjetë*) nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- **3** (*tre*) nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit;
- **1** (*një*) kërkesë e ardhur nga Universiteti Aleksandër Xhuvani, për të cilën në bazë të nenit 7 pika 1 gërma “c” të ligjit 138/2015 është ushtruar e drejta e nismës për verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, pranë Departamentit të Administratës Publike që pas verifikimit paraprak ka kërkuar verifikim të thelluar për subjektin;
- **1** (*një*) kërkesë, për verifikim të subjekteve, ardhur nga Bashkia Gramsh, e cila është kthyer për mosplotësim të kushteve dhe kriterëve ligjore;

Nga totali i mësipërm, brenda këtij vitit, ka përfunduar proceset e verifikimit dhe miratuar rezultati i verifikimit për **118** (*njëqind e tetëmbëdhjetë*) persona/ subjekt të ligjit.


(Më poshtë gjeni grafikun ku pasqyrohen në përqindje kërkesat për verifikim sipas institucioneve përgjegjëse).



1.1 Nga kërkesat e organeve kompetente për verifikim të plotë të regjistruara më vitin 2021, rezulton se:

- për 58 (*pesëdhjetë e tetë*) persona, është vendosur mospranimi i kërkesave për mos plotësim të kushtet e kriteret e përcaktuara në ligj;
- për 60 (*gjashtëdhjetë*) persona, procesi ka përfunduar gjatë vitit 2021, duke miratuar rezultatet e verifikimit;
- për 63 (*gjashtëdhjetë e tre*) persona, procesi i verifikimit ka vijuar për vitin 2022.

(Më poshtë grafiku)



1.2 Sipas organeve kompetente, për kërkimin e verifikimit të dhënave në formularët e vetëdeklarimit, nga totali i kërkesave të mësipërme të regjistruara në vitin 2021 janë përfunduar dhe vijonë të jenë në proces gjatë vitit 2022, si më poshtë vijon:

		Të përfunduara	Në Proçes
1.	Departamenti i Administratës Publike	43	41
2.	Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve	10	21
3.	Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit	3	0
4.	Kuvendi	8	0
5.	Këshilli i Lartë Gjyqësor	5	1
6.	Partia Demokratike	1	0
7.	Inspektori i Lartë i Drejtësisë	19	0
8.	Këshilli i Lartë Prokurorisë	27	0
9.	Bashkia Gramsh	1	0
10.	Universiteti A. Xhuvani	1	0
	TOTAL	118	63

2. Gjatë vitit 2021, në bazë të kërkesave të regjistruara nga viti 2016 deri më vitin 2020, janë kryer procese të verifikimit të thelluar të të dhënave në formularët e vetëdeklaruarë edhe për **24 (njetzet e katër)** persona, subjekt të ligjit, nga këto:

- për **8 (tetë)** subjekte, procesi ka përfunduar dhe janë miratuar rezultatet e verifikimit, të cilat i përkasin: 1 (një) i vitit 2017; 3 (tre) të vitit 2019 dhe 4 (katër) të vitit 2020;
- për **16 (gjashtëmbëdhjetë)** subjekte, procesi verifikimit ka vijuar për vitin 2022, të cilat iu përkasin: 2 (dy) të vitit 2017; 6 (gjashtë) të viti 2019 dhe 8 (tetë) të viti 2020.

(Grafiku më poshtë në përqindje)



2.1 Për kërkesat e Departamentit të Administratës Publike të bëra gjatë viteve 2016-2020, ka përfunduar procesi i verifikimit në vitin 2021:

- për 2 subjekte të ndjekur në bazë të kërkesës së vitit 2019;

- për 3 subjekte, ndjekur në bazë të kërkesave të vitit 2020;

Për të 5-të subjektet e mësipërme, Departamenti i Administratës Publike (DAP) është shprehur se nuk evidentohen të dhëna që përfshihen brënda sferës së ndalimeve, të parashikuara në ligjin 138/2015.


Ndërsa, për kërkesat e bëra gjatë vitit 2021, nga Departamenti i Administratës Publike, konkretisht, për **43** (*dyzet e tre*) subjekte të cilave ju ka përfunduar procesi i verifikimit po brënda këtij viti, ky organ vetëm për **19** (nëntëmbëdhjetë) subjekte, ka kthyer përgjigje duke shprehur se “nuk evidentohen të dhëna që përfshihen brënda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga Ligji 138/2015”.

Shkaku kryesor i mospërfundimit dhe vijimit edhe për vitin 2022 të të gjithë proceseve të verifikimit të të dhënave në formularët e vetëdeklarimit, vazhdon të jetë vonesa në kthimin e përgjigjeve, për informacionin e kërkuar, nga autoritetet e huaja policore dhe gjyqësore.

3. Lidhur me nivelin hiarkik të funksionarëve publikë, të sjellë për verifikim të të dhënave në Formularët e Vetëdeklaruar, rezulton si më poshtë:

- **83** (*tetëdhjetë e tre*) subjekte, “Zyrtar i Lartë” ;
- **52** (*pesëdhjetë e dy*) subjekte, “Nivel Ekzekutiv”;
- **24** (*njëzet e katër*) subjekte, “Nivel Drejtues”;
- **22** (*njëzet e dy*) subjekte, “Nivel i Mesëm Drejtues”;

(Më poshtë paraqitja grafike)



3.1 Për 2 (dy) nga subjektet, gjatë verifikimit të të cilëve janë konstatuar elementë të veprave penale, materiali **është dërguar për kompetencë** në prokuroritë përkatëse.

V. NGARKESA E PUNËS SË PROKURORIVE PËR VITIN 2021

Kjo pjesë e raportit është hartuar në përputhje me nenin 19 pika 1, të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit, Prokurori i Përgjithshëm publikon, brenda muajit mars të çdo viti, raportin vjetor mbi ngarkesën e punës së prokurorive për vitin kalendarik paraardhës, si dhe rekomandimet për përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së tyre.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” kanë sanksionuar se prokuroria organizohet dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.

Prokuroria përbëhet nga:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
- c) prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Në vitin 2021, numri i përgjithshëm i miratuar është **321**⁸⁷ prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

Shpërndarja e tyre në prokuroritë sipas niveleve ka qenë: 278 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, 26 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe 17 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme. Ndërkohë, për shkak të vakancave numri faktik i prokurorëve ka qenë 177 në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, 16 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe 12 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme, që krahasuar me vitin 2020⁸⁸ përbëjnë ulje përkatësisht prej 21.45 % të numrit faktik total të prokurorëve.

Në vitin 2021 numri i prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratës për secilin nivel prokurorie paraqitet:

1. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm:

⁸⁷ 15 prokurorë u emëruan në Prokurorinë e Posaçme.

⁸⁸ Numri faktik i prokurorëve në janar 2020 ka qenë 261, përkatësisht 236 në prokuroritë e shkallës parë, 15 në prokuroritë e apeleve dhe 10 në Prokurorinë e Përgjithshme.

Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë	Prokurorë			Oficerë të Policisë Gjyqësore		Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Efektivë ⁸⁹	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
Tiranë	80	52	58	48	48	71	69	199	169
Berat	7	3	5.25	7	6	8	8	22	17
Dibër	6	4	4	4	3	7	7	17	14
Durrës	27	21	22	13	13	23	21	63	55
Elbasan	25	17	20.50	13	13	19	19	57	49
Gjirokastrë	7	4	4	5	5	11	11	23	20
Fier	14	12	13	11	9	17	17	42	38
Korçë	13	7	7.50	11	8	19	19	43	34
Krujë	7	5	4.75	5	5	5	5	17	15
Kukës	5	2	3.50	3	3	7	7	15	12
Lushnje	7	3	4.50	4	4	9	9	20	16
Lezhë	10	5	5.50	6	6	11	11	27	22
Mat	3	2	1.75	2	2	4	3	9	7
Përmet	2	1	1	1	1	4	3	7	5
Pukë	2	2	2	1	1	4	4	7	7
Pogradec	4	3	3.25	3	3	6	6	13	12

⁸⁹ Llogaritja e numrit efektiv është bërë sipas kohës reale të punës së prokurorit në prokurorinë përkatëse, ku:

Me pak se një muaj (30 dite) =0 prokuror

Nga 1 në 3 muaj=0,25 prokuror

Nga 4 në 6 muaj=0,5 prokuror

Nga 7 në 9 muaj=0,75/prokuror

Nga 10 në 12 muaj=1 prokuror

Sarandë	7	4	4.50	3	3	7	6	17	13
Shkodër	19	11	10.50	13	13	21	21	53	45
Tropojë	3	1	1.50	1	1	4	4	8	6
Vlorë	19	13	14	14	14	17	17	50	44
Kavajë	7	3	4.25	3	3	6	6	16	12
Kurbin	4	2	2	3	3	6	6	13	11

2. Në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm:

Prokuroritë pranë gjykatave të apelit	Prokurorë			Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Efektivë	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
Tiranë	9	5	3.25	10	10	17	13
Durrës	4	4	3.50	4	4	8	7
Gjirokastrë	2	1	1	2	2	4	3
Vlorë	5	2	1.75	4	4	9	8
Shkodër	4	2	2	3	3	8	6
Korçë	2	2	2	2	2	4	4

3. Në Prokurorinë e Përgjithshme:

Prokuroria e Përgjithshme	Prokurorë			Oficerë të Policisë Gjyqësore		Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Efektivë	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
	17	12	11.5	42	34	80	70	148	116


Duke iu referuar të dhënave statistikore vjetore të përcjella nga prokuroritë, volumi i punës dhe ngarkesa mesatare analizohet në vijim:

I. Ngarkesa e punës së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm

I.1 Volumi në hetim

Volumi i punës në hetim në shkallë vendi

Gjatë vitit 2021, në organin e prokurorisë janë trajtuar 60976⁹⁰ materiale kallëzuese që përbën një rritje prej 4.2 % në krahasim me vitin 2020. Janë ndjekur gjithsej 47475 procedime penale, që përbëjnë një rritje prej 5.89 % në krahasim me vitin 2020, nga të cilat 28349 janë procedime penale të regjistruara, me një rritje prej 1.64 % në krahasim me vitin 2020 dhe 934 procedime penale të rifilluara, që tregon rritje prej 45.93 % në krahasim me vitin 2020. Janë mbartur, 18192 procedime penale me një rritje prej 11.57 % krahasuar me procedimet e mbartura në vitin 2020. Është vendosur mosfillimi për 13501 referime dhe kallëzime penale, që do të thotë një ulje prej 0.97 % në krahasim me vitin 2020.



Volumi në hetim ku përfshihen çështjet e mbartura, çështjet e regjistruara, çështjet e rifilluara dhe ato të mosfilluara, për vitin 2021 sipas prokurorive është si më poshtë:


Në prokurorinë e shkallës së parë Berat janë ndjekur 2664 çështje;

Në prokurorinë e shkallës së parë Dibër janë ndjekur 1568 çështje;



⁹⁰ Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara përfshihen: procedimet e mbartura; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2021 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2021; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2021.

Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë ndjekur 5996 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë ndjekur 3740 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë ndjekur 2958 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastrë janë ndjekur 1861 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kavajë janë ndjekur 1144 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë ndjekur 2951 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Krujë janë ndjekur 1539 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kukës janë ndjekur 956 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kurbin janë ndjekur 966 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë ndjekur 1934 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lushnjë janë ndjekur 1757 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Mat janë ndjekur 286 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Përmet janë ndjekur 231 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Pogradec janë ndjekur 970 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Pukë janë ndjekur 265 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë janë ndjekur 2114 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë ndjekur 3541 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë janë ndjekur 18290 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Tropojë janë ndjekur 523 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë ndjekur 4722 çështje.


Grafikisht këto të dhëna paraqiten si vijon:



Në vitin 2021 raporti i numrit të çështjeve në hetim me numrin organik, faktik dhe efektiv të prokurorëve, sipas prokurorive paraqitet në grafikët në vijim:




Ngarkesa mesatare në hetim për çdo prokuror sipas numrit efektiv




I.2 Sipas prokurorive të shkallës së parë, numri i procedimeve penale të regjistruara në vitin 2021 është si vijon:

Në prokurorinë e shkallës së parë Berat janë regjistruar 942 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Dibër janë regjistruar 551 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 2483 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 1960 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 1420 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastrë janë regjistruar 660 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kavajë janë regjistruar 549 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar 1183 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Krujë janë regjistruar 690 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kukës janë regjistruar 553 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kurbin janë regjistruar 455 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 1213 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lushnjë janë regjistruar 918 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Mat janë regjistruar 169 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Përmet janë regjistruar 141 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Pogradec janë regjistruar 514 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Pukë janë regjistruar 71 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë janë regjistruar 732 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 1614 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë që është prokuroria me ngarkesën më të madhe në vend, janë regjistruar 9149 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Tropojë janë regjistruar 282 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 2100 procedime penale.

Grafiku më poshtë paraqet të dhënat mbi procedimet penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitin 2021:




Ndërkohë, numri i të pandehurve/personave nën hetim të regjistruar në prokuroritë e shkallës së parë, paraqitet në grafikun më poshtë:




Raporti i numrit mesatar të çështjeve të regjistruara sipas numrit organik, faktik dhe efektiv të prokurorëve sipas prokurorive paraqitet në vijim:


Procedime regjistruar për çdo prokuror sipas numrit organik





Procedime regjistruar për çdo prokuror sipas numrit faktik





Procedime regjistruar për çdo prokuror sipas numrit efektiv



I.3 Në analizë të përqindjes që zënë procedimet e regjistruara dhe procedimet e mbartura në volumin e punës sipas prokurorive, të dhënat rezultojnë si më poshtë:



I.4 Në analizë të përqindjes që zënë raporti i procedimeve të përfunduara me çështjet e regjistruara dhe procedimeve të përfunduara me procedimet në ndjekje sipas prokurorive, të dhënat rezultojnë si më poshtë:



II. Ngarkesa e punës së prokurorive pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm.

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës ka shqyrtuar 359 çështje themeli dhe 337 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë ka shqyrtuar 130 çështje themeli dhe 135 çështje lidhur me masat e sigurimit;


Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë ka shqyrtuar 108 çështje themeli dhe 230 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër ka shqyrtuar 259 çështje themeli dhe 389 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë ka shqyrtuar 349 çështje themeli dhe 1149 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë ka shqyrtuar 286 çështje themeli dhe 534 çështje lidhur me masat e sigurimit.

Grafikisht të dhënat paraqiten si vijon, ku siç vërehet Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë edhe për vitin 2021 ka patur ngarkesën më të madhe:



Raporti i numrit mesatar të çështjeve me numrin organik, faktik dhe efektiv të prokurorëve sipas prokurorisë përkatëse paraqitet në vijim:


Ngarkesa mesatare për çdo prokuror sipas numrit organik



Ngarkesa mesatare për çdo prokuror sipas numrit faktik



Ngarkesa mesatare për çdo prokuror sipas numrit efektiv



III. Ngarkesa e punës së Prokurorisë së Përgjithshme

III.1 Përfaqësimi në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar akuzën në emër të shtetit shqiptar pranë Gjykatës së Lartë për 54 çështje, prej të cilave 34 gjykime themeli, ku tre janë për vendime njësuere, dhe 20 gjykime masa sigurimi, si dhe në cilësinë e subjektit të interesuar pranë Gjykatës Kushtetuese për 5 çështje.

III.2 Mosmarrëveshje për kompetencë

Gjatë vitit 2020 janë marrë 49 vendime për zgjidhje të mosmarrëveshjeve për kompetencën tokësore apo lëndore në hetimit paraprak të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.

III.3 Akte nënligjore

3.1 Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2021 janë nënshkruar këto Udhëzime të Përgjithshme:

- ✓ Udhëzim i Përgjithshëm nr.1, datë 30.01.2021 “Për pastrimin, nxjerrjen jashtë përdorimit, shkatërrimit dhe asgjësimit të pajisjeve TIK në prokurori”;
- ✓ Udhëzim i Përgjithshëm nr.2, datë 17.06.2021 “Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.3, datë 21.06.2019 “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore”;
- ✓ Udhëzim i Përgjithshëm nr.3, datë 17.06.2021 “Për pastrimin dhe shkatërrimin e pajisjeve TIK që trajtojnë informacion të klasifikuar në Prokurorinë e Përgjithshme dhe struktura në varësi”;
- ✓ Udhëzim i Përgjithshëm nr.4, datë 09.07.2021 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”;
- ✓ Udhëzim i Përgjithshëm nr.5, datë 19.07.2021 “Për një shtesë në udhëzimin e përgjithshëm nr.14, datë 21.09.2020 “Për ushtrimin e të drejtës së hyrjes në bazat e të dhënave të të tretëve”;
- ✓ Udhëzim i Përgjithshëm nr.6, datë 23.07.2021 “Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.08, datë 19.05.2020 “Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”;
- ✓ Udhëzim i Përgjithshëm nr.7, datë 23.09.2021 “Për administrimin, qarkullimin dhe ruajtjen e vendimeve të përgjimit parandalues të klasifikuara “Sekret Shtetëror”;
- ✓ Udhëzim i Përgjithshëm nr.8, datë 15.11.2021 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktim dhe ose dëshmitar”;
- ✓ Udhëzim i Përgjithshëm nr.9, datë 21.12.2021 “Për marrëveshjen mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit”;
- ✓ Udhëzim i Përgjithshëm nr.10, datë 30.12.2021 “Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimi me institucionet kushtetuese e ligjore”;

3.2 Akte të tjera normative të Prokurorit të Përgjithshëm:

- o Urdhër nr.78 datë 09.07.2021 “Plani i Veprimit “Për zbatimin e kërkesave të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 14.06.2021 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2021”;
- o Urdhër nr.79, datë 09.07.2021 “Plani i Veprimit “Për zbatimin e “Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021”;

- o Urdhër nr.87, datë 28.07.2021 “Për miratimin e rregullave për përdorimin e sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur”;
- o Urdhër nr.92, datë 30.07.2021 “Për përdorimin e regjistrit elektronik dhe përfitim të statistikave për çështje të pastrimit të parave në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”;
- o Urdhër nr.30, datë 19.03.2021 “Për transferimin e të dhënave në sistemin e përgjimit të Prokurorisë së Posaçme”;
- o Urdhër nr.61 datë 02.06.2021 “Për ushtrimin e kontrollit në veprimtarinë e oficerëve të policisë gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”;
- o Urdhër Nr. 62, datë 03.06.2021 “Për krijimin e Komisionit të Shkatërrimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në Prokurorinë e Përgjithshme dhe strukturat në varësi”.
- o Vendim nr. 68 datë 17.06.2021 „Për listën e informacioneve të klasifikuara "sekret shtetëror" në Prokurorinë e Përgjithshme”.
- o Urdhër nr.69, datë 17.06.2021 “Për krijimin e Komisionit të Shqyrtimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror” në Prokurorinë e Përgjithshme”.
- o Urdhër nr.70/1, datë 28.06.2021 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit”
- o Urdhër nr.81, datë 14.07. 2021 “Për funksionet që duhet të pajisen me “Certifikatën e Sigurimit të Personelit” për njohje me Informacionin e Klasifikuar të BE në Prokurorinë e Përgjithshme”.
- o Urdhër nr. 82, datë 14.07. 2021 “Për funksionet që duhet të pajisen me “Certifikatën e Sigurimit të Personelit” për njohje me informacionin e klasifikuar të NATO-s, në Prokurorinë e Përgjithshme”.
- o Urdhër nr. 83, datë 14.07. 2021 “Për funksionet që duhet të pajisen me “Certifikatën e Sigurimit të Personelit” për njohje me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në Prokurorinë e Përgjithshme”.
- o Urdhër nr. 105, datë 30.09.202 “Për krijimin e Strukturës së Sigurisë në zbatim të vkm nr. 542, datë 25.7.2019 “Për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe të informacionit (SKI)”.
- o Urdhër nr.111, datë 15. 10.2021 “Për caktimin e Strukturës së Sigurisë”.

3.3 Akte të përbashkëta ndërinstytucionale:

- Marrëveshje Bashkëpunimi nr.1476/3 prot., datë 3.02.2021 ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve “Për dhënien e të drejtës së aksesit prokurorisë në sistemet elektronike të MISP”;
- Marrëveshje Bashkëpunimi nr.248, datë 05 shkurt 2021 mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magistratëve/prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”;
- Memorandumi i Mirëkuptimit nr.627, datë 13.04.2021 mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prezencës së OSBE “Për bashkëpunimin dhe bashkërendimin në zbatimin e projekteve dhe veprimtarive në mbështetje të efikasitetit të sistemit të prokurorisë shqiptare”;

- Memorandumi i Mirëkuptimit nr.941/1, datë 11.06.2021 mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Projektit EURALIUS V “Për sistemin elektronik të menaxhimit të dokumentave të burimeve njerëzore në sistemin e prokurorisë”;

III.4 Dekriminalizimi

Në Sektorin e Dekriminalizimit në Drejtorinë e Koordinimit Institucional, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për vitin 2021 janë regjistruar 181 procese të verifikimit të plotë të të dhënave të formularëve të vetëdeklaruar të personave, subjekt i këtij ligji.

Gjatë kësaj periudhe, për 118 subjekte vetëdeklarues është përfunduar verifikimi dhe janë përcjellë rezultatet e verifikimit, ndërkohë që 63 raste vijojnë të jenë në proces verifikimi brenda afatit ligjor të kryerjes së verifikimit, të përcaktuar në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me këto kërkesa/procese të regjistruara më vitin 2021, për 58 persona, kërkesat janë kthyer pasi nuk plotësonin kushtet e përcaktuara në ligj, ndërsa për 60 persona, procesi ka përfunduar gjatë vitit 2021, duke miratuar rezultatet e verifikimit.

III.5 Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja

Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme gjatë vitit 2021, ka trajtuar:

- Ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit, në total 128 praktika dhe janë përfunduar gjithsej 81 praktika;
- Ekstradime nga jashtë drejt Shqipërisë, në total 117 praktika, të përfunduara 36;
- Urdhër arreste ndërkombëtare të lëshuara nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë të cilët nuk mund të ekstradohen për shkak të shtetësisë shqiptare, në total 299 praktika;
- Letërporosi nga Jashtë, në total 599 praktika, 397 të përfunduara;
- Letërporosi për jashtë, 655 praktika, 209 të përfunduara;
- Shpallje e shtetasve shqiptarë ose të huaj në kërkim ndërkombëtar, 172 praktika;
- Heqje e shtetasve shqiptarë nga kërkimi ndërkombëtar 133 praktika;
- Transferime të dënuesve nga jashtë, 2 praktika të reja;
- Transferime të dënuesve për jashtë 7 praktika në total;
- Transferim procedimi nga jashtë drejt Shqipërisë, 11 praktika;
- Transferim procedimi nga Shqipëria për jashtë, 13 praktika;
- Njohjet e vendimeve penale të ardhura nga jashtë, 40 praktika;
- Njohjet e vendimeve penale shqiptare të dërguara jashtë vendit, 14 praktika;
- Praktika të tjera 700 në total ku përfshihen dhënie mendimi për projektligje të ndryshme, kontributet për raporte, kërkesa për informacion nga subjekte etj.

III.6 Përgjimet

Gjatë vitit 2021 është përdorur përgjimi i komunikimeve elektronike nga prokurorët në fazën e hetimeve paraprake si mjet për sigurimin e provës në 655 procedime penale. Është realizuar përgjimi për 3664 paisje fundore në përdorim të 3412 subjekteve ndaj të cilëve ishte lejuar përgjimi.

Në 683 raste përgjimi është urdhëruar/autorizuar nga vetë prokurori, bazuar në nenin 222, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale.

Në total janë ekzekutuar nga Bërthama Komanduese Elektronike 1534 vendime të Gjykatës nga të cilat 610 janë vendime lejimi përgjimi marrë mbi kërkesën e prokurorit; 455 raste janë vendime të gjykatës e cila ka vleftësuar kërkesën e prokurorit për rastet kur është aplikuar neni 222, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, në 469 raste është miratuar nga gjykata zgjatja e afatit të lejit të përgjimit dhe vetëm në 2 raste gjykata ka refuzuar kërkesën e prokurorit për lejin e përgjimit. Në 58 raste të lejit të përgjimit, vetë prokurori ka urdhëruar ndërprerjen e tij me akt të motivuar.

Në përballje me volumn më sipër, oficerët e policisë gjyqësore të sektorit kanë mundësuar përgjimin dhe në përfundim rezulton të jenë prodhuar 14.364 procesverbale transkriptimi të shoqëruara nga 3505 CD/DVD.

VI. PËRMBLEDHJE E ANALIZËS FINANCIARE DHE ZBATIMIT TË LIGJIT PËR NËPUNËSIN CIVIL PËR VITIN 2021

